

Programi

**Konsultime me shoqërinë civile kosovare
mbi themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e
fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të
drejtave të njeriut në ish Jugosllavi (KOMRA)**

Nevojat, pritjet e viktimave dhe drejtësia tranzicionale

(09.05.2009. Hotel „Victoria“, Prishtinë)

- 09:30 – 09:40 **Hapja**
Shukrije Gashi, Partners-Kosova, anëtare e Këshillit koordinues të
Koalicionit për themelimin e KOMRA-s
- 09:40 – 10:00 **Nevojat, pritjet e viktimave dhe drejtësia tranzicionale**
Shukrije Gashi
Përkrahja morale, materiale dhe ligjore
Drejtësia tranzicionale dhe zëri i viktimave
- 10:00 – 10:20 **Përvojat e të tjerëve në përcaktimin e fakteve për të kaluarën**
Avni Melenica, Shoqata „22 Maji“
- 10:20 – 10:45 **Prezantimi i iniciativës për themelimin e KOMRA-s**
 - **Qëllimi dhe rrjedha e konsultimeve**
 - **Përse KOMRA?**Nataša Kandić, Këshilli Koordinues i Koalicionit për KOMRA
Salem Çorbo, Shoqata “Kthimi dhe ekzistenca e qëndrueshme“
- 10:45 – 11:00 Pauza
- 11:00 - 12:15 **Nevojat, pritjet dhe drejtësia tranzicionale: mekanizmat për
përgjigje në nevojat dhe pritjet e viktimave**
Diskutime
Moderatore: Shukrije Gashi
- 12:15 – 13:00 **Shfaqja e filmit Ballafaqimi me të vërtetën: Komisionet për të
vërtetën dhe shoqëritë në transicion** Diskutime
Moderatore: Shukrije Gashi
- 13:00 – 14:00 **Dreka**
- 14:00 – 15:15 **Roli i shoqërisë civile në procesin e konsultimeve dhe fuqizimin
e drejtësisë tranzicionale përmes këshillimeve dhe formave
tjera të aktiviteteve**
Moderatore: Shukrije Gashi

- 15:15 – 16:15 **Roli i organizatave të dala nga lufta dhe bashkëpunimi i tyre me organizatat e shoqërisë civile në procesin e konsultimeve dhe përvojat nga konsultimet në Kosovë dhe në rajon**
Moderatore: Shukrije Gashi
- 16:15 – 16.30 Pauza
- 16:30 – 17:00 **Konkluzionet: Komentet dhe propozimet**
Zhvillimi dhe rekomandimet
Moderatore: Shukrije Gashi

Lista e pjesëmarrësve:

Bekim Gashi	Familjar i viktimave
Eli Krasniqi	Sociologe
Haki Kasumi	Përfaqësues nga asociacioni i personave të zhdukur
Halit Berisha	Shpresimi
Kushtrim Koliqi	INTEGRA
Preнкë Gjetaj	Komisioni qeveritar për të zhdukurit
Kushtrim Gara	Komisioni qeveritar për të zhdukurit
Rexhep Lushta	Imam
Ruzhdi Jashari	Kryetar i asociacionit të familjeve të viktimave të Racakut
Shaban Terziu	Landsdown
Xhafer Veliu	Pengu i Lirisë
Ymer Merlaku	Përfaqësues nga asociacioni i personave të zhdukur
Sylejman Bytyqi	Ish i burgosur
Ylber Topalli	Ish i burgosur
Jeta Xharra	BIRN
Sarah Maliqi	YIHR
Ylber Maxhuni	Youth step
Mazllum Baraliu	Profesor

Vëzhguesit:

Haki Abazi	"Rockefeller Brothers"
Ylber Morina	International Center for Missing Persons
Kushtrim Koci	International Committee of the Red Cross
Bogdan Ivanisevic	International Center for Transitional Justice
Bekim Ismajli	Center for the Study of Social Policy
Sakibe Jashari	Ambasada zvicerane
Nora Ahmetaj	Odbor FHP
Lumnije Bislimi	Proseperiteti i karadakut

Panelistët dhe organizatorët:

Shukrije Gashi	Partners Kosova
Natasa Kandić	Fondi për të drejtën humanitare (FDH)
Salem Čorbo	"Povratak i održivi opstanak"
Avni Melenica	"22 Maj"
Bekim Blakaj	FDH Kosovë
Jelena Grujić	FDH
Mentor Rushti	Partners Kosova
Florent Hajrizi	Partners Kosova
Besarta Vasija	FDH Kosovë

Hapja e takimit

Shukrije Gashi: Ndoshta përkohësisht do të ndalet procedura e pranimi të shteteve të reja në Bashkësinë Evropiane dhe besoni unë jam shqetësuar shumë. Kjo nuk flet pak. Domethënë, edhe sot kur po e mbajmë këtë këshillim konsideroj se jemi vonë. Nëse dikujt do t'i duhet një ditë, një vit ne do të na duhet që punën ta bëjmë 24 orë dhe të shpejtojmë për ta zënë hapin dhe për të përmbushur standardet të cilat me apo pa vullnetin tonë kërkohen nga ne dhe ne kemi obligim që ato t'i përmbushim. Dhe kështu, të mos lejojmë që numri i madh i viktimave dhe të zhdukurve të mbetet vetëm në numër dhe ata të mos pranohen, të mos njihen, të mos marrin meritat e duhura. Ne nuk duhet të lejomë që vitet të na ikin, lëndët të vjetrohen, të zvarriten çështjet dhe kryerësit e veprave penale të mos dënohen. Të gjitha këto mund të realizohen me një bashkëpunim të ndërsjellët. Para pak kohësh, ishte data e shënimit të të rënëve në një familje në Mitrovicë. Ishte një insert të cilin e pash në Radiotelevizionin e Kosovës. Dhe u preka thellë dëgjova se familjarët theksuan se atë ditë askush nuk kishte shkuar që t'i ngushëllonte dhe t'i jepte prehje kësaj familje. Domethënë kjo është ajo mungesa e pranimi, e njohjes së viktimave. Unë jam shumë e sigurt se edhe me këtë këshillim nuk do të mund ta bëjmë më të mirën, por të paktën të përpiqemi të bashkëbisedojmë, të sqarohemi, të kontribuojmë se çka është qëllimi i këtij takimi, cilat janë nevojat e viktimave, pritjet e tyre: çka duhet bërë e çka nuk është bërë dhe si duhet bërë këtë. Të gjitha këto pritje kërkojnë angazhim. Unë jam e sigurt dhe po e theksoj edhe një herë që ne këtë nuk e bëjmë më së miri. Të gjithë ata të cilët e konfirmuan ardhjen në këtë tryezë dhe nuk erdhën, për ta kjo është një humbje e madhe. Kjo që ndodh sot, nuk do të përsëritet ndoshta nesër në formën në të cilën flitet sot. Në qoftë se nuk jemi bashkëbisedues të drejtpërdrejtë mesazhi që do ta marrim i cili kalon nëpër disa mundësi, nëpër disa persona deri të mbërrin deri te ne do ta humbë porosinë esenciale. Prandaj, është e rëndësishme që të bisedojmë drejtpërsëdrejti dhe të jemi të pranishëm. Siç e thash më herët, unë disa herë kam pasur rastin që të marr pjesë në këshillime të tilla dhe tash së voni, në një këshillim, i cili është organizuar nga Organizata joqeveritare vendore Integra, përfaqësuesi i së cilës është këtu me ne bashkë, ishte një këshillim me studentët, me të rinjtë dhe vërtetë unë jam mahnitë me vullnetin e çeliktë të tyre për të marrë pjesë në këshillime të tilla të rëndësishme, për t'i kuptuar sa më parë nevojat e kategorive më të goditura të viktimave të dalura nga lufta dhe vullnetin e tyre që ata të angazhohen dhe të bëjnë çmos që proceset në veçanti këtë proces që ta shtyjmë përpara.

Ngjashëm ishte edhe në një takim tjetër këshillim, në Beograd, me organizatat e të rinjve të organizuar nga Organizata joqeveritare Fraktal dhe po ashtu, lirisht mund të them se jam mahnitur se sa ka pas interesim për të rinjtë nga Beogradi që ata të jenë të angazhuar në këtë çështje, që ta kuptojnë mirë situatën përkitazi me gjendjen e viktimave në Kosovë e gjetiu kudo që pati konflikte të armatosura dhe që ata të bëhen zë i fuqishëm i kësaj çështjeje. Unë kam qenë edhe herëve të tjera, disa herë do me thënë, edhe në forume të cilat janë organizuar dhe në forumin e katërt që u mbajt në Prishtinë vitin e kaluar. Natyrisht se kam pasur edhe rezerva të mia. Mirëpo, duke qenë aktualisht e angazhuar dhe anëtare e koalicionit të Këshillit për themelimin e komisionit ose për KOMRA kam arritur që më mirë dhe më thellë ta kuptoj rëndësinë e angazhimit, nevojën e angazhimit në një iniciativë të tillë. Edhe një herë duhet të theksoj se në qoftë se nuk do të bëjmë një punë të tillë, në radhë të parë, dhe gjithmonë do t'u ngelemi borxh atyre që më së shumti u goditën duke mos ua dhënë të drejtën që drejtësia të vihet në vend, që kryerësit e veprave penale të dënohen njëherë e përgjithmonë dhe me këtë që t'ia mbyllim mundësinë që gjeneratat që vijnë të mos e trashëgojnë në ngarkesën e tyre shpirtërore e morale barrën e krimeve që janë bërë, ndasitë për shkak të konflikteve të armatosura dhe izolimin në vorbullat nacionale. Çfarë na duhet neve një e ardhme e tillë, përveç që s'na duhet aspak, në radhë të parë as bashkësia ndërkombëtare nuk do të lejojë që kjo të ndodhë dhe ne mos të mbesim një pikë e zezë në qendër të Evropës. Të mos ia mbyllim derën vetvetes. Se po lejuam të ndodhë kjo ne do të lejojmë që të përsëriten konfliktet, që mos të zbardhet fati i viktimave, që mos të vihet drejtësia në vend, që të mos ketë bashkëbisedim dhe dialog, që mos të ketë të ardhme të ndritshme për qytetarët në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë duke përfshirë me theks të veçantë Kosovën. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe më së miri ju e dini këtë se sa dhe si e ka paguar Kosova çmimin e pavarësisë. Të gjithë ne që ishim të vullnetshëm deri këtu, me durim dhe përpjekje të mëdha sakrifikuam dhe bëmë shumë, arritëm që ta përjetojmë lirinë. Por, nuk duhet harruar, nuk duhet harruar asnjëherë se në përpjekjet tona shumëvjeçare, po e flas me kompetencë dhe po e them me përgjegjësi të madhe, për arsye se edhe unë isha në një formë njëfarë lloj viktime dhe e përjetova represionin si ish e burgosur politik, në fakt më shumë isha aktiviste për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Pra, në njëfarë forme e kam përjetuar në lëkurën time dhimbjen e të qenurit të shtypur. Por, në zërin tim, të vetmuar në periudha të caktuara, me shumë miq dhe dashamirë të tjerë edhe nga Kosova dhe rajoni, shpeshherë kemi gjetur përkrahjen pikërisht nga vendet fqinje – veprimtarë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Domethënë, në ato periudha kur ishte më së vështiri. Kjo për mua ka domethënie të madhe. Në popull përdoret një shprehje ose një thënie, të cilën ju e dini, miku i mirë njihet në ditë të vështirë. Atëherë kur të gjitha rrugët në Kosovë ishin të mbyllura për të komunikuar, ishin pikërisht përfaqësuesit e shoqatave, organizatave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, aktivistë të këtyre organizatave të cilët gjetën mundësinë dhe forma që informatat, raportet tona që ne i krijojmë në terren t'i dërgonin në qendrat e dhura të bashkësisë ndërkombëtare, siç ishte Amnesty International, Helsinki Commity, Human Rights Watch e organizata të tjera, shërbime për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i Federatës ndërkombëtare në Zvicër si dhe në ambasadat atëherë në ish-jugosllavi dhe pikërisht këto informata i bënë aktivistët për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut, të cilët ndikuan që gjendja e shkeljes së të drejtave të njeriut të zbardhej për Kosovën dhe të gjente mundësi për të dalë në sipërfaqe. Prandaj, unë konsideroj që edhe enë rrethana të sotme, ata miq të cilët i krijuam në kushte

shumë të vështira, në rrethana kur ishte më së vështiri, që këta miq përsëri t'i respektojmë, t'i çmojmë dhe edhe më tutje ta kultivojmë miqësinë tonë, pavarësisht se a vijnë nga qeveri e vende të cilat janë të papëlqyeshme për ne. Nuk duhet harruar se misioni i tyre është mbrojtja e të drejtave të njeriut. Ata nuk përfaqësojnë qeveritë. Përfaqësojnë shoqërinë civile, përfaqësojnë misionin e përbashkët i cili është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe në këtë rast zbardhja e fatit të të zhdukurve, reparacioni ose dëmshpërblimi i kategorive më të goditura nga lufta, ndihmesa që drejtësia të vihet në vend, për këto kategori dhe e gjithë kjo që të bëhet shpejt, që ne të bëjmë përpjekje ta kapim hapin shpejt. Një formë e tillë do të jetë do me thënë sipas pikëpamje sime dhe pikëpamjes me njerëz me të cilët e ndaj këtë iniciativë, domethënë iniciativën për themelimin e komisionit për gjetjen dhe përcaktimin e fakteve për të vërtetën. Më vonë, sigurisht, gjatë kësaj dite, në bashkëbisedim me ju ju do ta keni rastin që të dëgjoni dhe të vlerësoni pse kjo iniciativë është e rëndësishme, pse duhet të përkrahet ose s'duhet të përkrahet. Kjo nuk është përfundimtare. Komisioni e ka rëndësinë e mbledhjes së fakteve, por asnjë anëtar i komisionit nuk ka për detyrë që të bëjë gjykimin, shpalljen e dënimit. Janë gjykatat ato të cilat e kryejnë këtë mision. Prandaj, askush prej nesh këtu nuk duhet të ngurrojë që me përqendrim ta dëgjojë këtë këshillim i cili ka më shumë karakterin për t'u njohur me rëndësinë e këtyre argumenteve që i shtrova më herët dhe porosinë e drejtësisë tranzicionale e cila siç e thash më herët është e kushtëzuar jo vetëm me Kosovën por me të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë që të gjithë ne mund të jemi pjesë e botës së qytetëruar, e bashkësisë evropiane vetëm në qoftë se i përmbushim ose plotësojmë disa standarde. Dhe për ne si përfaqësues të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose aktivistë për këto të drejta, e rëndësisë parësore është që të zbardhet fati i të zhdukurve, që kryerësit e veprave penale ta marrin dënimin e merituar, që ata të mos mbesin në mëshirën e askujt, mos të shndërrohen vetëm në numra dhe që dikush t'i përdorë për nevojat e caktuara, interesa individuale e të organizatave dhe të ngjashme. Sa i përket kësaj çështjeje, unë nuk kam ndonjë gjë të veçantë për të shtuar për arsye se konsideroj që ju jeni të angazhuar me vite të tëra në këtë fushë. E vetmja porosi e mundshme dhe informacion i mundshëm që dëshiroj ta bartë tek ju është që krejt angazhimet tuaja shumë të vlefshme, të nevojshme, kërkojnë vetëm që të orientohen, kanalizohen mirë, që informatat, faktet, argumentet që mund t'i keni dhe që i keni mbledhur, punën që e keni bërë – ato ta gjejnë vendin e duhur, të mbërrijnë deri tek qendrat e vendosjes. Kjo nuk do të mund të bëhet pa insistimin tonë aktiv që qeveritë e vendeve tona përkatëse të vetëdijesohen dhe të marrin hapin e duhur për të dhënë një mbështetje zyrtare. Gjithashtu, më duhet të them se jam ndie e nderuar që në Forumin e katërt rajonal në Prishtinë Qeveria e Kosovës, Presidenti mori pjesë dhe theksoi se përkrahë një iniciativë të tillë. Po ashtu, edhe ministrja e Drejtësisë së Kosovës dhe kohë më parë, në një takim që e patëm me përfaqësuesin e Qeverisë, Kryeministrin, zotëri Hashim Thaçin, ai gjithashtu shprehu vullnetin e mirë për ta përkrahur një iniciativë të tillë. Në radhë të parë, në dukje të parë, ne dhe gjithë ju që jeni shumë të lënduar me këto çështje, jam e sigurt që deklaratimet e tilla për përkrahje nuk iu tingëllojnë bindshëm dhe kjo është e arsyeshme dhe unë e ndaj mendimin me ju, sepse shpeshherë ndodhin deklaratime dhe ato s'kryejnë punë, por duke i pasur parasysh rrethanat në të cilat është krijuar Kosova si shtet, ne gjithashtu duhet me pas mirëkuptim që të paktën Qeveria jonë po e shpreh vullnetin, gatishmërinë për të përkrahur iniciativat e tilla. Kjo nuk është mjaft, por është një hap drejt realizimit të një interesi të tillë parësor. Dhe mua më pëlqeu

shumë që Kryeministri bindshëm e tha: unë e përkrah këtë iniciativë. Kështu vepruan edhe Presidenti dhe ministrja e Drejtësisë. Ky është një fat i madh që në këtë rrëmujë në Kosovë, ku posa në një mënyrë dolëm nga mbikëqyrja e UNMIK-ut dhe tash e kemi mbikëqyrjen e EULEX-it, Qeveria po gjen hapësirë përkundër vështirësive të mëdha që të ketë vesh dhe të dëgjojë edhe fjalën tuaj dhe fjalën tonë. Por, përsëri nuk është mjaft, për arsye se të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se Kosova tash është në procesin e njohjeve dhe kjo është një ngarkesë e madhe për Kosovën. Prandaj, ne duhet të bëjmë çmos që vazhdimisht të insistojmë dhe asnjëherë të mos flemë, sa i përket kësaj çështjeje. Të mbajmë këshillime të tëra që Qeveria ta ketë vëmendjen e përqendruar tek çështjet tuaja, në radhë të parë te viktimat, që ato të dëgjoen zëshëm dhe që të hapet mundësia për krijimin e një komisioni meritator i cili do ta vë drejtësinë në vend me angazhimin e qeverive përkatëse. Edhe një herë po e them që në këtë bashkëbisedim jemi të ftuar që vetëm të këmbëjmë informatat, të këmbëjmë pikëpamjet tona përkitazi me çështjet për të cilat po flasim. Asgjë nuk është e vendosur njëherë e përgjithmonë. Modelet e komisioneve nuk krijohen brenda ditës. Ky është proces. Proceset e tilla stërgjatin, janë të dhembshme dhe këto procese jemi ne, të gjithë sa jemi këtu, të cilët mund t'i shkurtojmë. Thash për këtë çështje, ju falënderoj shumë për vëmendje. Besoj se bashkërisht do të arrijmë të zbardhim të paktën kuptimin për çështje për të cilat bashkëbiseduam. Faleminderit! Përkitazi me çështjet të cilat pata prezantimin deri më tani, do të bashkëbisedojmë, do të shqyrtojmë mundësitë, pikëpamjet tuaja, nevojat tuaja dhe pritjet më vonë, kurse tash do të përpiqemi t'i përmbahemi agjendës ose rendit të ditës të cilin e kemi paraparë. Për të mos humbur kohë, atëherë do ta thërras që fjalën ta merr në vazhdimësi Avni Melenica, përfaqësues i Shoqatës "22 maji".

Avni Melenica: Faleminderit! Përsëritet edhe një herë të gjithëve. Unë jam Avni Melenica, vi prej Shoqatës të familjarëve dhe personave të zhdukur në Vushtrri që quhet "22 maji". Nga bashkëbiseduesja paraprahe më pëlqeu ajo pjesa ku tha që Presidenti dhe Kryeministri i Kosovës e kanë përkrah themelimin ose propozimin tonë, se ne këtu jemi vetëm si propozues të komisionit për vërtetimin dhe tregimin e së vërtetës. Sepse, në fakt këto komisione themelohen prej shtetit dhe saktë shteti është ai i cili ia cakton mandatin dhe qëllimet, ia kufizon veprimet dhe e autorizon komisionin. Në fakt, edhe në fund fare, shteti është ai i cili aprovon rekomandimet të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e raporti final të Komisionit. Këto komisione duhet të merren me krimet e kryera në të kaluarën e afërme sepse si objektiv i komisioneve janë deklaratat e dëshmitarëve, të viktimave dhe kryerësve të krimeve. Për me funksionuar shpejt e saktë dhe në mënyrë cilësore, Komisioni duhet me dit saktë me çka ka me punuar, çka ka me qenë objektiv i tyre dhe me pas të definuar qartë hapësirën kohore dhe rajonale ku kanë me punua komisionet në fjalë. Tjetër pikë e komisionit është që komisioni duhet të merret me krimet e mëdha, më saktë me krime ku kanë pësuar numër shumë i madh i njerëzve, sepse objektiv i komisionit nuk është me u marrë me krime individuale. Shumica e komisioneve, për shembull, janë formuar nga kryetarët e shteteve përkatësisht me dekrete presidenciale të kryetarëve, pa ndonjë konsultim të gjerë me masë, me shoqëri të ndryshme, duke ia caktuar drejtpërdrejt në mënyrë precize kryetari komisionit mandatin, qëllimin dhe afatin kohor të veprimit. Prej historisë, sepse ne s'jemi të parët që jemi kah e formojmë një komision të tillë, kemi mësuar që këto komisione janë dhe nuk janë fort të suksesshme, për arsye se formimi preciz nga shteti pa ndonjë konsultim të gjerë me shoqëri civile dhe

me shoqata të dala prej lufte e që merren me të drejta të njeriut dhe me familjarët e viktimave na jep të kuptojmë se komisionet e formuara në mënyrë të tillë nuk e kanë gëzuar atë mbështetjen e shoqatave të cilat në fakt do të duhej të merreshin me komisionin. Kanë qenë shumë të suksesshme për arsye se komisionet në mënyrë precize janë formuar edhe pa probleme të tipit të konsultimeve të atyre që më saktë kanë mund ta refuzojnë formimin e tyre. Ka pasur raste kur komisionet janë formuar edhe me ndërmjetësimin e Kombeve të Bashkuara me bisedime të palëve në konflikt. Në fakt komisionet në Salvador janë formuar pa pjesëmarrje të organizatave për të drejtat e njeriut, me ndërmjetësim të drejtpërdrejt të Kombeve të Bashkuara. Kjo gjë ka ndodhur edhe në Guatemalë, ku më saktë, përfaqësues të Kombeve të Bashkuara e kanë formuar komisionin dhe disa prej organizatave joqeveritare kanë bërë goxha presion duke ditur se ky komision ka me u formuar me bisedime paraprake. Si në Salvador ashtu edhe në Guatemalë komisionet janë formuar me ndërmjetësim të Kombeve të Bashkuara, por Kombet e Bashkuara s'janë marrë aq me punë të komisionit më pastaj. Në Siera Leone Komisioni për të vërtetën dhe për pajtim është formuar me negociata të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara por mandatin dhe veprimin e Komisionit e kanë caktuar me ligj në parlament. Më tej, gjatë historisë, ka pasur raste kur disa komisione janë formuar nga kryeministria, për shembull Komisioni i Nepalit. Madje ka pasur edhe rast kur është formuar një komision i Ekuadorit nga ministria e policisë. Rasti më interesant është formimi i Komisionit të Afrikës Jugore, në fakt të dy komisioneve në Afrikën Jugore, të cilat drejtpërsëdrejti janë formuar nga grupe rebele të atjeshme, komisionet të cilat kanë pas punë t'i dokumentojnë krimet e kryera prej vetë atyre forcave rebele. Tri raste tjera të formimit të komisioneve në Gjermani, në Uruguai dhe në Afrikën Jugore na kanë treguar se në raport me komisionin e Gjermanisë dhe të Uruguait, Komisioni i formuar në Afrikën Jugore ka pasur jehonë më të madhe për arsye se është formuar me konsultime të gjera të cilat i kanë pas pri edhe konsultimeve të mbi 300 orë diskutimi në parlament. Pastaj, ky komision, në fakt, i ka gëzuar të drejtat shumë të mëdha, siç janë të drejtat për amnisti, të drejtat për bastisje dhe të drejtat për t'i ftuar njerëzit të dëshmojnë forcërisht duke iu thënë atyre që nëse nuk dëshmojnë kanë me u burgosur ose një gjë e tillë. Për me pas sukses në komision duhet me kanë relativisht jetëshkurtër dhe këtu prej historisë vërtetohet se shumica e komisioneve kanë zgjatë ose kanë pasur jetë prej 1 deri në 3 vjet. Për strukturën dhe përbërjen e komisionit shumica e komisioneve nuk kanë pas më shumë se 4 a 5 komisarë, kështu që janë angazhuar një numër shumë i madh i njerëzve të cilët u kanë ndihmuar këtyre komisioneve për me i marrë deklaratat, me i vërtetuar ato, me i proceduar në data-bazën e të dhënave, me i rregulluar dokumentacionet e ndryshme e tjera. Këtu vlen të përmendet Komisionin e Kilit dhe të Argjentinës, të cilët kanë pasur diku rreth 60 të punësuar dhe Komisioni Jug-Afrikan që ka pasur diku rreth 300 të punësuar, me 17 komisarë në katër zyre, të cilat janë marrë me këto punë. Në Peru, për shembull, kanë punuar rreth 800 njerëz. Konstrukti i Komisionit në Peru ka qenë mobil dhe fiks. Komisioni Jug-afrikan ka punuar me 3 nën këshilla: këshilli për shkeljen e të drejtave të njeriut ka qenë një këshill i cili ka bërë dokumentime dhe dëgjime të deklaratave të viktimave, të dëshmitarëve dhe të kryerësve të krimeve. Këshilli i dytë në Afrikën Jugore ka qenë Këshilli për dëmshpërblime, reparacion dhe rehabilitim. Ky këshill ka mbledhë të dhëna, i ka përpunuar ato dhe i ka paraparë si rekomandime të shpagimit të dëmeve për viktimat. Këshilli i tretë ka qenë një këshill që ka qenë pak a shumë i pavarur prej komisionit. O kanë këshilli për amnisti, i cili, në fakt e ka përbërë

atë pjesën më kontraverze të komisionit i cili është përbërë prej një gjykatësi dhe prej dy anëtarëve të komisionit të cilët kanë pas një pikë për t'i amnistuar kryerësit e krimeve. Mund të themi se paraprijëse të këtyre këshillave ka qenë Departamenti i hetimeve i cili kishte për detyrë mbledhjen e deklaratave dhe se ka bërë një punë shumë të madhe, të jashtëzakonshme mund të themi, duke i mbledhur 22.000 deklaratat, prej të cilave kanë dalë 2.000 para dëgjimit publik para këshillit për shkeljen e të drejtave të njeriut. Pos kësaj, ky komision është përbërë edhe prej departamenteve të ndryshme siç ka qenë ai i sigurisë, i mbrojtjes, i shëndetit mental e tjerë. Anëtarët e komisionit, flasim pak për përbërjen dhe për zgjedhjen e anëtarëve. Anëtarët e komisionit janë ata që i bëjnë politikat e komisionit dhe janë ata që i udhëheqin hetimet, i marrin deklaratat dhe vendosin se çka prej materiali duhet të përfshihet në raportin final. Nga raportet që vijnë nga komisionet e ndryshme kemi parë se në krye të komisioneve kanë qenë njerëz që kanë gëzuar autoritet të madh në masë. Për shembull në Amerikën Latine kemi parë se anëtarët e komisionit janë zgjedhur pa ndonjë konsultim të gjerë gjatë themelimit të komisionit, ndërsa në anën tjetër, në Ekuador, shumicën e anëtarëve të komisionit e ka zgjedhur shoqëria nga organizata të ndryshme ndërsa një pjesë më të vogël në raport me këtë e ka zgjedhur edhe ushtria atje. Në Guatemalë një anëtar madje është zgjedhur nga një dokument i disa njerëzve të propozuar nga rektorë të universiteteve. Këtu isha ndal pak te emërimi i anëtarëve të Komisionit jug-afrikan i cili emërim si proces ka qenë shumë i ndërlikuar dhe më i ndërlikuari deri më tani. Atje është formuar një Këshill përzgjedhjen e anëtarëve, i përbërë prej përfaqësuesve qeveritarë dhe organizatave për të drejtat e njeriut, pastaj para këtij këshilli patën kaluar rreth 300 kandidatura të cilat janë studiuar veç e veç dhe janë reduktuar më pas në 50 të tillë, të cilët kanë dal me dëshmi publike para këtij këshilli dhe ky këshill pastaj këtë numër të kandidatëve e ka reduktuar në 25, të cilin numër në listë e ka dërguar tek presidenti Mandela për shqyrtim. Presidenti Mandela kësaj liste i ka shtuar edhe 2 anëtarë tjerë të cilët nuk kanë qenë të obliguar për ta kaluar këtë fazën e nominimit dhe që më pastaj pos këtyre dyve presidenti Mandela e ka emëruar edhe presidentin dhe zëvendësin e komisionit. Pak a shumë i njëjti proces u përcjell edhe në Siera Leone i cili, nëse e marrim si tërësi si proces, ka qenë shumë transparent. Edhe në Siera Leone ka pasur 65 kandidatura të cilët janë dëgjuar nga paneli seleksionues dhe janë vlerësuar me pikë ndërsa më pastaj komisionarë vendorë janë emëruar nga presidenti atje, të cilët kanë qenë 4 dhe 3 të tjerë janë kanë ndërkombëtarë dhe janë emëruar nga Meri Robins komisarë e lartë e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Pos kësaj, edhe në Siera Leone edhe presidentit edhe zëvendës presidentit të komisionit e kanë formuar presidenti i vendit, kuptohet në bashkëpunim me komisarin e lartë për të drejtat e njeriut të dërguar nga Kombet e Bashkuara. E njëjta procedurë ka qenë edhe në Timorin Lindor. Atje ka qenë një këshill i përbërë nga instanca politike civile dhe aty kanë konkurruar kushdo që ka qenë i gatshëm dhe pas intervistimit lista e 7 më të dalluarve janë emëruar si komisarë.

Halit Berisha: Së pari falënderoj për ligjëratën për komisionet e formuara nëpër shtete të ndryshme. Pasi qenka i Vushtrisë unë dhjetë vjet, me do zotëri që jemi këtu punojmë për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur në Kosovë. Kallxom ti mu çka ke bërë ti në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur në Vushtri dhe me kallxu sa janë të vrarë, sa janë të pagjetur dhe të gjitha këto. Ne ty s'të kemi pa kurrë! Qe dhjetë vjet që punojmë në Këshillin koordinues të asociacionit të familjarëve të personave të zhdukur. Me na tregu ti në Vushtri sa ke punuar, çka ke bërë dhe sa i ke të zhdukur.

Shukrije Gashi: Më fal Avni! Absolutisht nuk kam ndërmend të kundër argumentoj por thash edhe një herë, pas prezantimit të panelistëve ne do ta kemi mundësinë që të bëjmë pyetje dhe përgjigje dhe të përgjigjemi edhe në raste të tilla. Domethënë çështja e përkrahjes dhe iniciativat e tillë është edhe përmes organizatave, është edhe individuale, është edhe vullnet i mirë. Edhe një herë po e theksoj se askujt asnjëherë as nuk është tentuar as nuk do të tentohet që t'i mohohet puna, angazhimi që e ka bërë. Por, përgjigjen përkatëse do ta bëjmë më vonë kur të vjen koha për pyetje dhe përgjigje. Faleminderit!

Avni Melenica: Atëherë, për ta shkurtuar pak do të flasim edhe për metodologjinë e punës për dëgjime publike dhe për mbledhjen e dhënave mbi krimet, komisionet mund të punojnë në seanca të hapura e të mbyllura. Po ashtu pos dëgjimeve të viktimave dëshmitarët dhe kryerësit e krimeve mund të kenë edhe dëgjime individuale. Krejt komisionet përveç asaj të Afrikës Jugore kanë punuar me raste të mbyllura. Te Afrika Jugore dëgjimi u bë publikisht dhe raporti final nuk i ka kushtuar ndonjë rëndësie e madhe raportit për arsye se të gjitha kanë qenë publike prej dëshmimeve e deri te publikimi i raportit. Në Siera Leone ka pas dëgjime tematike për shembull, ku janë ftuar për dëshmi gratë dhe fëmijët e viktimave në konflikt. Ndalemi pak edhe tek hetimet mbi personat e zhdukur në mënyrë të dhunshme e cila çështje është zgjidh në tri mënyra deri më tani, me sa kemi pa prej komisioneve tjera. Mënyra e parë, çështja ka qenë ekskluzive për komision siç ka qenë rasti i Argjentinës, Uruguait dhe Sri-Lankës. Në mënyrën e dytë kjo çështje u marrë si njëjtë me proporcion me çështjet tjera dhe çështja e tretë ose grupi i tretë i komisioneve janë kanë ato komisione të cilat i kanë rekomanduar që pas raportit final me u formua komisione të cilat kanë me u marrë ekskluzivisht me këtë çështje.

Raporti final parasheh edhe pjesën e amnistisë. Komisionet e para në Amerikën Latine janë ballafaquar me problem se a me i emëruar kryerësit e krimeve apo jo si të tillë. Çështja është zgjidh në shumtën e rasteve nga komisionet pasi që shumica e themeluesve ua ka lënë këtë punë në dorë komisioneve. Komisioni në Çad, në Afrikë të Jugut dhe Salvador e kanë pasur të drejtën e emërimit të kryerësve të krimit dhe e kanë bërë një gjë të tillë mirëpo komisioni i Guatemalës nuk e ka pas një drejtë të tillë pasi që ka qenë i themeluar në mënyrë precize prej shtetit. Te raporti final, faktet dhe rekomandimet, deklaratat e mbledhura, materialet e konfiskuara dhe çdo lloj e dhënë tjetër duhet studiuar mirë dhe rrjedhshëm. Rasti i mirë i definimit të thukhtë të parametrave të komisionit ka qenë në komisionin e Salvadorit i cili i ka klasifikuar këto të dhëna në fakt në tri lloj faktesh, si faktet e pa rrëzueshme, faktet me rëndësi dhe fakte të mjaftueshme. Këto lloj faktesh më parë kanë qenë pika që duhej vërtetuar edhe prej dy dëshmitarëve si fakte për të hyrë pastaj në raportin final. Në shumë vende këto raporte janë bë shumë të realizuara dhe kjo ka ndodhë kryesisht në vendet ku puna e komisionit ka qenë publike. Këto raporte në të shumtën e rasteve pas përfundimit i janë dorëzuar themeluesve të tyre, kryesisht presidentëve. Krahës fakteve, raportet finale, përfshijnë edhe rekomandimet, të cilat janë nga më të ndryshmet, si për shembull ndjekja penale e tjerë. Këtu vlen të theksohet se përmbushja e rekomandimet pas publikimit të raportit final është punë e themeluesve të këtyre komisioneve. Po, në rregull. Në fund po ndalem pak te mediat. Disa media kanë pasur një rol të dyfishtë në kryerjen e punës. Përvojat e Timorit Lindor, të Siera Leones ka pas emisione nga komisioni i cili është transmetuar një herë në javë në radion nacionale. Ka qenë në Amerikën Latine ku mediat nuk kanë pas qasje. Për shembull komisioni del në publikim të raportit final i cili u pat popullarizuar goxha. Në Afrikë të Jugut janë përcjell të gjitha punët sepse vetë përballja e komisionit ka qenë e

hapur për media prej dëshmimeve deri te raporti final. Pak a shumë, kjo është e tëra që është përmbledhur nga raporti i të dhënave nga komisionet tjera. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Edhe përkitazi me prezantimin e Avniut do të kemi rast që më vonë të shtrojmë pyetje dhe përgjigje, siç theksova edhe më herët. Dhe për t'iu përmbajtur rendit të ditës, agjendës, ne do të vazhdojmë me panelistët e tjerë në vazhdim.

Kemi prezantimin e iniciativës për themelimin e KOMRE-s, qëllimi dhe rrjedha e këshillimeve, përse KOMRA. Këtë do ta bëjë panelistja Natasha Kandiç, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA dhe Salem Çorbo, Shoqata Kthimi dhe ekzistenca e qëndrueshme. Domethënë këta dy panelistë do ta bëjnë një shtjellim të kësaj çështjeje. Fjalën ia jap Natasha Kandiç.

Natasha Kandiç: Unë do të filloj nga Melenica Mua më ka impresionuar shumë kjo që ai ka investuar angazhim dhe mund që të mësoj më tepër për përvojat e të tjerëve.

Në këtë iniciativën tonë gjinden shumë tekste, transkripta me konsultime të tilla në Web-faqe dhe ka shumë organizata të cilat i përcjellin këto konsultime në shoqëritë e pas-Jugosllavisë. Dua të them se përvoja e të tjerëve është e rëndësishme. Siç është për neve e rëndësishme përvoja e të tjerëve ashtu edhe të tjerët do ta shfrytëzojnë përvojën tonë dhe duke i përcjellur këto konsultimet tona do të shohin se si rrjedhin këto konsultime, ekzistojnë disa nevoja të caktuara, të shoqatave të caktuara, grupeve të caktuara të të rinjve e përkrahin shumë iniciativën, se ekzistojnë kërkesa të caktuara të cilat shtrohen me vite e kurr nuk zgjidhen. E gjithë kjo është e leverdishme dhe e sigurtë kjo është hera e parë që unë dëgjoj se dikush nga shoqata e familjeve të viktimave flet për përvojën e të tjerëve. Kjo është vërtet e rëndësishme. Do të tentoj të hapi këtë çështje të nevojave të viktimave, dhe në atë kontekst të nevojave të viktimave të sqaroj pak se çfarë është dhe pse është kjo iniciativë. Unë nuk mund t'i numëroj tubimet, sa është numri i tubimeve dhe shoqatave që nuk kam marr pjesë. Ky numër i tubimeve është mbi njëqind. E çka dëgjohej në këto tubime kur flitet vetëm për nevojat. Pa marr parasysh a janë shoqatat nga Bosnja dhe Hercegovina, janë nga Mali i Zi, a janë nga Kosova, a janë nga Kroacia, ekziston diçka që është e përbashkët e kjo është se të gjitha viktimat kanë nevojë të flasin për atë se çka iu ka ndodhur. Të gjitha viktimat kanë nevojë të pyesin, kuptojnë se kush e ka kryer krimin ndaj tyre. Të gjitha viktimat kanë nevojë të madhe ta shohin se respektohen nga të tjerët, se i dëgjojnë edhe ata të palës tjetër, ata të cilët i përkasin atij shteti, asaj shoqërie e cila është përgjegjëse për atë padrejtësi që iu ka ndodhur atyre. Ajo që është gjithashtu e përbashkët për të gjitha viktimat është se atyre iu nevojitet një pranim (njohje) publik, nuk është e mjaftueshme ajo që të gjithë në rrethin e tyre e dinë se çfarë iu ka ndodhur. Se për ta është e rëndësishme që të tjerët të dinë edhe të vlerësojnë se kjo është e nevojshme edhe për disa gjenerata të ardhshme. Pastaj, në këto tubime, shihet shoqatat e viktimave dhe viktimat i kanë disa...Thash se është evidente nevoja që ta dinë se kush e ka bërë atë. Por ekziston një se kjo nuk është më nevojë, kjo është një kërkesë, që ata që kanë bërë krim të gjykohen. Dhe kjo është e përbashkët për të gjitha viktimat, se kurrë nuk janë të kënaqura më gjykimet kudo që janë organizuar. Numër i vogël i viktimave është i kënaqur me gjykimet e Hagës e mos të flas për gjykimet kombëtare (nacionale). Por, kjo që e kam vërejtur është se ata nuk janë të kënaqur me gjykimet, thonë se në gjykim janë vërtetuar veprat të cilat viktimat nuk kanë mundur t'i dinë në bazë të asaj që kanë parë. Viktimat nuk mund të shohin tërë atë anë e cila i takon atyre kryerësve, si për shembull tani, kam dëgjuar nga familjet e viktimave të cilët e kanë përcjellur vendimin e gjykatës (aktvendimin) në Suharekë. Ishin shumë, shumë të

pakënaqur me disa dënime. Më i përgjegjshmi është liruar nga përgjegjësia por atë askush nga Suhareka nuk e ka njohur dhe nuk e njeh dhe as që e ka parë ndonjëherë. Ky ishte njëfarë komandanti i skuadrës së 37 të njërive të veçanta të policisë, i cili është i akuzuar duke iu falënderuar asaj që prokuroria serbe gjatë hetimeve e ka identifikuar si personin që është përgjegjës sipas asaj përgjegjësie komanduese. Të gjitha familjet e viktimave në Suharekë e dijnë për komandantin e stacionit policor. Komandanti i stacionit policor ka marrë 20 vjet. Ky është dënimi më i madh për krime të luftës në të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë duke e përjashtuar vetëm gjykatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Atje, jashtë Sarajevës, dënimi më i madh për krime lufte është 20 vjet por vet gjykata, ajo gjykatë shtetërore e Bosnjës dhe Hercegovinës, vetëm ajo që e ka selinë në Sarajevë, ajo për krime lufte mund të bie vendimin edhe prej 40 vitesh. D.m.th., kam identifikuar se viktimat, ajo që është evidente, kanë kërkuar që të gjykohej, e kjo është kërkesë shumë e artikuluar. Pastaj gjithashtu ka kërkesë, kjo nuk është vetëm nevojë, që të marrin dëmshpërblime materiale, që të marrin atë lloj të reparacionit material të luftës, të marrin ndonjë pranim, pranim material për të gjitha që i kanë përjetuar. Kanë gjithashtu nevojë të shohin se edhe ata kanë njëfarë sigurie sociale, a janë aty në pyetje pensionet, a janë aty në pyetje kompensime të ndryshme sociale, a janë aty në pyetje kritere të veçanta për lehtësim të regjistrimit të fëmijëve në fakultete, por e presin këtë dhe publikisht i adresojnë kërkesat e tilla. E tani, çka ndodh lidhur me nevojat dhe lidhur me kërkesat e viktimave dhe familjeve të viktimave. Numër i vogël...Më falni, nuk e kam përmendur edhe një nevojë dhe kërkesë. Kur them nevojën, kjo është një nevojë e fortë emocionale që të gjinden mbetjet mortore të të zhdukurve dhe familjet të përjetojnë një lloj qetësimi, të dinë ku gjendet vendi i varrit (varreza) dhe të mund të vizitojnë atë varrezë. Por si kërkesë paraqitet ky identifikim i mbetjeve mortore dhe para tij zbulimi i varrezave të fshehta masive çfarë ka akoma. Në nivelin e tërë ish Jugosllavisë ne kemi edhe 16.300 sosh fati i të cilëve nuk është sqaruar. Natyrisht, që pas kaq vitesh vështirë është të flitet se ka burgje të pa zbuluara, por ajo që është plotësisht e sigurt është që këto fat nuk janë sqaruar dhe se ne akoma nuk e dimë saktësisht çfarë ka ndodhur me ta.

Sa i përket Kosovës, ky numër është diku në mes të 1.900 dhe 2000. Diku rreth 1.500 shqiptar akoma gjenden në listën e të zhdukurve dhe të pa gjeturve. Ne nuk e dimë se çfarë ju ka ndodhur atyre, edhe pse ka indikacione serioze sidomos për neve që merremi me këto çështje (pyetje) të të zhdukurve dhe fatet, çfarë ka mundur të iu ndodh atyre. Akoma ka varreza të fshehta masive dhe familjet dhe shoqatat që më së shpeshti e cekin këtë si kërkesë, do të thotë zbulimi i varrezave të tilla masive, ekshumimi dhe identifikimi e pastaj shkon ajo kërkesë, d.m.th. me vërtetimin e përgjegjësisë së fajësisë për atë që ka ndodhur. Tash pas 10 vitesh, pas luftës në Kosovë, a mund të jenë të kënaqura familjet e viktimave, shoqatat e viktimave, shoqëritë. Këtu në Kosovë shumë shpesh dëgjohet se çdo gjë është në duart e Serbisë. Por keni kujdes, Serbia është... Çka është gjithsejtë Serbia? Kjo është më e rëndësishmja që ta sqarojmë. Unë jam shumë e falënderueshme që Shukrije Gashi veçmas e ka ndarë këtë çështje të organizimit për të drejtat e njeriut, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, atyre që merren me të drejtat e njeriut. Të mos e përziejmë Serbinë, shtetin, qeverinë e Serbisë me atë që është shoqëri civile, ato që janë organizata për të drejtat e njeriut. Mua dhe neve të tjerëve, Shukrijen, unë lutem që neve këtu të na shikoni si aktiviste për të drejtat e njeriut, mbrojtëse. Do të thotë ne po angazhohemi për të njëjtën gjë për të cilën edhe ju angazhoheni, vetëm ndoshta, për arsye se jemi shumë të fokusuar në të drejtat e njeriut njëkohësisht e dimë se

si veprohet në këto çështje edhe në shoqëri të tjera të pasluftës, ndoshta në disa qëndrime dhe qasje dallojmë, siç është, nuk e di, këtu mbizotëron mendimi se kryesve të krimeve të luftës në Kosovë duhet tu gjykohet në Kosovë. Unë nuk mendoj se të gjitha gjykimet duhet të zhvillohen në Kosovë. Unë mendoj se duhet të kemi kujdes për atë se çfarë është qëllimi i gjykit. Qëllimi i gjykit duhet të jetë edhe që ajo shoqëri, qytetarët e atij shteti i cili është përgjegjës për krime të shumta, se ata duhet të ballafaqohen me ato gjykime, se ata duhet të shohin drejtpërsëdrejti çka ka ndodhur, konkretisht në këtë rast çka ka ndodhur në Kosovë. D.m.th. pa atë që shoqëria prej nga vijnë kryes të shumtë nga policia dhe nga ushtria, nëse ata nuk ballafaqohen me atë se çfarë është kryer, ju keni në Serbi ose çka ka bërë ajo Serbi, viktimat në Kosovë nuk do ta kenë aspak më lehtë. Sikur të gjykohen komandantët e policisë së Serbisë në Kosovë unë mendoj se do të ishte gati e pamundur. Askush, asnjë gjykatë e Kosovës, nuk do të mund të siguronte ardhjen e dëshmitarëve nga Serbia. Asnjë shtet, jo vetëm Serbia, nuk do të pranonte ti dorëzoj qytetarët, të akuzuarit e tij që ti gjykojë një gjykatë tjetër. Dhe kur mendoni më mirë, në atë mënyrë ne realizojmë njërin nga qëllimet më të rëndësishme vendosjen e drejtësisë e kjo është që ajo të fshihet aty ku ata kryes, që ajo polici, sot ata që e udhëheqin atë polici që ata të shohin se çfarë ka bërë ajo polici në Kosovë, që qytetarët, ata që shkojnë në shkollë, ata që studiojnë që ata të ballafaqohen me atë që ka bërë policia në Kosovë dhe në çfarë mënyrë janë vrarë dhe kanë pësuar më shumë se 10 mijë viktima në Kosovë. E tani, nëse tërë situatën lidhur me gjykimet, lidhur me atë që viktimat, familjet e viktimave dhe shoqatat vazhdimisht e përmendin, me Serbinë mundemi ta bëjmë pasi që të kërkoj falje, që tregohet se kjo është një nevojë dhe një kërkesë që gjithnjë e cekin, por kjo nuk ndodh. E kur kjo nuk ndodh, kur nuk ka as gjykime të përsosura, kur nuk ka as falje por nga të gjitha ka pak, atëherë do të vinte deri te ajo që organizatat për të drejtat e njeriut të fillojnë disa iniciativa. Atëherë ne jemi në mungesë të kësaj zgjidhjeje ideale, përgjigjeve për krimet masovike që janë bërë, e kjo është që do të ishte d.m.th. që Serbia të pranojë, që t'i paraqesë të gjitha faktet, që ti zbulojë varrezat masive, të kërkojë falje, t'i paraqesë të gjitha të dhënat, që ti emëroj kryesit, të organizojë administratën, të largohen nga institucionet ata të cilët kanë marr pjesë në krime. Do të thotë pasi që kjo nuk ekziston, atëherë organizatat për të drejtat e njeriut janë në pajtueshmëri me mandatin të cilin ato e kanë, kështu që vizioni i tyre në raport me ndonjë të ardhme por duke pasur parasysh të kaluarën atëherë ne jemi organizuar në atë nivel rajonal dhe jemi lidhur që është hera e parë nga viti 91 që ne i kemi të lidhura organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut në nivel rajonal. Ne d.m.th. nuk i përkasim asnjë qeverie, ju lutem, ne jemi grupe marginale dhe arrimë aq sa arrijmë të organizohemi, aq sa jemi prezent në opinion, aq sa kjo që ne po e bëjmë nxit, shqetëson opinionin dhe sa jemi atëherë të fuqishëm që në të vërtetë si aktivistë për të drejtat e njeriut të ndikojmë, të bëjmë presion dhe të ndërrojmë diçka. Kështu që ju lutem që ta kuptoni se vetëm përderisa bëjmë presion së bashku, përderisa kuptojmë se shoqëria civile nuk i takon asnjë qeverie por e ka njëfarë vizioni të saj e cila është në përputhshmëri me disa standarde ndërkombëtare. Çka dëshirojmë të arrijmë? Dëshirojmë drejtësinë për viktimat, pa marr parasysh a është ai Xhafer Velia, apo është ajo familja Manaj, apo ajo është familja nga Srebrenica ose ndonjë familje serbe e cila i ka anëtarët e saj të zhdukur apo të vrarë. Por nuk dëshirojmë trajtimin e njëlojshëm të viktimave e as viktimat, ju lutem nuk mund të trajtohen njëloj. Kjo nuk është e mundur. Ja një shembull. Sikur të kishim organizuar dëshmimin publik, dhe sikur të dëshmojnë viktimat dhe sikur Xhafer Veliu të fliste për zhdukjen e 35 të rinjve nga xhamia në Qirez,

pranë tij do të mund të dëshmojnë nuk e dijë sa të tjerë, për shembull të them, Boshnjak ose Serb të cilët do të tregonin për atë se dikush nga familja e tyre është zhdukur. Kjo kurrë nuk mund të trajtohet njëloj, sepse pesha e krimit të luftës diçka që i cakton raportet në mes viktimave apo nivelet në mes viktimave. Viktima e gjenocidit, viktima e krimit kundër njerëzimit, kurrë nuk është e njëjtë si viktima e krimit të luftës. Kështu ta keni këtë parasysh kur flasim se duam t'ua kthejmë viktimave dinjitetin, kjo assesi nuk do të thotë trajtim i njëlojshëm i viktimave. A duhet tani ta shikojmë këtë iniciativën tonë si diçka të rrezikshme për disa viktima. Ky është tentim i shoqërisë civile të përgjigjet në atë që ka ndodhur në të kaluarën dhe të tentojmë të parandalojmë që kurrë të mos përsëritet. Dëshirojmë që të emetohen viktimat nëpër lista, që me emër dhe mbiemër të dije cilat janë të gjitha viktimat. Unë kam dëgjuar në një rast se dikush nga Kosova e gjithashtu nga Srebrenica thotë se neve nuk na duhet asgjë. Ne si viktima jemi pranuar ndërkombëtarisht dhe pikë (saktë). Viktimat shqiptare kanë njohjen ndërkombëtare. Keni në të gjithë librat e shumtë ku ceket se Serbia është përgjegjëse për vrasjen e më shumë se 10 mijë viktimave në Kosovë. Dhe kjo është vërtetë një njohje ndërkombëtare. Por nuk i keni askund të përmendura viktimat me emra dhe mbiemra. Kjo nuk është. Duke falënderuar komisionin e qeverisë së Republikës Serpska ne kemi njohje publike të viktimave nga Srebrenica. Ata kanë cekur me emra dhe mbiemra 8 mijë viktima në raportin e tyre. Përndryshe po të mos ishte kjo të gjitha viktimat nga Srebrenica do të ishin vetëm numër e assesi të emëruar. Kjo iniciativa jonë është tentim që ne këtu, shoqëritë civile të organizohemi, të zbatojmë këto konsultime dhe provojmë të bëjmë presion në qeveritë dhe parlamentet që të themelojnë atë komision. Ne nuk e dimë a do të mund të kemi atë fuqi që ti detyrojmë. Por besojmë se kjo është tmerrësisht e rëndësishme dhe do të bëjmë ç'mos që kjo iniciativë e jona të arrij deri në parlamente dhe në parlamente të hapen debat. Nuk do të thotë kjo se dikush do ti mbaj të dhënat, nuk do të thotë kjo se do të ekzistoj vetëm një komision qendror por kjo do të thotë se në çdo shtet ky komision qendror do t'i ketë nën komisionet e tij ose komisionet nacionale të cilat do ti mbledhin deklaratat, të dhënat the të gjitha këto do të mbeten në të gjitha shtetet, kështu që çdo shtet, çdo shoqëri do të ketë përfitim nga kjo. Do të kenë diçka që do të jetë e organizuar, do të kenë diçka që do të paraqesë kujtimet historike, që do t'i dorëzohet gjeneratave të ardhshme. Ne gjithashtu mendojmë për atë se ai komision do të kryente punë të madhe nëse evidenton, regjistron, përshkruan të gjitha llogoret, të gjithë llogorashët, të gjithë ata që i quajmë të burgosur politik. Ne tani kemi shoqata të llogorashëve të ndryshëm të cilët i kanë disa shënime të tyre por nuk ekziston asgjë publike që ju mund të merrni, ndonjë dokument, dhe tani të thoni ja kanë qenë të burgosur këtu e këtu, kaq e kaq. Nuk ka dokumente të tilla. Kjo është tmerrësisht e rëndësishme. Është e rëndësishme për shkak të ndalimit të ndonjë krimi të mundshëm të luftës në të ardhmen. Është e rëndësishme për historinë, është e rëndësishme që historia të jetë e shkruar në bazë të fakteve dhe në këtë është iniciativa jonë. Kjo është diçka që ne tani do ta bëjmë në ndonjë nivel politik. Ndoshta, në të vërtetë ky është niveli më i lartë politik por nëse e ka parasysh formimin e ndonjë të ardhme demokratike, por kesi të ardhme demokratike dhe shoqëri demokratike nuk ka përderisa ky libër i së kaluarës nuk lexohet në një mënyrë objektive, të paanshme, të saktë, të baraspeshuar dhe t'i len asaj së kaluarë një shënim të qartë zyrtar, të saktë për atë që ka ndodhur. Natyrisht se shumica pyeten dhe thonë se a është e mjaftueshme që vetëm ne të dimë çfarë ka ndodhur. Pastaj thonë se është e rëndësishme të përgjigjemi edhe në pyetjen se pse ka ndodhur, si ka

ndodhur, cilat janë shkaqet, cilat janë ato shkaqe që kanë sjell deri te ajo. E, për këtë shërbejnë këto konsultime që të bisedojmë për të gjitha këto pyetje kontestuese.

Do të thotë, në fund dua të përmbyll që të mbetet më shumë kohë të bisedojmë për këtë. Do të thotë ne nuk jemi adresa që ju të na thoni – ju atje gjykoni në vend se kriminelët t'i sillni këtu. Ne pra do të thotë nuk jemi pushtet, as pushteti në Kosovë as pushteti në Serbi, as pushteti në Bosnje e Hercegovinë, por ne të gjithë i përkasim kësaj kategorie të aktivistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe duhet të pranoni se në vitet e kaluara kemi bërë diçka që asnjë pushtet nuk e ka bërë. Dhe ja, aty sot janë disa të burgosur politik. Ne nuk kemi mundur që t'i lirojmë nga burgu në Serbi edhe pse e kemi ditur se ata janë burgosur për shkaqe politike, po të mos ishte fajësia e tyre, por e vetmja që kemi mundur disi është që i kemi vizituar, që letrat ti marrim disi dhe ti dërgojmë në Kosovë, që të shkruajmë për atë që ata janë të burgosur dhe se ata janë të burgosur politik. Por nuk kemi mundur ti lirojmë, sepse ne as nuk jemi gjykatë, as nuk jemi pushtet, por kemi mundur të kërkojmë dhe kemi kërkuar publikisht që ata të lirohen. Gjithashtu ne tani nuk mund të shkojmë dhe të gropojmë, të gërmojmë dheun dhe të kërkojmë varreza masive, por çka mundemi. Siç kemi vepruar gjer tani, kemi arritur gjer te të dhënat për varrezat masive, i kemi paraqit ato të të dhëna, kemi bërë presion. Nganjëherë kemi pas sukses, nganjëherë jo. Ju të gjithë e dini si kur ne flasim për Maçkaticën. Për Maçkaticën flasim që 3-4 vite, kemi shkruar shumë herë por nuk kemi arritur t'i detyrojmë pushtetarët. Por prandaj besoj se kjo iniciativa jonë, edhe pse shpesh e përmendim në konsultime dhe themi ju lutem në Serbi ekziston Maçkatica, duam të vërtetën, prej nga janë sjell ata trupa atje. Çfarë ka ndodhur me ata trupa, kush ka vendosur për atë. Kjo është një gjë e rëndësishme. Nëse e arrijmë këtë, atëherë kjo tregon se nëse insistojmë, nëse kërkojmë, nëse jemi këmbëngulës mund të arrijmë diçka. Kështu që ju lutem të keni parasysh këtë që e ka thënë Shukrija, këtë që e kam thënë unë dhe që këto iniciativat tona, nëse flisni për to flisni në kontekstin e disa nevojave dhe pritjeve tuaja. Nëse ju keni iniciativë më të mirë ju lutem po kjo është aq e rëndësishme, hajde që të kemi sa më shumë iniciava ka kështu që ndoshta mund të ndihmojmë më shumë, gjë që është qëllimi i të gjithë neve. Që të dimë saktë çka ka ndodhur, t'i emërojmë kryesit dhe të jemi të sigurtë se në gjeneratat e ardhshme kjo nuk do të ndodhë. Ja unë më vonë ndoshta do të kyçem përsëri por tani dua të kemi atë kohë, dhe ja po shof se zotëri Halit Berisha është i padurueshëm që të flasë.

Shukrije Gashi: Po, s'ka problem. Faleminderit, Natasha. Ashtu siç e thash edhe më herët dhe siç e theksoi zonja Kandiç, ne më vonë do të përgjigjemi në shqetësimet tona të ndërsjella për arsye se këto na përkasin të gjithë neve. Tash në vazhdimësi do t'ia jap fjalën zotëriut Salem Çorbo nga Shoqata Kthimi dhe ekzistenca e qëndrueshme që edhe ky të ndajë përvojën e tij dhe pikëpamjet e tij përkitazi me këtë çështje.

Salem Çorbo: Unë gjithsesi ju përshëndes të gjithëve dhe keni dëgjuar se vij nga Bosnja dhe Hercegovina, nga Bjelina. Jam i informuar se edhe në Kosovë shënohet 9 maji dita e fitores mbi fashizmin dhe e shoh ditë të përshtatshme për këtë lloj bisedash dhe ju uroj të gjithëve së bashku këtë festë. Unë vij nga një organizatë joqeveritare e cila në mënyrë shumë praktike që disa vite merret me të gjitha aspektet e problemeve, krimeve të luftës, trajtimin e viktimës dhe problemeve të tyre. Dhe për këtë unë veproj në Bjelinë, dhe përafërsisht me kthimin në Bjelinë në vitin 2000 ne kemi filluar të merremi me këtë. Ky është tërë spektri i aktivitetit të cilin dikush duhet ta përpunojë, që të nxirren regjistrat e vërtetuara të krimeve të luftës, nga vërtetimi i rrethanave nën të cilat kanë ndodhur para

së gjithash vrasjet, dhe format e tjera të thyerjes së të drejtave njerëzore ndërkombëtare, gjer te kryesi, gjer te tentimet për të ardhur gjer te ata që i kanë bërë, gjer te varrezat masive ku kanë qenë trupat, apo, të larguar, gjer te ekshumimi të cilëve do tu ndihmojmë që e vërteta të vijë sa më shpejtë e edhe familjet të vijnë gjer te më të dashurit, pastaj riekshumimi sepse një numër i njerëzve është varrosur në shpejtësi në kushte të luftës, pa përcjellje... obduksion. Do të thotë ata janë varrosur sikur të kishin vdekur në mënyrë të natyrshme dhe kështu janë evidentuar në të gjithë librat. Do të thotë ky është proces i riekshumimit dhe pastaj shkon puna e identifikimit, shkon puna e bashkëpunimit me të gjitha organet e hetuesisë, pastaj ... reparacionit qoftë material qoftë jo material, bashkëpunimi me NDP... respektivisht më falni me UPI-në rreth identifikimit, bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar rreth statusit të të llogorashëve të shtypurit (utepana) dhe fatit të tyre. Një punë shumë, shumë të madhe e ka udhëhequr organizata joqeveritare në kushtet dhe në mesin ku akoma janë në pushtet ata njerëz të cilët në periudhën nga 92. gjer 95. kanë qenë në krye të të gjitha funksioneve të rëndësishme. i njëjtë është shefi i policisë, i njëjtë është prokurori publik, të njëjtë janë njerëzit e sigurimit shtetëror, kryetari i atëhershëm i komunës tani udhëheq direktoratin për zhvillimin e qytetit. Flas për një gjendje jashtëzakonisht të vështirë në Bosnje dhe Hercegovinë, kjo situatë është në Bjelinë e nuk është aspak më e mirë as në meset tjera. Atë që dua të them unë janë tri arsye kryesore të cilat e kanë udhëhequr organizatën time që t'i bashkangjitemi këtij koalicioni, të sjellim qeveritë, shtetet, politikat e këtij regjioni që më në fund ja pas 10 vitesh këtu dhe 17 vitesh në Bosnje dhe Hercegovinë dhe të tjerëve të arrijnë gjer në atë nivel që me ato mekanizma të cilët ata i posedojnë krahas ndihmës së madhe të sektorit civil iu mundësojnë para së gjithash personave të zhdukur, vërtetimi i saktë me fotografi se çka ka ndodhur, emërtimi i njerëzve të cilët kanë udhëhequr dhe ata që kanë prirë në kryerjen e krimeve masovike. Do të thotë këto tri ... unë i kisha emëruar këtë me drejtësi. Kjo është drejtësia më e fortë në Bosnje dhe Hercegovinë edhe pse është reformuar, as për së afërmi nuk ka kapacitet për nevojat për të cilat Bosnja dhe Hercegovina i ka dhe do të përsëris shkurtimisht më shumë se 100 mijë të vrarë, 13 mijë të zhdukur, 2,5 milion të dëbuar prej të cilëve një milion presin të kthehen në Bosnje dhe Hercegovinë, dhjetëra mijëra njerëz të cilët kanë kaluar nëpër të gjitha llogoret janë në shpatullat më të forta të drejtësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës pasi që edhe vet e dimë se Haga tani pret edhe dy të akuzuar, përafërsisht e përfundon atë pjesë. Atë barrë kurrë drejtësia e Bosnjës dhe Hercegovinës nuk do të mund ta mbajë, nuk do të mund ta plotësojë. Edhe një gjë, ky është fragmentim me të cilin ata merren me viktimat. E ata edhe më tutje mbeten kryesorët, absolutisht rruga kryesore në trajtimin dhe ndihmën e viktimave, do të thotë në plotësimin e drejtësisë dhe në dënimin e atyre që e kanë kryer atë. Por mendoj se dëshmitarët e kohës, nuk do të mund as për së afërmi ta plotësojnë këtë funksion. Do të thotë kjo drejtësi në Bosnje dhe Hercegovinë edhe pse bën mjaft përpjekje, veçanërisht prokuroria shtetërore dhe gjykata. Në entitetet ... as ka shumë më pak dhe mund të ju them se prokuroria e qarkut të Bjelinës e cila e përfshinë territorin e Srebrenicës, Bratunicës, Zvornikut, Skelanit, Kravicës, Bjelina nuk e ka ngritur asnjë akt padi për krime të luftës. Ai njeri ka qenë prokuror ushtarak në kohën e zgjedhjes atë çështjes së Srebrenicës dhe atëherë ai ka ngritur disa qindra kallëzime kundër Boshnjakëve. Dhe sipas tyre edhe tash ato kallëzime procesohen. Duket e pabesueshme por për afërsisht kjo është ajo gjendje që është në Bjelinë. Theksi tjetër i rëndësishëm i cili organizatën time ... e ka tërhequr në koalicion, është qasja e qëndrimit të pushtetit

ndaj viktimave. Me kalimin e kohës në Bosnje dhe Hercegovinë , viktimat janë gjithnjë e më të vetmuara, më të paafta, të gjitha janë të harruara. Unë kisha thënë që nëpër të gjitha pyetjet. Themi ne e kemi ligjin për personat e zhdukur në nivelin shtetëror ... vitin e tretë i cili është përshkruar në një standard të Evropës dhe ai absolutisht nuk po zbatohet, në asnjë segment. Pushtetet janë shumë rehat, aprovojnë ligje aq të rëndësishme dhe pastaj nuk i zbatojnë. Format e reparacionit. Përparësi e shumëfishtë i është dhënë popullatës luftarake, gjë që unë edhe e kuptoj, por absolutisht padrejtësisht është neglizhuar popullata e viktimave, familjet e viktimave, posaçërisht nëse janë vrarë ushqyesit e familjes, ata të cilët i kanë mbajtur familjet dhe kështu familjet kanë ardhë në situata jashtëzakonisht të rënda dramatike. Do të thotë pushtetet, me kalimin e kohës, fjalimet janë gjithnjë e më deklarative, vetëm kohë pas kohe, në rastet e tubimeve dhe festave të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe nuk e di gjendjen këtu, shoh njerëz nga pushteti këtu, nga strukturat shtetërore dhe do të ketë rast që edhe unë të dëgjoj diçka për këtë besoj dhe me siguri të plotë vërtetoj se politikat i kanë ngritur duart sepse kanë punë më të rëndësishme. Pjesa e tretë është se e gjithë ajo punë bie në barrë të shoqatave, të cilat janë gjithashtu të vetmuara, dhe gjithnjë e më shumë të paafta, pa përkrahje të përshtatshme materiale, pa mjete të përshtatshme, pa kuadro të përshtatshme. Njerëzit lodhen kur bëjnë punë të pavlerësuar. Nëse ju që pesë vite punoni me organet e hetuesisë dhe nuk ka asnjë akt padi, e dini, ju pastaj vështirë e keni të silleni thjeshtë me atë popullatë. Njerëzit ju pyesin çka do. Mendoj, kam shkuar pesë herë të dëshmoj. Raporti ndaj dëshmitarëve, kam harruar të them. Tri marka është një shujtë të cilën e paguan drejtësia e Bosnjës dhe Hercegovinës nëse dëshmitari vjen nga Bjelina në Sarajevë. Nuk pranohen shpenzimet e rrugës. E dini, deklarativisht të gjithë dëshirojnë që të dënohen fajtorët, por në praktikë shumë kryejnë obstrukcione të formave të ndryshme, hedhin poshtë, të gjitha përpjekjet e sektorit joqeveritar dhe do ta keni shumë të qartë nëse ju kujtohet ajo që në fillim i kam emërtuar njerëzit në Bjelinë, që janë absolutisht të njëjtit njerëz që kanë qenë në periudhën nga 92 gjer 95. në vendet më të rëndësishme nga policia. Dhe gjëja e katërt, të cilën dëshiroj ta them edhe këtu të jem i shkurtër, është qasja rajonale. Pse qasja rajonale? Ne disa herë jemi përpjekur të fitojmë komisionin komunal për të vërtetën dhe pajtimin dhe e kemi fituar. Në Bjelinë ekziston parlamenti lokal dhe kjo ka qenë mirë, dhe pastaj, e dini çfarë ka ndodhur, pushteti si gjithnjë ka befasi, të talentuar për befasi të pakëndshme. Në komision zgjedhin njeriun i cili ka qenë komandant i llogorit në Batkoviç, pranë Bjelines. Dhe ai i pamundëson të gjitha Institucionet dhe shoqatat që të pranojnë nënçmimin e tillë, që të marrin pjesë në punën e atij komisioni. ... kur është absolutisht e rëndësishme kjo lidhshmëri, unë nuk e di, mundeni energjikisht... ku janë trupat e këtyre të zhdukurve nga këtu, ku janë njerëzit që i kanë bërë këto. Sigurisht nuk janë në domenin e shtetit të Kosovës, kështu që këto janë arsytet të cilat na kanë përcaktuar mua dhe organizatën time që të marrim pjesë në koalicionet dhe që nga Bjelina të vij këtu dhe vetëm që t'i ndaj këto qëndrimet tona. Natyrisht çdo gjë mund të kalojë në ndonjë tjetër ... prandaj unë do të kisha dashur që të gjithë vetëm çka dimë dhe shoh dhe kemi përvojë të mirë në udhëheqjen e organizatave të cilat merren me problemet dhe statusin e viktimës. Përsëris, në fokus të të gjitha këtyre aktiviteteve duhet të jetë viktimat. Absolutisht, viktimat. Jo kështu si e bëjnë në politikë, jo kështu si e bëjnë në drejtësi për shkak të kapaciteteve të veta të pamjaftueshme, jo kështu si mundemi ne si shoqata ... të themi kemi arritur gjer te kufijtë tanë, më nuk mundemi. Mendoj se është një hap para të gjithave, do tu kisha thënë edhe udhëheqësve të shtetit se mund tu

mundësoj, së paku viktimave në hapësirat e ish Jugosllavisë atë një satisfakcion i cili na është më se i nevojshëm. Ju faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit zotëri Çorbo! Tash do të vazhdojmë me një pauzë të shkurtër. Falënderojmë shumë që keni ardhur për t'i kontribuar këtij këshillimi. Faleminderit!

(Pas pauze)

Shukrije Gashi: Faleminderit për vëmendjen! Do të vazhdojmë përsëri me përfilljen e agjendës. Tash me radhë është një lloj rotacioni përkitazi me prezantimin që u bë deri më tani... dhe drejtësia tradicionale, mekanizmat, përgjigje e pyetje për të cilat kujtoj se ju mbetëm borxh por tash do të vazhdojmë me përgjigjet. Jeni të ftuar të gjithë ju, secili prej jush që ka ndonjë shqetësim, ka ndonjë ide tjetër rreth kësaj iniciative, rreth modelimit dhe çdo tjetër që lidhet me këtë këshillim jeni të mirëseardhur, të shtoni pyetje dhe të komentoni. Ju kisha lutur që të gjithë të jemi racional në qasje për shkak të respektimit të agjendës dhe mundësisht të ngelemi në kornizat e agjendës, të mos dalim e debatojmë për çështje të cilat nuk janë pjesë e këshillimit të sotëm. Faleminderit për mirëkuptim!

Haki Kasumi: Faleminderit, kryesi e nderuar që ma dhatë fjalën. Unë jam Haki Kasumi, koordinator i Këshillit koordinues të 21 shoqatave të të zhdukurve të Kosovës. Më duhet në fillim që të prezantoj dhe të përsëris qëndrimin e Këshillit koordinues rreth iniciativës të cilën në fillim e kemi vlerësuar si pozitive, si të dobishme dhe me interes të përgjithshëm, por marrë për bazë gjendjen në të cilën ndodhet Kosova dhe raportet e saj me Serbinë prej nga na ka ardhur kjo iniciativë, ne e kemi marrë me rezervë dhe e marrim edhe sot e kësaj dite dhe e analizojmë. Unë vetëm do të përkujtoj panelistët dhe organizatorët e kësaj konsulte se në konsultën e kaluar paraprahe, të mbajtur në Mitrovicë, është marrë një qëndrim dhe ka hyrë, sa më kujtohet mua, edhe në konkluzë që Kosova dhe sidomos Shoqëria civile, organizatat që janë të thirrura të flasim për këtë çështje janë të interesuara, e mbështesin iniciativën për formimin e një komisioni në nivel të Kosovës dhe ai komision do ta bëjë punën e vet, do ta ngrisë çështjen në shkallën e duhur dhe pastaj, udhëheqësit të cilët do të krijojnë përvojë do të krijojnë njohuri për problemin, do marrë edhe qëndrime dhe do të zgjerojë bashkëpunimin me ato vende me të cilat sigurisht do të shohin të arsyeshme se kanë nevojë të bashkëpunojnë. Lus organizatorin dhe panelistët që në konsultat tjera të kenë shumë kujdes kë po e angazhojnë që ta menaxhojë gjegjësisht ta udhëheqë një konsultë të tillë. Unë vetëm po e përmend një shembull që për ne aktivistët e shoqatave të të zhdukurve, prezantuesi nga Vushtrria për ne është njeri i panjohur, është anonim. Më vjen keq, sepse edhe me vonesë, por nuk e dëgjova prezantimin e tij, por për përvojën tonë si Këshill, për njohuritë tona me të cilat përballemi tash e dhjetë vite nga përfundimi i luftës në Kosovë, Avni Melenica nuk e di kë e përfaqëson. Për informimin tuaj, po ju them se në Vushtrri punon një aktivist shumë i mirënjohur në nivel të Kosovës – Sabit Kadriu, i cili ka një bagazh, një të kaluar dhe njohuri e është personalisht i goditur gjithashtu. Pastaj është anëtare e Këshillit koordinues, një aktiviste tjetër, gjithashtu familjare e goditur, Lutfije Behrami të cilën nuk e di se organizatori a e ka ftuar fare. Ju lutem me imponim të njerëzve të tillë të pa informuar për ne, një gjë e tillë, është e papranueshme dhe ne na irriton që në takimet e ardhshme vërtet ta konsultojmë këtë çështje dhe përgjigjen në pjesëmarrje në këshillimet e ardhshme të ngjashme rreth kësaj iniciative. Për ndryshe, ju lutem, ju lutem edhe një herë, sepse nuk janë të përfaqësuar të gjitha shoqatat dhe njerëzit përgjegjës të cilët kanë kredibilitet, kanë njohuri dhe kanë të drejtë të flasin për problemin, për çështjen, për iniciativën dhe idenë e formimit të një komisioni shumë të rëndësishëm normal pozitiv me

të cilin gjithsesi ne si shtet i ri do të duhej të përballemi dhe për të cilin kemi nevojë dhe duhet ta mbështesim nga të gjitha nivelet. Po më duket se po politizohet pak si tepër mbështetja formale dhe më tepër, do të thoja, ndoshta edhe individuale e përfaqësuesve të institucioneve tona. Ju lutem, unë konsideroj se një pjesë e madhe e pushtetarëve tanë, çdo respekt për pozitën që e kanë, por përvoja e tyre e përballjes me dhimbjen e popullatës së Kosovës nuk është në nivel të detyrës së tyre, nuk është përgjegjësi dhe nuk është për t'u falënderuar, prandaj ne kemi përcjellur te pushtetarët tanë sugjerimin, kritikën dhe kërkesën tonë që të kenë kujdes çfarë dhe kë po e mbështesin, qysh janë mësuar ata, formalisht nga se po i dëmtojnë proceset, po e dëmtojnë aktivitetin humanitar dhe po e lënë të hapur dhe po e prekin plagën e cila lende është duke rrjedhur, duke kulluar që nga përfundimi i luftës. Për fillim, unë kaq. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit, Haki! Po, Avni, do ta marrësh fjalën. Edhe një herë, dua të theksoj se këtë që e tha Hakiu, me të vërtetë ka ton shqetësues dhe ne kemi mirëkuptim për shqetësimin tuaj. Unë e thash, më duket, edhe në fillim që nëse dikush e ka pronësinë e kësaj fushe, atëherë këtë më së shumti e kanë viktimat dhe pikërisht ky këshillim është organizuar për këtë. Ne, të cilët e kemi marrë radhën e organizimit të Këshillimit, këtë e bëjmë në kuadër të misionit të organizatave tona veç e veç. Edhe atëherë e thash, dhe po e përsëris: unë nuk pretendoj dhe asnjëherë s'kam pretenduar që t'i përfaqësojë viktimat, assesi. Por, e drejtë e imja individuale dhe si organizatë është që t'i bashkëngjitem apo mos t'i bashkëngjitem një iniciative. Dhe, e di pse! Për arsye se jam aktiviste për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ky është mision i imi. Në momentet e caktuara, kur unë do të takohem me të pavërtetën, me dëmtimin e ligjit të viktimave, me dëmtimin e imazhit të qytetarëve të mi – të Kosovës dhe njerëzve e qytetarëve të tjerë kudo qoftë, në botë dhe në rajon, unë atëherë do ta them publikisht dhe do të tërhiqem. Derisa konsideroj dhe nuk kam pa diçka të tillë, unë do të jem pjesë e iniciativës. Do të jem pjesë e iniciativës. Sa i përket përgjigjes së Melenicës, zotëriut Melenica, unë do ta jap fjalën. Është e drejtë elementare e secilit që të shpreh dhe thotë mendimin e vet. Faleminderit.

Avni Melenica: Edhe një herë po prezantohem. Jam Avni Melenica, vije prej Shoqatës së familjarëve dhe personave të zhdukur në Vushtrri “22 maji”. Sa i përket asaj që tha zotëriu Kosumi, vetëm mund t'i them se nëse ai e përfaqëson dikë, nuk e di qysh mundesh të mos më njohësh mua kur i kam pesë anëtarë të zhdukur, sigurisht. Në rajon timin janë 68 të zhdukur, përfshirë këtu edhe nja 4 persona që janë jo më “22 maj” në Vushtrri. Dikush e ka bërë një pyetje më përpara dhe kjo të dihet. Përndryshe, personave që iu referohet personave zotëriu Kosumi, Sabit Kadriut dhe Lutfije Behramit, këta dy persona janë dy persona të cilët kanë refuzuar të dëshmojnë në Beograd ku kam dëshmuar unë. Këta janë persona të cilët mund t'i quaj destruktivë, qysh po të quaj edhe ty, me keqardhje. Po më vjen shumë keq, por këtu nuk ka vend për destruktivitet. Secili fundi i fundit i jep idetë dhe mendimet e veta personale. Për më shumë, nëse nuk keni dijeni për rastin e “22 majit” mundesh të klikosh “22 maji.com”, i ke të dhënat të sakta, me biografi, me fotografi të 68 personave të zhdukur. Kaq, s'po dua të hy më thell. Këto janë çka desha të them.

Haki Kasumi: Kur e ke regjistruar këtë shoqatë? Dhe, faleminderit shumë për informatën kur the se je dëshmitar i proceseve të Beogradit.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Avni! Unë konsideroj, thash edhe më herët dhe po e përsëris: Ju falënderoj të gjithëve që keni ardhur këtu. Ju kisha lutur edhe një herë që të gjithë ne, që kemi ardhur këtu, të përpiqemi të bashkëbisedojmë në kuadër të agjendës, rendit të ditës, në kuadër të kornizës së paraparë me rendin e ditës, për shkak të racionalitetit me kohën dhe qëllimit të këtij këshillimi. Faleminderit për mirëkuptim! Avni, të kisha lutur mos me përdorë

shprehje të vrazhda, sepse nuk ka nevojë, meqë këtu nuk jemi për vrazhdësi por e kemi një mision të qartë.

Avni Melenica: S'ma merr mendja se është shprehje e vrazhdët, por më tepër janë të vrazhdët njerëzit. Problemi i regjistrimit, sepse unë po e di pak a shumë me çfarë direktiva është ardhë... Unë jam regjistruar, ka dy muaj, si organizatë sepse po dua t'i përfaqësoj këta njerëz si organizatë dhe po dua t'i ndihmojë diçka, jo si një person, por si një shoqëri, si organizatë.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Avni! Ju lutem a dëshiron ndokush të merr fjalën?

Eli Krasniqi: Ok. Kryesisht është fakt, po s'po mundem me thënë që po më pengon kjo farë jo dashamirësia për shkak se pa e qel diskutimin përpara po personalizohet muhabeti, që konsideroj nuk i ndihmon as neve as askujt hiq. Desha të bëj një pyetje lidhur me mbështetjen e Qeverisë dhe sa është reale ajo mbështetja e Qeverisë meqë e kam përshtypjen se shumicës së njerëzve këtu po e bren ajo mbështetja e qeverisë. Ne jemi mësuar me fjalën dhe qeveria ndoshta mbështetjen reale kishte me tregua në hapa konkretë, të cilët ka dështuar t'i bëjë deri tash. Dhe, tjetra, është se jam përpjekur disa herë me kuptua në aspektin sociologjik hezitimin ose mos hezitimin për me iu bashkëngjitur një iniciativë të tillë dhe disa herë po bie se duhet njëfarë njohjeje për viktimat, pastaj ka tendenca me u përmirësua, me marrë pronësinë mbi viktimën dhe çështje tjera, por nuk dëgjova deri tash ndonjë arsye. Kjo kishte me qenë edhe e formuluar ndoshta si pyetje: Cilat janë arsyet konkrete për mos bashkëngjities kësaj iniciative? Sepse deri tash dëgjuam pse me iu bashkëngjitur, por cilat janë tash arsyet pse mos me iu bashkëngjitur. Kjo është.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Eli! Meqenëse këtu kemi përfaqësuesit e Qeverisë, unë nuk do ta marr atë të drejtë në pyetjen e parë, por nëse ka nevojë me dhënë mendimin në pikëpamjen time personale, do ta jap më vonë. Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë.

Kushtrim Gara: Përshëndetje, të gjithëve! Unë quhem Kushtrim Gara. Vi nga Komisioni qeveritar për persona të pagjetur. Domethënë, jam udhëheqës i zyrës në kuadër të këtij komisioni qeveritar. Nuk e di tash sa do të kishte vlerë fjala ime, duke pasur parasysh atë përkrahjen që ka dhënë Presidenti i Kosovës, zotëri Fatmir Sejdiu, Kryeministri Thaçi, ministrja e Drejtësisë, zonja Nekibe Kelmendi, pastaj edhe vetë kryetari i Komisionit qeveritar, zoti Pren Gjetaj, i cili, siç jeni njoftuar, ka marrë pjesë thojë në të gjitha takimet këshilluese që janë mbajtur. Përkrahja e Qeverisë, po e ceku, brenda mundësive, sepse fillimisht duhet cekur se kjo është një iniciativë e Shoqërisë civile, do të jetë e pa kontestueshme. Domethënë, gjithmonë do të jetë në përkrahje të Qeverisë së Kosovës, e në këtë rast e Komisionit qeveritar për persona të pagjetur në të gjitha iniciativat që do t'i kontribuonin zgjidhjes së fatit të personave të pagjetur. Ky është një preokupim i mbar shoqëror, është një prioritet edhe i Qeverisë së Kosovës. Me vetë faktin se është prioritet i Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës me vendim të Kryeministrit ka themeluar Komisionin qeveritar për personat e pagjetur. Me vendim të Kryeministrit, vitin e kaluar në dhjetor të 2008, Qeveria e Kosovës ka miratuar një strukturë të re, me staf të shtesë, domethënë ka ngritur kapacitetet brenda zyrës së komisionit qeveritar të personave të pagjetur dhe do të avancojë atë kjo zyre deri në një nivel më të lartë qeveritar.

Eli Krasniqi: Sa persona të zhdukur janë gjetur deri tash, me krejt këto përpjekje.

Kushtrim Gara: Kështu! Mandat i Komisionit qeveritar për personat e pagjetur, fillimisht është koordinimi i të gjitha organizmave qoftë qeveritare, qoftë ndërkombëtare, qoftë vendore në punën e zbardhjes së fatit të personave të pagjetur. Komisioni është komision ndërministror ku bëjnë pjesë një numër i madh i ministrive që janë pjesë e Qeverisë së Kosovës. Kemi bashkëpunim të ngushtë me Komisionin ndërkombëtar për persona të pagjetur. Bashkëpunim

të ngushtë kemi me Zyrën për mjekësi ligjore dhe për persona të zhdukur. Bashkëpunim të ngushtë po ashtu kemi me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me shoqatat e familjarëve dhe personave të pa gjetur. Duhet pasur parasysh se janë dhjetë vite që kur ka përfunduar lufta dhe njëri nga sfidat me të cilat ne po përballemi sot është mungesa e informatave, por me një koordinim dhe me një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha këto organizma që unë i ceka ne jemi duke bërë maksimumin e mundshëm në zbardhjen e personave të pa gjetur. Është mirë gjithnjë të bëjmë krahasime midis asaj që është bërë dhe asaj që ka mund të bëhet e nuk është bërë. Dhe nuk është mirë të bëhet krahasimi midis asaj që është bërë dhe çka është dëshiruar për të bërë. Dëshirat e të gjithë neve është që fati i personave të pagjetur të zgjidhet qysh sot. Por në të njëjtën kohë duhet pasur parasysh edhe mundësitë për zbardhjen e fatit të këtyre personave. Për momentin, kemi më shumë se 1.900 persona deri në 2.000 që konsiderohen si persona të pagjetur. Po në të njëjtën kohë, duhet cekur se çdo ditë punojmë, çdo ditë ka raste kur kemi identifikime, çdo ditë punohet në zhvarrosje të reja, në dorëzim të trupave tek familjarët dhe çdo ditë punohet në kërkim të vendvarrimeve të reja, në kërkim të informatave apo informacioneve se ku janë këta persona. Vazhdohet bashkëbisedimi me palën në Beograd në kuadër të grupeve punuese, i cili është nën menaxhimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Ka qenë e diskutueshme edhe pjesëmarrja jonë në këto takime të grupit punues, mirëpo duhet cekur se për momentin ndoshta është e vetmja dritare shprese nga e cila ne mund të marrim informacione. Kaq për fillim.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Kushtrim! Veç diçka shkurtimisht, Natasha!

Natasha Kandiç: Vetëm të shtoj në shpjegimin e Kushtrimit. Mendoj se në këtë moment ne nuk kemi kërkuar kurrfarë përkrahje politike për formimin e komisionit, kështu që kjo do të vijë pas dy vitesh. Ne si lëvizës, si anëtare të koalicionit, kërkojmë nga politikanët përkrahjen për atë iniciativë në nivel, do të thotë të bashkëpunimit rajonal, në nivelin e qasjes rajonal në këtë aspekt në mes të tjerash edhe të të zhdukurve dhe në vërtetimin (verifikimin) e të dhënave për krimet e luftës. Kjo për fillim është diçka e rëndësishme dhe e mjaftueshme. Tek pasi që ti kryejmë këto konsultime, kur ne e formojmë një model të komisionit, do të thotë ne, shoqëria civile, ne pastaj do të shkojmë nëpër Qeveri dhe parlamente dhe pastaj vjen ndonjë vendim i vërtetë për këtë. E gjer atëherë, gjatë tërë kohës, është në pyetje një iniciativë civile dhe për ne është, vërtetë, e rëndësishme një përkrahje për këtë iniciativë, kurrfarë vendimmarrje, nuk flitet për asgjë, për kurrfarë vendimmarrje.

Halit Berisha: Unë jam Halit Berisha, nga Shoqata „Shpresimi” në Suharekë. Unë jam i lumtur për një çështje sot, kur para një motmot e gjysmë, në Suharekë, në restaurantin “Rozafa” me drejtoreshën e Fondit, i kam thënë se gjykimi në Beograd është farsë. Edhe kjo është vërtetuar në fjalimin e kryetarit të Kosovës në Meje, ku ka thënë se gjykimi në Beograd është farsë. Unë tash jam shumë i lumtur që supozimi im para një motmot e gjysmë është bërë realitet, që e ka përkrahur edhe kryetari i Kosovës. Sepse, unë nuk e di që kur flet zonja, thotë se nuk mund të fajësohet Serbia. Serbia ka qenë shtet i organizuar, me Qeveri, me të gjitha dhe me zinxhirin komandues i ka kryer të gjitha krimet të cilat janë bërë në Kosovë. Për atë arsye ajo duhet të dënohet si shtet e jo të dënohen personat të cilët në rastin e gjykimit në Beograd unë nuk kam shkuar. Nuk kam shkuar për këtë arsye: i kam thënë se atë gjykatë nuk e njoh. Nuk kam besim se në atë gjykatë me kolegjin e gjykimit, me prokurori, nuk është dikush që nuk e njoh që ka qenë në zinxhirin komandues të krimeve të cilat janë bërë në Kosovë dhe sot unë nuk e jap betimin para asaj gjykatë. Dhe pyes: Pse ajo, zonja drejtoreshë, kallximin penal nuk e ka bërë në Gjykatën e Prizrenit që i takon rrethit të qarkut Suharekë-Prizren dhe ato dokumente me i dorëzua në gjyqin e Prizrenit po i ka dorëzuar në Beograd. Dhe, athua do të

jetë qendra e botës Serbia që të gjitha krimet të cilat janë zhvilluar në Kosovë duhet të gjykohen në Beograd. Për atë arsye nuk kam shkua. Unë kam qenë 3 herë në Hagë, por kam shkuar në Hagë për arsye se atje ka qenë një gjyq ndërkombëtar. Edhe të gjitha gjykimet, unë kam thënë, të bëhen në Kosovë, të gjykojnë ndërkombëtarët dhe të gjithë ata duhet të vijnë në Kosovë. Pak para do dite, e lexova unë në gazetë se në Kroaci janë gjykuar edhe në mungesë. Në mungesë për atë arsye se shpallet fletë arresti për ata kriminelë të cilët janë aty dhe ata nuk mund të lëvizin prej Serbisë se duhet me ndejt aty, ose kanë me i pru në Kosovë. Për këtë çështje unë, drejt me thënë, tash jam i lumtur sepse ia kam qëllu para një motmot e gjysmë. Për çështjen e saj, unë kam marrë ftesën prej Qendrës për administrimin e konflikteve që të marr pjesë në këtë tryezë. Po këtu shkruan dhe thotë: këshillime me Shoqërinë civile mbi themelimin e komisionit rajonal. Unë plotësisht e përkrah kryesuesin e Këshillit koordinues dhe njëkohësisht përkrah propozimin e Këshillit për mbrojtjen dhe liritë e drejtave të njeriut, e unë nuk po i shoh ata këtu, që kanë thënë të formohet një komision nacional në Kosovë, a Fondi është me zyre në Beograd dhe i takon Serbisë. Dhe, nuk ka punë me neve! **Ai komision nacional i cili do të bëhet edhe me ligj, e ne shumë shpejt në Këshillin koordinues do t'i adresojmë një letër kryeministrit dhe kryetarit të Kosovës dhe kësaj Ministrisë për Drejtësi që ai të formohet këtu, prej kujt të formohet dhe ai komision le të urdhërojë dhe bisedojë me themeluesit të cilët janë Fondi për të Drejtat Humanitare, ajo në Kroaci dhe në Bosnjë. Ata le të bisedojnë me ta se cilat probleme ne duhet t'i zgjidhim. Përndryshe, ne shoqatat, nuk do të bashkëpunojmë.** Edhe një çështje tjetër që kur e kam marrë e kam lexuar këtë farë historikun e saj, deklaroj se, thotë, në grupin koordinues të konsultimeve në Kosovë është edhe "Shpresimi". S'është e vërtetë! Është vetëm një individ që është kryetari i Shoqatës Hysni Berisha, jo shoqata "Shpresimi". Shoqata "Shpresimi" nuk është, publikisht po e them unë, për arsye se familjarët të cilët kur kanë dëgju për këtë punë kanë qenë shumë të indinjuar. Për atë arsye publikisht po them se nuk është "Shpresimi". Prandaj, ne nuk do të bashkëpunojmë si "Shpresimi" kurse individët munden me shkua në përgjegjësinë e vet. Unë zotëriun e kam edhe kushëri dhe kemi punuar qe dhjetë vjet bashkë. Dhe për atë arsye, këto dhjetë vjet, automatikisht ne pikërisht për çështjen e Beogradit, meqë unë deri në momentin kur më kanë ftuar me telefon se duhet dëshmuar unë nuk e kam dit se ai bashkëpunon me Fondin, kurse unë kam qenë në Kryesinë e Shoqatës së saj, domethënë individë të tjerë. Prandaj, po them se ne si shoqata, në Këshillin koordinues i është thënë më 13 mars mirë aty për arsye se kanë marrë mendimin e të gjitha shoqatave të cilat i kemi pas në mbledhje se ne pa formimin, edhe një herë po e citoj, "e këshillit nacional të Kosovës" nuk do të bashkëpunojmë për të formuar fondin e saj. Një çështje tjetër që mua pak më brengos, është një deklaratë e një kryetari të Shoqatës së Mejës, zotëri Haki Sadriut, i cili në një mbledhje të Këshillit koordinues ka thënë, po citoj, "mu zotëri Bekim Blakaj më ka ofruar një zarf me 7.000 dollarë për me ia dhënë listën e personave të zhdukur të Mejës që ne të manipulojmë me të". Kjo është fjalë e tij, jo e imja. Dhe unë tash po dyshoj, për shembull, se a mund të korruptohen njerëzit të cilët për shkak të hollave të bëjnë edhe çudira nëpërmjet shoqatës, pa e dit shoqata. Përgjigja e tij ka qenë: jo. Këto çështje të cilat ne po i përmendim, unë i përkrah si inicuese. Absolutisht, kur është për të mirën në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Por unë jam i indinjuar, sepse zotëriu prej Komisionit qeveritar për personat e zhdukur... Unë kam qenë anëtar i Komisionit në mandatin e zonjës Nusrete Kumnova. Por unë kam deklaruar qysh në vitin 2001 si anëtar i Shoqatës "Shpresimi" dhe anëtar i Këshillit koordinues dhe kam thënë se, nëse duhet me krye punën që me pas një numër të saktë me emër e mbiemër dhe me biografi, me emër të nënës e të babës të të vrarëve dhe të zhdukurve në Kosovë duhet të formohet një grup pune e jo komision. Edhe

sot e atë ditë, unë po deklaroj se edhe atëherë edhe sot nuk dihet numri i saktë i personave të zhdukur. Unë e kam përpara një fletë. FDH është e datës “Zëri” e 17.10.2008 dhe thotë se nga lufta e fundit në Kosovë janë 13.000 viktima. Ku e dinë këta që janë 13.000. A janë 13.001 a janë 13.005? Dhe ku i kanë marrë të gjitha këto shënime të cilat askush në Kosovë nuk e di numrin e saktë të viktimave që janë bërë gjatë luftës 98-99 në Kosovë. Prandaj, manipulimi me këto, sikur është gazeta “Zëri” e datës 17.10.2008 dhe manipulimi me këto na çon të dyshojmë për shembull edhe ndoshta në fondin për të drejtat humanitare apo një shoqatë tjetër e cila merret me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Unë kam bërë pyetje në Këshillin koordinues dhe në Komisionin qeveritar, që prej 26.12.2002 në Merdare kanë ardhur 8 kufoma të cilat ne nuk i kemi dit. Janë kthyer pa analizë të ADN-ës. Kur kemi marrë vesh për këtë, ne jemi trazuar në këshillin koordinues dhe kemi thënë se qysh bën të vinë ato pa e dit asnjëri prej Serbisë. Këto kanë ardhur prej Petrovo Sellës. Prej datës 26.11. 2002, në vitin 2002 kanë ardhur vetëm 8. Në vitin 2003 kanë ardhur 186 thasë të plasmastit, në to kanë qenë eshtrat e personave të cilët janë marrë apo të gjallë, të mbytur apo të vrarë në Kosovë për ta humbur gjurmën e krimit. Në vitin 2004 kanë ardhë, janë kthyer me data s’po i citoj, 183 thasë të plasmastit. Në vitin 2005 296 dhe i fundit kontingjent, ta quaj kështu kushtimisht, se ata janë njerëz të cilët kanë jetuar në Kosovë janë me 30 qershor të vitit 2006 kanë ardhur 120 thasë të plasmastit. Dhe unë kam pyetur, a thua dikush prej drejtësisë, prokurori apo dikush tjetër me këto të gjitha 18 kontingjente që kanë ardhur nuk është interesuar se çka ka në thasë, a janë njerëz të cilët janë mbyt dhe bile me ngrit një procedurë penal kundër NN, kundër Serbisë të cilët i kanë marrë dhe i kanë çue. Askujt s’i ka interesuar për këto çështje të cilat sot ne po i diskutojmë. E ajo ka qenë një detyrë e prokurorit, që dikush ma i madh se ai është dashur t’ia ngrehë veshët dhe me thënë – me i çu për çdo datë kur vijnë ata në Merdare në atë pranim-dorëzimin e thasëve për të mund t’u ngritë ato. Problemi tjetër është që mua më brengosë që deri më sot janë afër 100 e diçka, nuk jam i saktë me numër. Janë kallximet penale prej vitit 2001 dhe deri më sot janë pluhurosë nëpër prokuroritë në Pejë, në Prizren e diku tjetër dhe askush nuk ka qarë kokën për të mund me zhvillua procedurën e tyre. Mua më brengosë rasti i Krushës së Vogël kur ne të gjithë, të Këshillit koordinues e kemi bezin me emrat e atyre njerëzve të cilët ata i kanë njohur, vendorëve të cilët kanë bërë krime dhe atë bez e kanë pre. Nuk është interesuar askush hiq me thënë a janë të vërtetë apo jo, apo përgjegjësinë do ta marrin familjarët. Këto çështje më bëjnë me dije se dikush është duke penguar procesin e zbardhjes së personave të zhdukur, kurse ne jemi ata që i kemi mbajtur gjallë familjarët dhe Këshilli koordinues është ajo hallka e zinxhirit që e ka lidhë hallet dhe kërkesat, të gjitha ato dëshmitë e atyre familjarëve për me iu thënë funksionarëve këtë të cilët është dashur ta zbardhin këtë. Ne kemi kur më 10 prill 2003 Kuvendi i Kosovës e ka formuar një dokument i cili i obligon subjektet të cilët duhet të punojnë në zbardhjen e fatit të pa gjeturve apo të zhdukurve. Po ashtu, edhe në 2005 një deklaratë, të cilën dy herë e ka trajtuar këtë problemin e të zhdukurve për dhjetë vjet. A thua, i ka ra ndërmend dikujt, a nëpër kuvendet komunale, unë kur kam qenë anëtar i Këshillit, po mendoj i Komisionit qeveritar në një mbledhje të asociacionit të këtyre kryetarëve të komunës kam kërkuar që në një komunë a është vendosur në ndonjë rend dite një herë në motmot çështja e personave të zhdukur. E keqja më e madhe ka qenë se në komunën e Dragashit nuk ka asnjë të zhdukur, kryetari i komunës ka ardhur në mbledhje, e ku ka pas më shumë ata as s’e kanë qarë kokën me ardhë aty. Këto janë probleme të cilat grumbullohen. Por, në qoftë se nuk do pushteti, sa kemi ne mundësi shoqatat. Ne e kemi kapacitetin e vogël, edhe financiare dhe çfarë të duash, edhe kadrovik, kurse pushteti e ka kapacitetin e madh, ka pare, ka njerëz të cilët nëse duam të punojmë, për me mund bile-bile

kurgjo hiq, sot ne s'kishim me diskutua se Halit Berisha të diskutojë se në Kosovë nuk dihet numri i saktë i personave të vrarë dhe të zhdukur pas dhjetë vjete. Për këtë arsye, faji është jetim, por ne të shoqatave, ne të asociacionit të familjeve, gjithmonë do ta ngrehim zërin dhe nuk do t'i lëmë rahat deri në atë ditë kur të vetëdijesohet pushteti e thotë: pa ngadalë, si këta juristët thonë, unë nuk jam jurist, ato krimet e luftës nuk plaken, nuk vjetrohen kurrë. Edhe sot me ia nisë, për një motmot ne mund të kemi një evidencë të plotë dhe me i thënë me emër e mbiemër, jo kaq numra por emri i atij personi të cilin nuk e kemi në mesin tonë. Unë edhe një herë po theksoj: Nuk do të marrim pjesë në këtë KUMRA a si po i thonë, derisa nuk formohet Këshilli nacional që ato kërkesat tona t'ia shprehim këshillit e këshilli apo Qeveria ata ligjëson me listë aty detyrat dhe punët të cilat do t'i kryen ai këshill. Për këtë arsye ai edhe le të merret me ato të Bosnjës e shteteve tjera të cilat janë aty. Unë edhe një do ta përmendi, se harrova me thënë. Kur janë bërë, tri protokolle janë të nënshkruara në mes të UNMIK-ut dhe atij këshillit që ka qenë ai Nebojsa Çović dhe tash jo me i nënshkruar me Qeverinë e Serbisë por me obliguar qeverinë e Serbisë për këtë, por edhe atë me njëfarë të ashtuquajtur këshill për Kosovën apo din a jo, që na obligon. Dhe, për ironinë më të madhe, në nenin 10 ku bëhet fjalë për rikthimin, riatdhesimin e repatrizimit a qysh thuhet aty, duhet thotë në nenin 10 se në rastin e riatdhesimit të qytetarëve që vijnë prej Serbie nuk guxojnë me pas as mjete të informimit as nuk guxon me pas qytetarë të atyhit. Po ne, me këmbëngulje kemi shkuar dhe 17 herë kemi qenë prezentë me rastin e atyre punëve. E çka do të thotë kjo? Domethënë nuk e ka obliguar Qeverinë e Serbisë dhe thotë ai unë s'kam punë me të, sepse e ka kryer NN Çović dhe ditën e mirë, tash nuk është as ministër as kurgjo hiq. Domethënë, krejt ato kanë shkuar në një mënyrë perfide vetëm e vetëm, unë e kam bindjen, si qytetar dhe si një familjar për persona të zhdukur, si qytetar që vetëm e vetëm ta zvogëlojë çështjen e personave të zhdukur në Kosovë. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit, zotëri Halit Berisha. Këtë informacion që e dhatë, është i vlefshëm dhe konsideroj se sigurisht ekziston edhe diku tjetër, por mirë është që u tha edhe publikisht. Këto janë argumente dhe unë po përpiqem drejt ta kuptoj shqetësimin tuaj. Edhe një po e them se ne të cilët jemi si përfaqësues të organizatave joqeveritare e përkrahim iniciativën, këtë e bëjmë në kuadër të vullnetit të mirë dhe nuk pretendojmë që ta kemi të drejtën për ta përfaqësuar shtetin. Shtetet i përfaqësojnë vetëm qeveritë e shteteve, përfaqësuesit e qeverive. Kështu që është deri te individët, përfaqësuesit e shoqatave a dëshirojnë që të bëhen pjesë e iniciativës apo jo. Qëllimi ynë është që të kontribuojmë sado pak në kuptimin e drejtësisë tranzicionale në rrafshin vendor, rajonal dhe ndërkombëtar. E theksova edhe më herët se të gjitha këto rrafshë janë të kushtëzuara dhe ne, edhe një herë po e them, se nuk kemi kurrfarë përfitimi material përveç atij moral i cili është vullneti. Kurgjo tjetër nuk ka këtu.

Ndërsa sa i përket pyetjeve tuaja të drejtuara Fondit për të Drejtën Humanitare, këtu është Bekim Blakaj dhe unë do t'ia jap fjalën atij. Unë e di që Bekimi do të përpiqet të jetë racional në mënyrë që të mos ikim nga rendi i ditës. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit, Shukrije! Unë u ndjeva i thirrur, prandaj edhe e kërkoja fjalën. Quhem Bekim Blakaj. Jam shef i Zyrës së Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë. Zotëriu Halit Berisha, nxori një kumtesë për shtyp, që e ka pasur Fondi për të Drejtën Humanitare, ku u përmendën 13.000 viktima. Në fakt aty është thënë rreth 13.000 viktima sepse ne ende nuk i kemi përfunduar hulumtimet tona. Mirëpo unë besoj se shumë shpejt do të vijmë në numrin e saktë dhe me emra e me mbiemra. Mua po më habit fakti që Këshilli koordinues i cili përbëhet prej 21 shoqatave, qysh s'kanë ardhur deri sot deri te lista me emra e mbiemra.

Në rregull, ju e thatë, askush në Kosovë nuk e ka! Dhe ju lutem, më dëgjoni, sepse unë ju dëgjova me kujdes goxha gjatë. Çështja tjetër është. Njëfarë takimi të Këshillit koordinues, një zotëri paska thënë që unë i kam ofru të holla për një listë! Ne i kemi listat dhe jo vetëm listat me emër e mbiemër, por me të dhëna të sakta, të dhëna personale të viktimave, të dhënat rreth mënyrës se si ka ndodhur, të rrethanave të vrasjes ose të zhdukjes. Zotëri Halit Berisha nuk është ardhë në prezantimin tonë që e kemi pasur para disa javëve në Suharekë, sepse ka pasur rastin shumë të mirë me pa listat me emra e me mbiemra, me i pa të gjitha të dhënat për viktimat që kanë rënë, janë vra ose janë zhdukur në territorin e komunës së Suharekës. Po më vjen keq, por megjithatë jeni të mirëseardhur kurdo që doni dhe të vini në zyrën tonë dhe t'i shikoni ato të dhëna. Ndërsa, në ato takimet tuaja, ku po ekzistojkan shifra tjera, unë kam dëgjuar se ka edhe propozime të ndryshme që me iu ndalua puna disa organizatave që merren me të drejtat e njeriut, sikur të ish aty ndonjë kongres i komitetit qendror apo diçka i tillë. Prandaj, edhe nuk dua me u marrë me atë çështje. Unë jam në dispozicion gjithmonë dhe puna jonë është shumë transparente dhe ne do të vazhdojmë dhe shumë shpejt do të kemi listat me emra e mbiemra, të sakta. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit, Bekim! Po, urdhëroni zotëri Mërlaku!

Ymer Merlaku: E përkrah fjalën e kryetarit të Asociacionit familjar të Kosovës, zotëri Haki Kosumit. Lidhur me çështjen e të zhdukurve, ne jemi qe 11 vite së bashku me Hakiun dhe kush më mirë se ne gjendjen nuk e di në terren të Kosovës. Sot shumë lehtë njerëzit me dy vetë, tre vetë mund të themlojnë shoqata dhe të merren me këtë çështje dhe është e drejtë e tyre, se Shoqëria civile na përkrahin dhe këto iniciativa ju që i bëni këtu mirëpo ne si tha edhe kryetari, nuk pengojmë por kemi shumë rezerva ndaj anëtarësimit apo themelimit e këtij komisioni mbi të vërtetën. Ne e dimë që këso komisione për të vërteta kanë ndodhur në shumë shtete ku ka pas konflikte dhe ato herë janë shuar e herë janë ripërtërirë ndërsa specifika e Kosovës është një specifikë krejt tjetër nga shtetet tjera. Mendoj që ne edhe në Këshill, që jemi afër 25 shoqata, gjithmonë kemi ngritur zërin dhe kemi thënë që të formohet një komision nacional, kombëtar në nivel të Kosovës, domethënë nga Qeveria e Kosovës dhe ajo mund të punojë, mund të bashkëpunojë me të gjitha shoqatat, me Fondin e me krejt. Ndërsa, sa i përket rezervës që thash, unë vetëm do ta jap një shembull. Natasha Kandiç ka ndikuar, me siguri ka ndikuar dhe ka përkrah gjykatën në Beograd që është mbajtur ndaj familjes Berisha atje. Mendoj kështu! Këtu mund të vijmë në konstatim se kryesi i veprës penale duhet të dënohet në vendin e krimeve. Ju keni gabuar tash Natasha. Ju keni gabuar. Me çdo rregull, me çdo ligj ndërkombëtar, me çdo konventë është e shkruar që kryerësi duhet të dënohet në vendin e krimit. Ju jeni ajo që keni ndikuar që të mbahet në Beograd dhe të legjitimohet gjykata e Beogradit e tjera. Kjo mua më jep të kuptoj që nuk jeni shumë serioze dhe keni qëllimet tuaja. Sigurisht fshehen edhe sende tjera, që ne nuk i dimë apo i din dikush. Mendoj se ende ne, shoqatat, këshilli duhet të mendojmë se a duhet të përkrahet a s'duhet. Ndërsa, kërkesa e familjarëve dhe e këshillit është që të formohet një komision i së vërtetës në Kosovë – nacional për të gjithë. Unë kaq pata. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit zoti Mërlaku! Natasha?

Natasha Kandiç: Po duhet të them diçka që nuk e kam të lehtë ta them. Por kjo gjithnjë më pikëllon dhe pyetem se çka kanë njerëzit, çka kanë njerëzit nëse mund të më flasin mua për atë që unë i ngriti aktpaditë, çka fshihet pas kësaj. Po ku jeni ju zotëri Halit, e edhe ju zotëri Merlaku. Ku ishit ju në kohën e bombardimeve të NATO-s që të thoni diçka. Të thoni atë që thash unë. Pse nuk e keni thënë këtë, menjëherë pastaj, kur kanë ardhur këtu forcat ndërkombëtare, ajo është, ajo punon kundër nesh, por ju ka ra në mend sot pas dhjetë vitesh.

Unë vetëm mund të them se kjo është e pahijshme, por unë nuk jam këtu për shkak tuajin. Për shkak tuajin zotëri Halit, edhe pse kam kaluar orë dhe orë duke biseduar në Suharekë, por kurrë nuk kisha ardhur këtu për shkak tuajin, por për shkak të viktimave. Dhe ju këtë të drejtë nuk mundeni me ma marrë, sepse ju asgjë nuk keni bërë për këto viktimë. Asgjë! Vëllai juaj është përmendur njëmijë e herë në gjykim dhe ju as për atë nuk keni dashur asgjë. Prandaj unë nga ju nuk pres asgjë pozitive lidhur me viktimat. Mua më vjen keq që zotëri Merlaku flet kështu. Mua më vjen keq që zotëri Kosumi ka thënë kështu, por ajo është e drejtë e juaja. Por ju mua, siç edhe nuk më keni urdhëruar, eja e diçka, e shiko çka po ndodh në Kosovë, si policia dhe ushtria serbe po vret, por unë këto i kam bërë vet. Në të njëjtën mënyrë punoj edhe sot, punoj edhe më tutje, absolutisht nën mbikëqyrjet e mija, nën principet e mija dhe ju lutem që kurdo që dëshironi të thoni diçka mos mu drejtoni mua personalisht, por mundeni që njëherë ta shkruani mirë në letër e pastaj atë shpallen publikisht, por unë këtu nuk jam për shkak tuajin e as nuk jam për shkak të njerëzve që flasin aq pahijshëm, siç flisni edhe ju.

Halit Berisha: Obligimin tim moral unë e kam krye për arsye se e kam parashtruar kërkesën time në Tribunalin e Hagës dhe kam qenë 3 herë në atë gjykatë në kohën e gjykimit të Millosheviqit, në kohën e këtyre të treve dhe tash para 12-13 ditëve kam qenë në gjykimin e Gjorgjeviqit. Unë obligimin moral e kam kryer aty dhe të gjitha dokumentacionin tim të cilin e kam parashtruar është marrë si provë materiale për gjykatën. Unë e kam kryer obligimin, kurse në gjykatën e Beogradit kur....

Shukrije Gashi: Faleminderit! E ka fjalën Shaban Terziu, se e ka kërkuar fjalën që sa herë. Urdhëroni, Shaban!

Shaban Terziu: Faleminderit! Unë përshëndes të gjithë të pranishmit. Si iniciativë, çdo iniciativë që ka vullnetin e mirë, është e mirë, të kuptohemi. Mos të konfrontohemi këtu. Unë mendoj ndryshe e ti mendon ndryshe, pse unë veprova kështu e ti duhet me vepruar si unë. Veprimet dhe mendimet janë të ndryshme dhe parlamentarizmi i lejon ato. Po shkoj tash me radhë. Unë quhem Shaban Terziu, vije nga organizata multi etnike profesionale nga Gjilani. Unë po fokusohem aty ku kam njohuri më shumë. Është interesant që dy shoqata nuk janë të ftuara këtu. **Apeloj që të ftohen: Shoqata e veteranëve të luftës nga Ushtria çlirimtare për Medvegje, Bujanoc dhe Preshevë dhe Shoqata për familjet e dëshmorëve.** Unë kam kontakt permanent me ta se i takoj atij regjioni. Është çështje se duhet të thirren edhe shoqatat e ish veteranëve të luftës, shoqatat e dëshmorëve dhe të thirren në këto tryeza, në këto konferenca, edhe nga Serbia. **E kam një të dhënë se unë kam marrë pjesë në Jahorinë të Sarajevës kur një ish ushtar rezervist në zonën e Karadakut që ishte në Jahorinë me mua dhe dha shumë të dhëna.** Thoshim pse mos të thirren persona të tillë dhe të japin gjëra konkrete. E kam fjalën nga Serbia. Ai ishte nga Surdulica dhe ato gjëra shumë ishin konkrete, shumë domethënëse dhe shumë reale. **Apeloj që të thirren edhe shoqata në të ardhmen në konferenca dhe në tryeza edhe nga Serbia.** Në Gjilan Shoqata jonë e ka ndërmend të organizojë një debat, konferencë apo tryezë me ish ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Medvegjes, Bujanovcit dhe Medvegjes dhe veteranët e luftës dhe të familjeve të dëshmorëve, sidomos pas arrestimit të 3 personave të Luginës së Preshevës kur dihet se në çfarë forme janë arrestua dhe dhunshëm janë çua në Beograd. Unë kam kontakte dhe ata apelojnë te unë dhe edhe unë po apeloj që të organizohet një konferencë në Gjilan lidhur me këto të dhëna, sepse kanë shumë për të dhënë, kanë shumë gjëra reale për t'i ofruar. Dikush thotë qysh i ke këto njohuri. Me propozimin dhe insistimin e Institutit Amerikan për Paqe përkatësisht Daniel Serveri dhe shefit të Pentagonit Amerikan Daniel Server, unë kam marrë pjesë në demilitarizimin e ushtrisë çlirimtare për Medvegje, Bujanoc dhe Preshevë. Pra, është lënë anash, posaçërisht është lënë anash nga pushteti apo

strukturat e Serbisë ku ata nuk ftohen, nuk thirren por vetëm këqyren, torturohen dhe ndjeken. Ka shumë familje të ardhur nga Lugina e Preshevës në Gjilan, për shkak se ndjeken. Ka me gra e fëmijë, kanë ardhur dhe janë strehuar dhe ata duhet dikush t'i ftojë, t'i thirrë pse ju kështu në këtë gjendje. Pushteti serb pse këto tortura, lufta ka përfunduar, atëherë çka më tutje. Unë personalisht si Shaban dhe si organizatë e kam një mirënjohje të veçantë ndaj zonjës Natasha Kandiç sepse ka bërë shumë për Kosovën. Po ndoshta kemi bërë edhe ne diçka, po s'kemi me mund me bë kurrë sa kemi ne dëshirë, dëshira dhe mundësia jonë është shumë relevante që s afrohen njëra me tjetrën. Unë kam rast konkret, rasti i Paraçinit, rasti i Aziz Kelmendit. Unë Rizah Xhaklin e kam mik. Ajo ka ndikuar kur ka qenë dënimi 20 vjet dhe ka mbajtur burgun në burgun e Paraçinit. Ajo ka ndikuar që Riza Xhakli të lëshohet para kohës. Janë këto gjëra konkrete. Mos t'i politizojmë. Shoqëria civile nuk guxon të jetë e njëanshme. Se kush ka punua, kështu është dashur, mos ta shikojmë njëri tjetrin por të shkojmë përpara. Iniciativat janë të mira. **Iniciativë nacionale që ishte shtetërore, ajo është shumë e mirë. Të japim propozim, por deri të formohet ai komision nacional le të punojmë, jo të ngrijmë aktivitetin. Propozimi është i mirë. Duhet të formohet një komision nacional, por ne duhet të punojmë. Si iniciativë le të jetë dhe si konkluzion nga kjo konferencë, por megjithatë duhet deri atëherë ne të punojmë.** Aktivitetet duhet të ecin, dikush pret prej neve. Më falni!

Shukrije Gashi: Faleminderit zotëri Terziu. Tash fjalën e ka Ruzhdi Jashari.

Ruzhdi Jashari: Së pari më lejoni të përshëndes panelistët e kësaj tryeze, të këtij debati. Gjithashtu, asociacionin dhe shoqatat e familjeve për persona të zhdukur dhe të gjithë të pranishmit bashkë me mas-mediat këtu që janë dhe përfaqësuesit e Qeverisë. Kjo ditë është një datë që të tjerët pushojnë, nëse mund të punojnë të shtunën, por e kanë zëvendësuar pushimin me ditën e hënë. Është data 9 maja Dita e Evropës dhe është shumë e çmueshme që pikërisht në këtë ditë janë fokusuar, janë orientuar kamerat për me biseduar për një çështje shumë vitale dhe të interesit jetik për personat që kërkojnë drejtësi, për personat që kërkojnë të gjenden, për personat që nuk janë në mesin tonë dhe që na mungojnë të gjithëve. Kush jam unë, ndoshta ishte dashur ta theksoj në fillim. Ne njihemi paraprakisht me shumë e shumë njerëz, me shumë aktivistë, të veprimtarëve të të drejtave më herët, pastaj një gazetar i një fronti të luftës, pastaj edhe një pjesëmarrës direkt në ekipet mbrojtëse në Hagë, për nga 3 vite kam punuar për rastin Limaj dhe të tjerët. Punët janë pak më të thella, po më duket mua dhe janë me një kërkesë më sublime se sa ato veç e veç, të imtuar dhe të ndara veç e veç për çështje më personale dhe më të vogla. Ne duhet të mendojmë se bota po ecën globalisht, por duhet të mendojmë pak më globalisht. Për të menduar globalisht, domethënë është iniciativë e mirë, e mirëseardhur prej jush për të ngritë një asociacion të një niveli rajonal. Ndoshta rajonal, pak në nivel të Ballkanit, por rajonal në nivel evropian, ndoshta edhe ndërkontinental dhe të kontinenteve tjera që presionet vijnë nga jashtë për sistemet, për qeveritë ku ka mundësi të shtyhen proceset drejt direkt të zgjidhen problemet dhe drejtësia të shkojë në vend. Mendoj se në Kosovë ka pasur zvarritje dhe janë të pajustificueshme faktet e pritjes dhjetëvjeçare. Dhjetë vite me prit një viktimë me ditë se ku është, të paktën eshtrat me i gjet. Ose 15 vite me prit me rastin e Bosnjës. Në Kosovë ndoshta mund të thuhet edhe mund të justifikohet kjo pritje në një sistem të drejtësisë me tri palë ligje, një drejtësi të trefishtë. Drejtësi me rregullore të UNMIK-ut, me Qendrën në Nju Jork, pastaj një drejtësi krejt tjetër me ligjet e bartura të ish-sistemit që është dashur me i zbatuar edhe ato dhe me ligjet vetjake nga organet vetëqeverisëse që kanë qenë të formuara edhe komisariatit gjegjësisht nën administratorin e UNMIK-ut. Domethënë, këto tri palë ligje në një rrafsh, secila ka prejjudikuar ose ka anashkaluar njëra-tjetrën kështu që presionet janë kanë tepër të ngathëta ose të vogla prej njerëzve që kanë kërkuar viktimat të

gjenden, të paktën të gjenden eshtrat pastaj të bëhet varrimi i tyre dhe një prej mungesave serioze në këtë drejtim është mungesa e mbrojtjes ligjore - aspekti institucional ligjor në këtë rrafsh. Prandaj, unë personalisht mendoj, nga përvoja që kemi pasur dhe që kemi, ne atje gati veç me viktimat i kemi drejtuar punët në Shtime dhe nuk e kemi shumë atë hall, domethënë të gjitha janë gati të gjetura dhe të kryera, me përjashtim të 5-6 viktimave ende që duhet të gjenden eshtrat e tyre. Të mbështetet pra kjo iniciativë dhe presionet të vijnë pikërisht prej rrafshit të jashtëm për shtetet. Pak më vështirë ndoshta e ka zonja Kandiq këtu, me gjithë faktin që një presion i madh i saj në shtetin e vet ka bërë që shumë çështje të zbardhen dhe dalin para drejtësisë. Mundësitë me i ndihmuar ne si Kosovë dhe si kosovarë ose si asociacion ndoshta janë kanë të pakta, të vogla, por fuqinë më të madhe e ka ai popull nga brendia e vet me bë presione në qeverinë e vet për me bë punën e vet. Një regjistrim dhe një shoqatë e tillë atje në Serbi bën një presion më të madh, një organizim, një shoqëri civile në Kosovë bën një presion më të madh. Prandaj nuk mund të shkohen në shabllon diskutimet dhe shoqëria civile të identifikohet me shtetin ose me pushtetin. Secila e bën punën e vet. Natasha le ta bëjë punën e vet, organizimet e tilla le të ngriten. Iniciativa e Këshillit të të drejtave të njeriut është e mirëseardhur dhe ajo me u bë këshill nacional, po le të ketë vend në këtë organizim, le të shtohet nesër modaliteti i ndërtimit, le të ketë një pozicion edhe këshilli nacional i formuar nesër, le të ketë një pozicion modaliteti i këtij ndërtimi dhe zoti Kosumi që e ka organizimin e mirë, të mrekullueshëm në këtë çështje dhe presioni i tyre nuk është ndalë vazhdimisht. Domethënë, kam konsiderata dhe kam konsideratë të veçantë për të, që kam punuar vazhdimisht, mirëpo pa prejjudikuar të drejtën me ndërhy secili në shoqatën e njëri tjetrit. I kanë ata statutet, i kanë programet dhe i kanë punët e veta. Unë edhe një herë them se jam mbështetës i fuqishëm i këtyre punëve duke ditur se pengesa serioze nganjëherë për Kosovën është ecja përpara që duhet me i mbushë disa kriterë. Mbështes mbështetjen e Qeverisë dhe të kryetarit të vendit që e mbështetin këtë iniciativë dhe është anë pozitive. Në një aspekt, duhet me kaluar nëpër disa çështje, me i përmbush disa kriterë për të mund me ecë në vendin ku e kemi ne, në Evropë, për me mund me ecë mekanizmat tjerë ku duhet. Presionet e jashtme, pse jo një presion, do modalitete juridike të këtij organizimi rajonal, mund të shkojnë direkt në Unionin Evropian. Mund të shkojë direkt në Komisionin juridik të Venecisë dhe në këto aspekte juridike bëhen presione e pengesa edhe për Serbinë. S'mundesh me bë këtë punë, dhe kështu janë ato presione të mëdha. Prandaj këtu e kemi edhe Bosnjën. Këtu është edhe Kosova, këtu është edhe Serbia, këtu janë edhe disa të tjerë prandaj presionet tona të fuqishme vijnë nëse mund të dalim jashtë ne dhe të bëjmë organizime të fuqishme rajonale. Unë jam mbështetës dhe edhe një herë po konfirmoj fuqishëm këto sende. Faleminderit për fjalën dhe për durimin që patët me më dëgjuar.

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë, Ruzhdi për një përmbledhje kaq të mirë dhe kaq domethënëse. Unë tash konsideroj se duhet të jemi pak më racional se duhet të paraqesim filmin për Komisionin e Marokut. Urdhëroni!

Rexhep Lushta: Ju falënderoj të gjithëve edhe një herë. Unë jam Rexhep Lushta, kryetar i Bashkësisë Islame në Mitrovicë. Falënderoj organizatorët e kësaj tryeze, gjithashtu falënderoj edhe mysafirët që kanë ardhur këtu. Fillimisht po shpreh një keqardhje për disa diskutime të cilat janë bërë në mes nesh dhe të cilat kishin me qenë më mirë të bëhen kur kishim me pas takime ndërmjet veti, ato asociacione apo ato shoqata, e jo në një tryezë të këtillë. Sidoqoftë e mbështes shumë edhe bisedimin e zotëri Jasharit dhe Terziut. Më vjen keq shumë se një iniciativë e tillë çfarë është kjo sot nuk është bërë më herët, e cila me të vërtetë ashtu siç e tha zotëri Ruzhdiu – neve na nevojitet që për zbardhjen e faktit apo zbardhjen e fatit të njerëzve të

pagjetur që të dalim edhe jashtë kufijve të vendit tonë. Derisa një gjë e tillë nuk bëhet, është pak më vështirë që ne të arrijmë t'i gjejmë të gjitha ato viktime të cilat sot neve të gjithëve na mungojnë. Ajo çka më intereson mua është që të pyes edhe zonjën Kandiç për të cilën kam një respekt të veçantë, për punën e saj të cilën e ka bërë, sepse me të vërtetë t'i thuhet stop apo t'i dilet përballë Qeverisë së Serbisë në rrethana të cilat kjo i ka bërë, jo vetëm për popullin tonë por edhe për të gjitha viktimat tjera në rajonin e ish-Jugosllavisë...Më intereson të di se cili është raporti në mes Fondit për të drejtat humanitare dhe kishës ortodokse serbe dhe bashkësive fetare tjera në Serbi. Këtë pyetje po e bëj për arsye se ne po shohim se kisha ortodokse serbe, sidomos gjatë luftës dhe pas luftës është politizuar tej mase, gjë që ne, si bashkësi fetare, po them edhe Bashkësia islame dhe bashkësitë tjera duhet që të mos politizohemi, por të jemi në shërbim të popullit dhe se një çështje që është, është vërejtje për të gjithë – anashkalimi i bashkësive fetare në iniciativa të tilla. Ne si bashkësi fetare, tash po flas si Bashkësi islame, duhet që nga këndi ynë të japim kontributin dhe ta luajmë rolin tonë në zbardhjen e fatit të njerëzve të pagjetur. Dhe, këtë mund ta bëjmë, shumë lehtë. Unë jam nga Mitrovica. Mitrovica është një qendër e krizës. Është një qendër ku krejt problemi i Kosovës, ndoshta, është i lidhur me nyjën e Mitrovicës. Por, u përmend Konferenca që është mbajtur në Mitrovicë, nuk është ftuar Bashkësia islame. Ky është një gabim, por ndoshta nuk janë ftuar edhe bashkësitë tjera fetare. Unë, personalisht, përveç se jam kryetar i Bashkësisë islame në Mitrovicë, njëkohësisht kam qenë edhe themelues i një shoqatë apo një këshilli multi-etnik qysh në vitin 99, kur të gjithë kanë menduar se bisedimet me palën serbe nuk janë të mundshme, e ne kemi arritur që në nëntor të vitit 99 të ulemi në tryezë serbët dhe shqiptarët bashkërisht. Do të thotë, kemi bërë një përpjekje të madhe për të arritur një rrugë e cila na shpie drejt një paqeje më të qëndrueshme jo vetëm në Mitrovicë por edhe në Kosovë. Edhe nëse fillojmë ne tash që të akuzohemi, nuk mund të arrijmë asgjë. Prandaj, po e përfundoj me shpresën se ky këshill, në gjirin e vet ka me pas edhe përfaqësues të bashkësive fetare, të cilët kanë me dhënë kontributin e vet, të cilët kanë me luajtur një rol të veçantë në këtë proces i cili me të vërtetë është proces i cili po na mundon të gjithëve sepse me fatin e të pagjeturve nuk duhet të merren vetëm asociacionet dhe shoqatat e të pagjeturve, por me fatin e tyre duhet të merremi të gjithë. Kam një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me Shoqatën “Kujtimi” në Mitrovicë, me zotërinjtë të cilët janë me të vërtetë duke bërë një punë shumë të madhe. Po më vjen keq që zotëri Sheremeti, as baca Bajram nuk janë këtu, por ata me të vërtetë kanë bërë një punë të madhe në Mitrovicë. Ne, si Bashkësi Islame, po e përfundoj me këtë, kemi bërë shpeshherë apel edhe te bashkësia ndërkombëtare, edhe te qeveritarët tanë këtu, që vendi, në të cilin dikur ka qenë xhamia e Ibrit, ai vend të investigohet, të hulumtohet, sepse ekzistojnë dyshimet se në atë vend ekziston një varrezë masive. Mirëpo, deri tash, gjithmonë kemi has në veshë të shurdhër. Prandaj, shpresojmë se me këtë komision, së paku do të arrijmë që ai vend të hulumtohet dhe një dyshim i njerëzve që ekziston për ekzistimin e një varreze në atë vend, ai dyshim të shuhet. Ju faleminderit, shumë! Shukrije Gashi: Faleminderit shumë për këtë përmbledhje të informatave. Unë besoj se në të ardhmen e afërt, me këshillimet tona, gjithsesi do ta përfshijmë edhe Bashkësinë islame dhe të gjitha bashkësitë tjera fetare. Kjo ka qenë edhe intenca jonë dhe nuk do të ndalemi me kaq, mirëpo ky është vetëm një fillim dhe të gjithë ata që kanë interesim dhe vullnet të mirë janë të ftuar që të marrin pjesë dhe të organizojnë këshillime të tilla. Faleminderit!

Natasha Kandiç: Përgjigje vetëm në pyetjen e zotëri Lushtës. Organizata për të drejtat e njeriut në Serbi ka raport shumë kritik ndaj kishës Ortodokse dhe pjesëmarrjes dhe veprimit të Kishës Ortodokse duke filluar nga vitet e nëntëdhjeta. Përgjashtim i vetëm na duket këtu në

Kosovë, se ka qenë menjëherë në vitin 99. ka pas atë Sava por edhe ai nuk është më në opinion, kështu që nuk ka më asnjë lajm se cila është pozita e tij sot, por sidomos kisha ortodokse Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë e ka pas atë, ashtu të them, raport pjesëmarrës shumë transparent për të gjitha që kanë ndodhur, dhe organizata për të drejta të njeriut kanë kritikuar në mënyrë shumë – shumë transparente dhe të hapur.

Ylber Maxhuni: Ju faleminderit për fjalën! Edhe një herë ju përsërit në emër të Organizatës joqeveritare “Youth Step” nga Vushtrria. Unë mendoj se ...

Shukrije Gashi: Më falni, a bën të prezantoheni?

Ylber Maxhuni: Po! Unë quhem Ylber Maxhuni dhe përfaqësoj Organizatën joqeveritare nga Vushtrria. Desha me u lidhur duke iu përmbajtur programit të këtij diskutimi lidhur me nevojat e komisionit, pritjet dhe drejtësinë tradicionale, mekanizmat dhe përgjegjësitë për nevoja dhe pritjet e viktimave. Unë mendoj se nevoja për themelimin e këtij komisioni është e pashmangshme dhe është shumë e nevojshme për shoqërinë tonë dhe stabilitetin në Ballkan dhe mendoj se kjo iniciativë duhet të përkrahet dhe po ashtu inkurajoj zonjën Natasha Kandiç dhe, pas atyre diskutimeve që u dëgjuan është vështirë të flitet, por mendoj se prapëseprapë është kjo shumë pozitive për ecjen përpara të shoqërisë sonë. Mendoj se çështja e mekanizmave është çështje e ekspertëve dhe lidhur me këtë e kemi parë një projektstatut dhe besoj se ishte shumë i detajuar dhe i mirë, kurse për vetë iniciativën e këtij komisioni mendoj se është shumë e qëlluar. Kaq. Ju faleminderit, pata shumë emocione, dhe mendoj se nuk munda ta them tërë atë çka desha dhe besoj se tjetrën herë do të jem pak më i relaksuar.

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë! Me vetë shprehjen tuaj se kjo është një iniciativë pozitive dhe e përkrahni, ka domethënie të madhe. Faleminderit!

A të vazhdojmë me paraqitjen e filmit, apo dëshiron edhe ndokush tjetër të marrë fjalën? Është vetëm edhe një. Më falni vetëm edhe diçka. Edhe pas paraqitjes së filmit, domethënë, do të ketë përsëri diskutime, kështu që unë kërkoj falje por më mirë është t'i përmbahemi agjendës dhe pastaj edhe të vazhdojmë me diskutime. Atëherë, mundeni edhe ta merrni fjalën. Mirë, po vazhdojmë dhe do ta përfundojmë një herë me diskutime dhe pastaj vazhdojmë. Urdhëroni, ju lutem!

Sylejman Bytyqi: Jam Sylejman Bytyqi nga Ferizaj. Këtu jam në cilësinë e ish të burgosurit politikë. Përsërit iniciativën për të organizuar këtë takim dhe në rend të parë dua ta falënderoj nikoqirin, posaçërisht zonjën Natasha Kandiç për kontributin e së cilës në drejtim të mbrojtjes së atyre që kanë qenë në çfarëdo forme të viktimizuar, atyre që kanë qenë të përndjekur, nuk mund ta mohojmë. Prandaj, thash thjeshtë, shfrytëzoj rastin ta falënderoj përzemërsisht për të gjithë atë që ka bërë në këtë drejtim. Nisma për t'u takuar të gjitha këto struktura këtu duhet përsëritur dhe kujtoj se është momenti i fundit që të merremi më seriozisht me këtë çështje. Në rast se për dhjetë vjet nuk kemi arritur që të bëjmë një hap të rëndësishëm përpara në këtë drejtim, me këtë tempo që po zhvillohen gjërat këtu te ne në Kosovë, ndoshta duhet të kalojë tepër shumë kohë dhe një ditë gjeneratat tjera do të thonë se këta nuk e kanë kryer obligimin e vet. Rruga më e mirë për ta zgjidhur këtë problem, natyrisht se nuk është e lehtë, është e vështirë, delikatë dhe komplekse. Së paku unë këtu e shoh edhe çështjen e disa diskutimeve sepse në fund të fundit na mbetet se duhet të provojmë, sepse ata që kanë qenë të përfshirë në të gjithë atë që ka ndodhur, por posaçërisht ata që kanë pësuar, një përgjigje e kërkojnë. Unë shoh se nuk ka shumë rrugë të hapura. Përkundrazi, shoh se ka shumë pengesa dhe shumë barriera. Por, të nisem ky problem e të diskutohet, besoj se është mjaft pozitive sepse një ditë nuk do të jemi në gjendje të heqim dorë e të themi nuk arritëm gjë, por së paku do të përpiqemi dhe një ditë do hapet një portë. Kujtoj se, po e përsëris edhe një

herë, është mirë që jemi takuar, por po vonohemi në kohë, për arsye se me këtë tempo, si thash, ndoshta do të na duhen edhe 100 vjet. Prandaj, mos ta akuzojmë zonjën Kandiç pse ka ardhur me hapë këtë çështje këtu, natyrisht jo me vetë iniciativën e vet, por duhet ta falënderojmë për nismën, ndërsa neve na duhet dhe na mbetet ta bëjmë pjesën më të madhe të punës. Unë thjesht, jam prej atyre që di shumëçka të flas, por s'kanë qenë shumëçka të koordinuara, shumë aksione, shumë aktivitete e shumë shoqata e tjera, e tjera këtu në Kosovë dhe kjo ndoshta ka qenë një nga arsyet që kanë mbetur shënimet e shpërndara në qendra të ndryshme dhe s'kemi mundësi t'i tubojmë në një vend. Çështja e komisionit. Unë besoj se në rast se ua lëmë OJQ-ëve të ndryshme, individëve, atëherë nuk do të shkojmë larg përpara. Është detyrë me të cilën duhet të merret një institucion qeveritar dhe ky komision nacional që u përmend këtu, sepse mundësitë ka me i pasur më të mëdha dhe besoj se atë komision ne duhet ta ndihmojmë në forma të ndryshme, po edhe individëve që marrin pjesë këtu, asociacioneve, grupeve, shoqatave e tjera, e tjera. Para pak ditësh dëgjova se paska në Kosovë që veprojnë 4.900 organizata joqeveritare. Edhe sot, s'po mundem me kuptuar. Mirëpo, cila është fushë veprimtaria e tyre, me çka merren, më se merren, kryesisht me disa veprimtari sporadike të parëndësishme a përmbajtje është edhe ai një lloj mini-biznesi, kështu të them, ndërsa ky grupacion ose shoqatat që merren me këtë çështje nuk kanë as ndihmesën më të vogël financiare materiale e tjera, e tjera dhe as mbështetje deri në këtë moment dhe është koha e fundit që për këtë në një mënyrë të bëhen presione te organet për t'u shpëtuar kjo punë. Ju faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë! Haki, doni fjalën?

Haki Abazi: Përshëndetje! Nëse më lejoni, do të prezantohem. Unë jam Haki Abazi prej Fondacionit të Vëllezërve Rokefeler dhe përfshijmë të gjithë regjionin e Ballkanit me programet tona. Arsyeja pse unë desha ta marr fjalën është që të hedh mbi këtë diskutim një dritë tjetër të aspektit të donatorëve ndaj iniciativës. Sigurisht se Kosova ka filluar ta ndërtojë pozicionin e vet ndaj komisionit regjional. Përkrah jashtëzakonisht dhe fuqishëm idetë e pjesëmarrësve këtu që kjo të vazhdojë tutje, jo për faktin se unë personalisht po konsideroj se është e rëndësishme por rëndësinë të cilën po ia japin pjesëmarrësit, si zotëri Ruzhdi Jashari, zotëri Sylejman Bytyqi, të cilët direkt kanë qenë të involvuar në proceset e mbrojtjes së drejtës të të burgosurve, viktimave dhe vazhdojnë të jenë pjesë e iniciativave në Kosovë për kthimin e dinjitetit të njerëzve të vrarë, të atyre që nuk janë më me ne dhe familjarëve po edhe shoqërisë kosovare në përgjithësi, po edhe shumë tjerë që sigurisht nuk kanë mund këtë herë të jenë pjesëmarrës këtu, t'ua bashkëngjis përkrahjen e njerëzve të cilët në mënyrë intensive bisedojnë për rëndësinë e krijimit të komisionit të së vërtetës në regjionin e Ballkanit. Përveç se ka rëndësinë elementare të cilën duhet ta ketë, për ata të cilët i përmenda: viktimat, familjarët, shoqëria në përgjithësi për të mund me ecë përpara, ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për raportet në regjion dhe raportet brenda Evropës. Evropa asnjëherë nuk ka pasur brenda territorit të vet një iniciativë të tillë e cila kishte me sjell në dritë marrëdhënie të një gjetjeje të së vërtetës por edhe të krijimit të marrëdhënieve për pajtim. Unë e di që ky proces është jashtëzakonisht i rëndë dhe sigurisht që filmi ka me folur për ato çështje dhe sigurisht se jeni ju të njoftuar për procesin në Afrikë të Jugut, dhe që ka ecur nëpër faza të ndryshme të vështirësive por një gjë nuk është harruar asnjëherë. Në krejt këto vështirësi ka triumfuar ideja për t'iu kthyer dinjiteti viktimave dhe njerëzve të cilët kanë vazhduar të jetojnë në agoninë e plotë të asaj që ka ndodhur. Dhe, derisa ajo nuk ka ndodhur, shoqëria asnjëherë nuk ka mund të ecë përpara. Sot Afrika e Jugut është në tempon më të lartë të organizimit të kampionatit të futbollit, e cila është një shenjë e vogël, por domethënëse, për kyçjen në marrëdhëniet normale

të një shteti. Kosovës, më shumë se cilitdo shtet në regjion, i nevojitet që ta shtyjë përpara gjetjen e së vërtetës, kthimit të dinjitetit të viktimave dhe të jetë pjesëmarrës i një procesi ndërkombëtar i cili do të validitet patjetër në nivelin ndërkombëtar. E di që nevojitet shumë guxim, shumë kurajo për me falë, për të qenë popull i cili i tejkalon egot e veta dhe dhimbjet e veta, por dhjetë vite pas luftës, ne definitivisht duhet të jemi të strukturuar si shtet për t'i dalë për ballë procesit të pajtimit, procesit të gjetjes së vërtetës dhe me i tejkaluar egot e individëve të cilët sigurisht se brenda tensioneve dhe marrëdhënieve të komplikuar që janë, nganjëherë e kanë vështirë, por me përkrahjen e njerëzve këtu, me përkrahjen e njerëzve që presin nga jashtë që ky proces të ecë përpara sigurisht se do të gjendet forcë që të ecet përpara në kuadër të komisionit regjional. Mos harroni se qendra për drejtësi në tranzicion e cila është qendra që udhëheq praktikisht procesin nëpër botë, është po ashtu përkrahëse direkte e komisionit regjional, e cila ka vazhduar me

Natasha Kandi: ... formojnë njëloj komisioni. Ju keni dëgjuar nga zotëri Salemi për iniciativën që në nivelin e Bjelinës dhe Tuzllës formohet komisioni i cili do të merret me vërtetimin e fakteve. Do të thotë, por vetëm në atë hapësirë. Çfarë ka ndodhur në Bjeline dhe Tuzell dhe e gjithë kjo është shumë - shumë e rëndësishme, e gjitha shumë kontribuon për atë që ne e dëshirojmë. Do të thotë të vërtetojmë çfarë ka ndodhur dhe të jemi të fokusuar në viktima, kështu që do të ishte e dobishme që dikush të na thotë diçka më shumë për këtë.

Shukrije Gashi: Faleminderit zonja Natasha. Do të vazhdojmë deri në ora 14, kurse tash fjalën do t'ia jap Kushtrimit e pastaj në qoftë se ka dikush për këtë diçka me këtë që elaboroi Natasha është i mirëseardhur. Faleminderit!

Kushtrim Koliqi: Faleminderit! Kushtrimi prej "Integrës" Prishtinë. Unë veç desha me dhënë një informatë që ma merr mendja ende nuk u dha këtu e që është shumë e rëndësishme. Në qoftë se themelohet një komision rajonal nuk ka me themeluar fondi, nuk ka me udhëheq fondi. Në qoftë se themelohet një komision rajonal nuk ka me udhëheqë asnjë organizatë që është pjesë e këtij koalicioni për themelimin e KOMRA-s. Ne jemi do organizata, do njerëz që po besojmë në një bashkëpunim rajonal dhe ne po duam me lobu, me bë presion që ky komision rajonal me ndodhë, se po besojmë që ky komision rajonal ka me miratuar do gjëra për të ardhmen, kështu që ta kemi shumë të qartë. Natasha Kandi s'ka me qenë sheficë e komisionit. Kanë me qenë njerëzit më kredibilë të tëra vendeve që ne mendojmë. Në qoftë se zotëri Kosumi apo kolegët e tij kanë me i propozuar njerëzit më kredibilë në Kosovë që me qenë pjesë e komisionit rajonal ata njerëz kanë me u zgjedhë. Kështu që mua po ma merr mendja se nuk bën me personalizuar nëse kemi diçka kundër personit të caktuar apo kundër një nacionaliteti tjetër, mos t'i ngatërrojmë sendet se po më duket që jemi të vetmit ne që nuk po e shfrytëzojmë Natasha Kandi si person. Unë mendoj se ne duhet ta shfrytëzojmë Natasha Kandi, që ndoshta për ta shfrytëzuar po tingëllon ndoshta pak si keq, por ta shfrytëzojmë se nuk është bash lehtë në mes të Serbisë me gjet një Natasha Kandi tjetër. Të këqyrim edhe anën e kundërt a ekziston në Kosovë ndonjë shqiptar që ka luftuar ose ka ngrit zërin aq fuqishëm për serbët që janë vra këtu. Edhe unë brenda gjakut tim kam pak urrejtje ndaj nacionalitetit tjetër, siç kemi ne krejt për shkak të historisë që kemi mësuar. Edhe mua më janë vra do njerëz. Gjithkujt në Kosovë iu ka vra dikush, më i afërm, më i largët e tjerë. Mua po ma merr mendja se nuk bën ta centralizojmë këtë KOMRA-in në qoftë se, ishalla, themelohet. Në qoftë se themelohet nuk bën me centralizuar se fondi e ka pronësinë. Harroni! Ajo s'mund të ndodhë kurrë. E para, një komision i tillë për me pas legjitimitetin e vet duhet me pas vulën e shtetit, dhe të tjetrit nëpër vende të tjera. E dyta. Duke i marrë parasysh aftësitë e tyre politike dhe mundësitë e tyre politike, pa e pas

edhe mbikëqyrjen e komunitetit ndërkombëtar, s'ka me pas shansë. Pra, pa i pasur këta piunat e Obamës e tjetrit, s'ka me pas qare që ky komision me pas legjitimitetin e vet dhe të njëjtën kohë ka me pas efektin e vet, pastaj. Kështu që, shumë po ju lus, jam pak dëshprues i ri, a po dini. Qysh me centralizua çdo send. Në Kosovë Natasha Kandiçi në qoftë se kemi me u marrë me ndonjë organizatë të Kosovës, ne kemi me u marrë për veten tonë në Kosovë. Nuk mund të vjen askush as prej Beogradit as prej Serbisë as prej Kroacisë. Ka kaluar më ajo kohë. Ka kaluar koha e UDB-es e KGB-ës. Unë nuk po besoj më në atë kohë. Mos të bëjmë fiksione, fiksione pa lidhje. Në Kosovë ne kemi me u marrë me njerëz tanë. Ne kemi me shkue me folë me njerëz tanë. Askush më s'mundet me të manipuluar, as me pare, as me 7.000 dollarë. Kështu që shumë po ju lus që të mos e centralizojmë këtë. Shoqëritë civile nuk kanë me udhëheq komisionin. Kanë me udhëheqë njerëzit më kredibilë në botë, në botën e Ballkanit. Kështu që, prapë besoj në bashkëpunimin rajonal. Në qoftë se Natasha Kandiçi paska gabuar dika me një rast atje, nuk do me thënë që kjo tash s'ka me pas gisht në komision, nuk ka me pas hapësirë me gabue në komision në qoftë se paska gabu, se ka me gabuar. Se Bekimi që paska gabuar, ka me ia dhënë 7.000 dollarë. Nuk ka me udhëheq komisionin, nuk ka me kanë brenda në komision. T'i lëmë anët personale, ta këqyrim pak një interes më global. Në qoftë se familja e nënës time, e cila u prek në Pejë ka me pas një beneficion, ka me u shpagua materialisht, ka me pas një memorial, ka me pas një muze e tjera, e tjera, pse mos me bë. Kaq. Shukrije Gashi: Kushtrim, faleminderit shumë! Fjala e juaj ka qenë shumë e qëlluar dhe shumë përmbledhëse. Unë gjithashtu thërras të tjerët që tha edhe më herët zonja Natasha që të paraqiten ose me elaborime rreth idesë për krijimin e komisionit nacional ose të shtrojnë pyetje përkitazi me këtë. Faleminderit!

Halit Berisha: ... Kallxom t'i mua kështu, në qoftë se ne të Këshillit koordinues domë ta çelim një zyre në Beograd, çka bëhet me atë zyre brenda 24 orëve.

Kushtrim Koliqi: Veç shko në Ambasadën Amerikane, Ambasada Amerikane ta ruan, e bën presionin më të madh. Jo, jo, Ambasada Amerikane në Kosovë ose dikush që ka fuqi të madhe, nuk të prek askush.

Po sigurisht, unë nuk po besoj në atë çka po thua ti, sigurisht. Në qoftë se kemi aq shumë... Po ndoshta jam aq naiv e injorant.

Shukrije Gashi: Urdhëroni, zotëri Mërlaku.

Ymer Merlaku: E kisha lidhur këtë çështje pasi që ashtu mendoj unë, si jurist. Komisioni, nuk e di sa munden me analizue çka është komisioni, nuk e dinë programin e atij komisioni, nuk i dinë të dhënat çka është ai komision. Së pari nuk e dinë fjalën me çka merret. Ai është një komision shumë i keq, shumë hetues. Nuk e di sa është... është i mirë për këto familje e për krejt, mirëpo rrjedha kur një popull, populli serb e dënoi bota dhe pa asnjë kërkim falje, e tash dalin njerëz nga shoqata të reja – hajde pajtojmë e send, pa u dit ende 2.000 njerëz të fillohet iniciativa, pa u zbardhë fati i të zhdukurve, pa asnjë kërkim faljeje, mua më duket se është herët. Unë jam për ato ndryshime, jam për ato iniciativa por mendoj se jemi herët. Ende nuk është koha. Janë shumë çështje që duhet të zgjidhen më herët. Kaq.

Haki Abazi: Më fal, a mundesh me na i tregua cilat janë ato çështje, sepse procesi për të cilin po flasim është pikërisht për çështjet për të cilat po flet.

Ymer Merlaku: A e din ti komisioni çka është?

Haki Abazi: Nuk është me rëndësi a e di unë. Nëse mundesh....jepju publikut te çështja e pajtimit. Çështja e pajtimit është çështja e fundit në fazën e krijimit të Komisionit. Këtu është duke u folur për një proces publik pjesëmarrës ku secilit i jepet mundësia që të kyçet me informacionin, dokumentacionin, të dhënat, angazhimet, brengosjet dhe të gjitha çka mund të

përfshijë një proces për të mund me mbërri deri te formimi i komisionit. Nuk ke nevojë, unë nuk jam në provim para teje me më pyet, nëse është komision.

Të lutem a ka mundësi me i treguar publikut, pjesëmarrësve të cilat janë hapat që ju i parashihni për me mbërri deri te komisioni. Të flasim në mënyrë pragmatike...

Ymer Merlaku: Duhet të jetë zbardhja e fatit të të pagjeturve.

Haki Abazi: Ai është pjesë e këtij procesi.

Ymer Merlaku: Një. Duhet Serbia të kërkojë falje ndaj gjenocidit të bërë në Kosovë. Kur?

Shukrije Gashi: A e përfundove. Vetëm diçka. Fjalën le ta merr Xhafer Veliu.

Xhafer Veliu: Quhem Xhafer Veliu, vie nga Skenderaj, i shoqatës ...

Ky komision kur të formohet, mua më preku si familjar ai shoku atje, Serbia duhet t'i plotësojë do kushte, të gjendet edhe më i fundit që është i zhdukur. Të gjithë ata kriminelët t'i qet para drejtësisë dhe t'i paguajë dëmshpërblimet në njerëz dhe dëmin material që e ka bërë. Atëherë do të vjen edhe te ardhja e këtij komisioni. Komuna e Drenasit dhe Skenderajt sot i ka mbi 300 ende të pagjetur. Asnjëherë nuk pajtojnë familjarët të vijnë te ajo çka mendohet te ne. Familjarët kërkojnë të afërmit e tyre. Janë qe 11 vite me ankth dhe me pritje çka po ndodhë me ta, kur po iu vijnë më të dashurit e tyre. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë. Kjo do me thënë ishte një brengë reale e konkrete. Këto brenga duhet të ndahen këtu dhe për këto brenga të bëjmë përpjekje dhe të gjejmë zgjedhje, të gjejmë bashkëpunim të ndërsjellët, për arsye se ky është përqendrimi. Tash fjalën do t'ia jap zotëri Bogdan Ivanisheviq... Më falni, por e kërkoi edhe ky. Atëherë, s'ka problem. Atëherë, e ka fjalën zotëri Baraliu. Urdhëroni!

Bogdan Ivanisheviq: Po unë kisha thënë vetëm një fjali tani për tani. Do të doja të ceki atë që e tha Kushtrim Koliqi, se jo vetëm të personalizohet por të kuptohet se kjo nuk është iniciativë që ka ardh nga Serbia. Këtë do të doja ta theksoja, pasi që zotëri Kosumi njëjtë ka thënë në paraqitjen e tij se iniciativa ka ardhë nga Serbia. Kjo thjeshtë, në nivelin faktik, nuk është e vërtetë dhe do të doja që të mos shqyrtohet në atë mënyrë, të fillohet nga ajo që nuk është fakt. Kjo iniciativë vjen nga të gjitha pjesët e ish Jugosllavisë. Kosova tani merr pjesë në këto konsultime, a do të hyjë apo jo, ndonjë organizatë, kjo mbetet të shihet. Po mirë, ndoshta ju e dini, por ajo që keni thënë, unë nuk e di çka keni ju por e di çka keni thënë. Ju keni thënë se iniciativa vjen nga Serbia. Kjo në nivelin faktik nuk është e saktë. Ka ardh iniciativa nga ana e organizatave joqeveritare nga Beogradi, nga Sarajeva dhe nga Zagrebi, tani janë qindra, ndoshta jo qindra por 200 organizata përfshirë edhe ato nga Kosova, kështu që thjeshtë nuk i kontribuon kualitetit të diskutimit nëse vazhdimisht diku shtrohet nëpër diskutim ajo ide se fjala është për iniciativën e cila ka ardh nga Beogradi. Mendoj se disa njerëz janë pjesëmarrës, ngjashëm me atë, flas. Ndoshta zotëriun nuk e kam kuptuar mirë, dhe ndoshta për shkak të përkthimit nuk arrij t'i kuptoj të gjitha por ja që do të ishte mirë që në diskutim thjesht mos t'ë flitet në atë mënyrë. Nuk ka kuptim.

Shukrije Gashi: Faleminderit, zoti Ivanisheviq. Tash fjalën e ka zotëri Baraliu.

Urdhëroni!

Mazllum Baraliu: Faleminderit shumë. Përsëritës organizatorin, penalistët, të gjithë të pranishmit. Unë jam Mazllum Baraliu, profesor universiteti, në Universitetin e Prishtinës. Këtu jam në cilësinë e vëzhguesit dhe flas në emrin tim personal.

Mendoj që nuk ka asgjë të keqe që të ketë polarizime të mendimeve dhe shprehje të brengave, dhembjeve dhe dëshirave tona dhe unë mendoj se ato dëshira dhe synime tona janë të përbashkëta të të gjithëve këtu të pranishëm dhe kjo duhet të jetë ndoshta orientimi kryesor dhe objektivi kryesor po edhe një indikator për konkluzione konkrete. Unë e mora fjalën

pikërisht jo për të balancuar as për të prekur ndjenjat e askujt dhe për të cenuar ato, me gjithë respektin ndaj secilit dhe secilës diskutonte këtu dhe të gjitha viktimave, mbi të gjitha, për arsye se mendoj që qëllimi i çdo iniciative të kësaj natyre është pozitive dhe sublimë sepse ka të bëjë me atë që u tha nga të gjithë parafolësit – mbrojtjen e viktimës dhe identifikimin e shkaqeve dhe të pasojave e problemeve të cilat kanë sjellur deri te zhdukja, vrasja, krimet e të tjera, të gjitha viktimave, në të gjitha vendet duke përfshirë edhe Kosovën. Natyrisht se neve na dhemb shumë rasti i Kosovës dhe duhet kuptuar shumë drejtë të gjithë diskutantët që folën në një variant dhe që mandej pati një reagim që mendoj s'ka arsye dhe të palës tjetër që po ashtu mendon pak më ndryshe. Unë jam i njoftuar me zanafillën e kësaj iniciative dhe e di që nga fillimi. Kam qenë edhe në organizimin e fundit që është mbajtur në hotelin Grand. E çmoj shumë përpjekjen e të gjithëve, të vullnetmirëve. Kësaj radhe le t'më lejohet dhe le t'më falet në qoftë se dikush mund të preket dhe mendojë ndryshe por është evidente që ka një, megjithë respektit ndaj secilit, që për mua s'është me rëndësi a është një muaj a dy muaj, dy ditë a tri ditë që dikush merret, apo 12 vjet. Është shumë me rëndësi ata që merren më shumë dhe ndihmojnë në këtë aspekt sepse është një plagë e përgjithshme dhe problem i përbashkët. Ka një prani pak sa, mos të them, selektive ose restriktive por megjithatë ka elemente sepse kam parë unë njerëz të cilët janë deklaruar dhe mbaj mend shkëlqyeshëm, nga mbledhja e fundit, ata nuk janë këtu. Nuk është në favor të zhvillimit të kësaj iniciative dhe të zbulimit të së vërtetës objektive për viktimat në të gjitha rajonet e Kosovës, veçanërisht flasim, thash më parë, duke filluar nga Kosova, sepse jemi drejtpërdrejt të prekur, po edhe unë jam njëri prej atyre që ka humbur familjarë, por edhe të tjerët që s'kanë humbur kanë dhembje dhe kanë interesim që ky problem të zgjidhet. Prandaj unë nuk e shoh si polarizuese në kuptim negativ bisedën këtu dhe unë i jap të drejtë të gjithë atyre që folën fillimisht dhe të gjithë këtyre të tjerëve dhe kjo nuk është kurrfarë kompromisi, por mendoj se është shumë objektive dhe korrekte. Nuk mendoj se ka nevojë për të mbrojtur askënd. Më lejoni që zonjën Kandiq, dhe kërkoj falje që e përmendi, por në kontekst pozitiv. Ajo është aq e madhe për arsyet që u thanë këtu dhe që u thanë edhe nga të tjerët me synim, kinse ajo është fajtorë ose, sipas mendimit të tyre, kanë të drejtë të mendojnë që është fajtor, por unë mendoj që ajo është shumë e madhe, ajo ka bërë shumë. Po ashtu edhe Sonja Biserko dhe shumë të tjerë, shoqëria civile atje bën përpjekje në kushte jashtëzakonisht të vështira, më të vështira se kudo tjetër në Serbi është që të veprojë shoqëria civile dhe të ketë guximin. Edhe ne në Kosovë kemi kushte të vështira. Edhe në Bosnje kanë, në qytete e shtete tjera të Ballkanit por atje është shumë vështirë. Dhe unë mendoj që askush këtu nuk e pati atë tendencë ta cenojë dhe ta zvogëlojë, minimizojë rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm edhe para lufte, edhe gjatë lufte, edhe pas lufte të zonjës Kandiq dhe fondit të saj, në asnjë mënyrë. Natyrisht se synimet tona janë të përbashkëta dhe pse jo, edhe ajo ka të drejtë të na kritikojë neve dhe ne t'i themi diçka që eventualisht mund të jetë ndryshe ose mund të ishte më ndryshe, por që nuk e zvogëlon në asnjë mënyrë kontributin dhe personalitetin e madhështinë e zonjës Kandiq. Unë mendoj se të gjithë pajtohemi me këtë. Mirëpo, sa i përket iniciativës, propozimi, ju lutem, duhet të respektohet dhe unë mendoj për atë çka na pret neve kosovarëve. Nëse e teproj, kur ta kaloj kohën, lirisht më ndërpreni unë e ndërpres. Por mendoj se është e rëndësishme për të rrumbullakuar, për të rekapitulluar diskutimin dhe për të pasur një konkluzion nga ky takim, kjo përpjekje, e cila duhet të zgjerohet radhët e saja. Prandaj të gjitha propozimet që u dhanë këtu, unë do të shtoja, përveç atyre që bashkësitë fetare patjetër të ftohen dhe nëse nuk vijnë një herë do të vijnë një herë tjetër. U tha këtu, po edhe zonja Kandiq e tha dhe ju, zonja Shukrije, e thatë se kjo iniciativë do të pretë 2 vjet e

ndoshta edhe 3 vjet e nuk realizohet. I dimë ne, edhe qeveritë tona, i dimë edhe sektorin e institucioneve, me gjithë respektin ndaj tyre dhe unë kam pastaj po ashtu një propozim për qeverinë tonë se çka duhet bërë. Mirëpo, mendoj se ne duhet të dimë se kemi nevojë për një konsolidim të brendshëm. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë për ndërtimin e një qëndrimi rreth kësaj iniciative nga brenda dhe ajo, me shumë të drejtë, u shtrua nga diskutantët, nga profesori Haki, nga profesori Halit dhe të tjerët këndej që mendojnë, jam i bindur njëjtë, por kah të jetë fillimi. **Fillimi duhet të jetë që të bëhen konsultime dhe konsolidohet e të ketë një qëndrim shoqëria civile fillimisht bashkë me Qeverinë brenda Kosovës.** Dhe, atëherë do të sqaroheshin të gjitha të panjohurat dhe ajo që quhet ose improvizim ose iniciativë sepse këtu shteti i Serbisë nuk ka iniciativë dhe u tha, s'po them asgjë të re, por ta konstatoj atë që u tha dhe ta verifikojmë e të merremi vesh që diçka tjetër është shoqëria civile dhe diçka tjetër është qeveria edhe në Serbi edhe në shtetet tjera, edhe në Kosovë. Ne s'jemi të kënaqur as me Qeverinë tonë për disa çështje, për shembull, mirëpo e çmojmë se është Qeveria jonë. Edhe në Serbi qytetarët e saj kanë të drejtë ta çmojnë Qeverinë e tyre për atë që bën, për interesa të atyre qytetarëve që mund të jetë në dëm tonin, por edhe ta kritikojnë. Dhe pikërisht shoqëria civile po e bën këtë. Prandaj ne duhet ta ndërtojmë qëndrimin këtu, t'i fusim ato segmente duke llogaritur gjithësesi edhe në Këshillin koordinues të shoqatave dhe të personave të pagjetur dhe Këshillin për të drejtat e njeriut dhe liritë e qytetarëve dhe të gjitha OJQ-ët të cilat kanë vullnet që të kyçen, t'i sqarojnë brenda këtu, ta ndërtojmë një qëndrim, të koordinojmë me Qeverinë, patjetër dhe unë mendoj që aktiviteti nuk duhet të jetë jo vetëm te ne, por edhe në Bosnje, në Serbi, në Kroaci, në Mal të Zi dhe në Maqedoni vetëm nga shoqëria civile sepse ju e dini sa qeveritë e çmojnë sektorin civil. Nuk e çmojnë dhe nuk e respektojnë. Prandaj edhe këndej, por në të njëjtën kohë e kemi përfaqësuesin e Qeverisë dhe me shumë respekt e lusim që të bëjë më shumë sepse është evidente, unë kam qenë nënkryetar i Komisionit të parë pas luftës për hetimin e krimeve këtu në Kosovë dhe ne nuk kemi pasur përkrahje as nga Qeveria e Thaçit, ajo e para dhe as nga këto qeveritë tjera. Por, kjo nuk do të thotë se ne duhet ta ndalim aktivitetin. Prandaj, koordinimi i aktiviteteve, qeveria le të urdhërojë këtu dhe do të ju lehtësojë punën juve të gjithëve këtu që keni vetëm synim të mirë si iniciativë, domethënë dhe është e vërtetë që tha zotëriu iniciativa nuk ka qenë vetëm nga Fondi humanitar dhe nga Serbia por ka qenë nga disa OJQ nga Kroacia, nga Serbia dhe nga Bosnja. Mirëpo ne kemi pasur atje... Jo unë s'kam atje, s'desha të flas as këtu dhe u gëzova kur nuk ma dhatë fjalën sepse nuk desha të flas. Por e mora këtë me shumë guxim dhe kurajo edhe intelektuale edhe qytetare e njerëzore që t'i ndihmoj procesit dhe t'i sqarojmë gjërat e ta bëjmë dhe ndërtojmë një propozim. Dhe ky është propozimi im dhe po e përfundoj. Do të thotë, të dalim nga këtu me një propozim **kur t'i vjen koha që nuk është asgjë e kundërshtueshme që të formohet këshilli nacional, gjegjësisht të konsolidohen radhët e sektorit civil në bashkëpunim të plotë dhe në koordinim me Qeverinë, e cila mund të ndihmojë shumë në konsolidimin e radhëve të sektorit civil në Kosovë, të OJQ-ëve të cilat kanë ende rezerva.** Ju lutem, askush nuk është kundër. Unë ju kuptoj plotësisht të gjithë ata që thanë se në emër të familjeve që po dyshojmë... Nuk është puna e dyshimit. Është puna se kanë arsye sepse s'është bërë asgjë që 10 vjet, që 17 vjet në Bosnje, e të tjera dhe thjeshtë është humbur besimi. Pra, ta rindërtojmë këtë besim dhe në këtë mënyrë është mënyra më e mirë. Dhe, të ju them një gjë. Nuk ka rrugë tjetër, më besoni, që të mos koordinojmë ne, sektori civil edhe në rajon por në radhë të parë në Kosovë, pastaj ky këshill nacional me të tjerët në rajon dhe këshillat nacionale që duhet, ashtu siç u tha, të formohen me ligj dhe nga parlamenti të miratohet. Me të tjerët nuk ka asgjë por vetëm është një formë e organizimit.

Por, nuk mund të bëjmë ndryshe. Qeveritë nuk e bëjnë këtë punë. Të jeni të sigurt se asnjë qeveri në rajon, sidomos Qeveria e Serbisë, nuk e bën. Qeveria jonë është e pafuqishme dhe edhe ajo ka pengesat e veta, me gjithë se vullneti sigurisht, që po e shoh Kushtrimin që po buzëqeshë apo po nënqeshë por vullneti nuk mungon. Në asnjë mënyrë nuk e kam synimin tim që të kritikoj askënd këtu por pikërisht që t'i neutralizojmë dyshimet, rezervat dhe dhimbjet që i kemi dhe të shikojmë përpara, ta ndërtojmë një propozim dhe të shkojmë në drejtim të duhur. Përndryshe, kjo është një iniciativë dhe dëshirë ndërkombëtare. Ju lutem! Këtë duhet ta bëni transparente. Është vullneti i mirë i këtyre OJQ-ve dhe i juaji por është edhe bashkësia ndërkombëtare pranë kësaj dhe ai djali e tha shumë mirë, në mënyrë transparente pa kalkuluar shumë, se koha është. Është e vërtetë kjo, prandaj nuk është e keqe, është pozitive dhe urdhëroni të kanalizojmë më së pari ne, të konsolidohemi brenda, t'i bashkëngjitemi iniciativës dhe të shkojmë përpara në realizimin e kësaj dëshire dhe kësaj initiative që është vërtetë sublime sepse qëllimin e kemi të njëjtë dhe ai është: mbrojtja e viktimave, zbulimi i të vërtetës, sepse këto komisione vërtet kanë pasur vështirësi por kanë pasur edhe suksese edhe në vende tjera. Prandaj ne nuk jemi të vetmit. E vetmja specifike është që ne jemi në një iniciativë rajonale, e cila ka filluar nga lartë-poshtë dhe nuk do të shkojë. Nga poshtë-lartë, jam i sigurt se do të shkojë, prandaj ju falënderoj dhe me kaq po e përfundoj.

Shukrije Gashi: Faleminderit, zoti Baraliu. Pikërisht këtë që e thoni ju, ne po përpiqemi ta bëjmë, të bashkëbisedojmë me Shoqërinë civile dhe me Qeverinë në Kosovë. Të ftuar kanë qenë të gjitha shoqatat, shumë prej tyre, për ato për të cilat ne kemi ditur dhe qëllimi ka qenë që jo vetëm ne ta paraqesim iniciativën tonë por në fakt që të bashkëbisedojmë edhe për komisionin në nivel nacional, madje është shtruar edhe në takime që kemi pasur edhe në Beograd. Domethënë askush kërkujt nuk ia ka mbyll derën. Përkundrazi, qëllimi është që ne brendapërbrenda këtu, dhe kudo qoftë në ish-Jugosllavi, të harmonizojmë dhe në rend të parë të marrim qëndrime dhe pastaj t'i bashkëngjitemi iniciativave të cilat e shkurtojnë rrugën deri te realizimi i qëllimit. Mirëpo, si do që të jetë, ju falënderoj shumë për fjalën tuaj shumë konstruktive dhe shumë e strukturuar. Faleminderit! Tash ju kisha ftuar të shkojmë në drekë. Haki, më fal, urdhëro, por shkurt.

Haki Kasumi. Unë nuk kisha ndërmend, por kam dëshirë dhe do të flas pak dhe në këtë fjalë timen do të lus të gjithë të pranishmit që kurdoherë, që kanë rast të dëgjojnë fjalën time, që ta përcjellin pak më me kujdes.

Këtë fjalë të dytë do ta filloj dhe do ta citoj një nënë, e cila me dhembjen e saj në zemër, thotë kështu:

O njerëz të mirë

Që merreni me punë të dhembshme

Dhe të mira

Ju lutem gjemani njeriun

Të cilit po më lutni,

Po më detyroni

Dhe po kërkonin

Që t'ia fal gjakun

Dhe jetën e djalit tim

Për derisa ne jemi ende larg asaj që ta identifikojmë, ta gjejmë ose s'e kemi gjetur as trupin e fëmijës që e kërkon nëna ne po kërkojmë diçka që ta bëjmë hapin e fundit të parin. Unë konsideroj dhe po e përsëris edhe një herë se në fjalën time edhe në takimin e parë, me këtë

përballjen e parë, me këtë iniciativë po i drejtohem vetë të nderuarës zonjës Kandiç se si ide dhe si iniciativë e respektoj si njeri me këtë kulturë dhe me këtë nivel që ka, e respektoj lartë dhe mendoj se meriton dhe e ka respektin edhe të familjarëve dhe të viktimave të Kosovës. Por, po e përsëris edhe një herë dhe po them: ju lutem, ju lutem – mos të nxitjmë dhe të bëjmë përpjekje që pa e pasur dhimbjen e nënës në të kërkojmë që ta bëjmë atë hapin e fundit të parin dhe të keqkuptojmë njerëz ose të etiketojmë njerëz. Unë përfaqësova dhe prezantova qëndrimin e Këshillit koordinues, i cili është i tillë, i pëlqen apo nuk i pëlqen dikujt, është diçka tjetër. Dhe, ma mori parafolësi i respektuar atë konstatimin tim që desha ta them: Njerëzit nga konsulta e mëparshme dhe njerëzit nga forumi i katërt që është mbajtur në Grand shumica absolute e tyre ndërrojnë. A thua janë ndërrua dhe janë ftuar njerëz të tjerë të painformuar të cilëve u plasohet një gjë e cila për ta, normal kam respekt, çdo iniciativë dhe organizatë joqeveritare dhe sidomos kam respekt për ata që s'kanë lidhje me dhimbjen tonë për prezencën e tyre që mundohen. Megjithatë është njerëzore që ata mundohen të kyçen në dhembjen e kësaj çështjeje, që është shumë e ndjeshme. Punoj që dhjetë vite dhe konsideroj se nuk kam arritur ta definoj dhe ta kuptoj këtë dhembje dhe ta përcjell te të tjerët dhe të kërkoj ose të gjej formulë adekuatë për tejkalim të kësaj. Prandaj, iniciativa dhe ideja e formimit të komisionit regjional e deshëm në si Kosovë dhe si popullatë ose s'e deshëm, e kjo vlen për të gjithë të tjerët, ajo do të shkojë sepse është ide progresive, ide e qëlluar dhe ide në interes të atyre për të cilët normal lindin ide të tilla.

Shukrije Gashi: të paraqiteni me komentime, të merrni pjesë me pikëpamjet tuaja dhe çfarë janë përshtypjet tuaja nga ky komision. Gjithashtu, edhe përkitazi me çështjet paraprake, të cilat u shtruan gjatë këshillimit, keni mundësi të shtroni pyetje. Ju lus që të jeni aktivë. Urdhëroni, Eli.

Eli Krasniqi: Unë edhe pak më parë desha, në seancën e fillimit, të them diçka që është perceptim i imi dhe mundem me gabua. Observimi im është që dhimbja është shumë e madhe. Edhe trauma dhe dhimbja janë shumë të mëdha. Është kjo pikërisht një element i cili nganjëherë, si të them më but, na e humbë drejtimin për të ndërtuar diçka që është pragmatike, diçka që është e nevojshme për të gjithë. Prandaj, ndoshta kishte me qenë mirë dhe unë po konsideroj se veç është pranuar ai propozimi që ka qenë edhe më herët, edhe para kësaj séance, sa kam mund unë ta përcjell dhe jo aq shumë, fatkeqësisht, që të krijohet së pari komisioni në nivelin kombëtar. Në këtë rast, nëse veç vazhdohet ashtu, e unë besoj se kishte dashur të jetë ashtu, sepse shumica, sa mora vesh unë, janë të pajtimit që të fillojë në nivelin nacional, qoftë edhe ajo nëse s'ka arsye, është legjitime ndjesia që njerëzit sot këtu dhe njerëzit të cilët nuk janë prezent e kanë, që duhet të jetë së pari i nivelit kombëtar qoftë ai edhe për rahatini e tyre mendore, psikologjike ose emocionale, çfarëdo qoftë ajo. Prandaj, në këtë aspekt, mendoj se ndoshta është më se e rëndësishme të kemi njerëz të cilët janë marrë një kohë të gjatë me çështje të traumës, njerëz të cilët janë psikologë socialë, për shembull, meqë ne kemi plotë organizata dhe individë të cilët kanë punuar dhe janë shumë të mirë në këtë drejtim. Unë kisha me i dhënë disa emra të individëve, që mendoj kishin me bë punë shumë të madhe. Më duket që kjo është me rëndësi me i dhënë më shumë kohë dhe me i dhënë njëfarë trajtimi të veçantë sepse, e ndoshta e kam gabim dhe kërkoj falje nëse e kam huq komplet. Por, përnjëmend konsideroj se dhimbja dhe trauma janë shumë të mëdha, aq sa po krijon njëfarë hapësire të besimit, njëfarë hapësire që dyshimi mund të zë vend aty shumë, bile edhe për gjërat më të vogla. Dhe këtu natyrisht është problemi kur njerëzit fillojnë të ballafaqohen me të kaluarën. Në këtë aspekt, mendoj se mund ta merrni këtë si observim por mund ta merrni

edhe si propozim.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Eli! Gjithsesi, propozimet e tilla janë të mirëseardhura. Edhe ata socio-psikologë që janë të interesuar të marrin pjesë me iniciativa të tilla janë të mirëseardhur. Unë plotësisht e bashkëndej shqetësimin e të gjithëve këtu, në veçanti të atyre që kanë punuar shumë në këtë fushë dhe natyrisht se pa bashkëbiseduar kështu qysh bashkëbiseduam sot dhe do të bisedojmë edhe në të ardhmen e afërt, ne nuk do të jemi në gjendje që të kuptojmë se çfarë janë interesat, çfarë janë modelet, si njerëzit konsiderohen se do të mund t'i qasemi kësaj problematike. Ne disa herë e theksuam ne sot se nuk tentohet që asgjë, as ne sot, as në vazhdimësi të merr fund. Këto janë bisedime të hapura. Janë këmbim idesh, modelim i Komisionit përmes ofrimit të këshillimeve për mundësi që secili të deklarohej, me dhënë arsyetimet. Edhe një herë po them se askush nuk ka asgjë kundër kërkujt këtu. Përkundrazi, atë që e tha njëherit zoti Baraliu që ishte edhe si propozim ishte shumë i mirëseardhur. Dhe praktikisht kjo është mënyra qysh do të ndodhë ajo. Në të gjitha këshillimet, të gjithë të interesuarit janë të mirëseardhur. Kërkush as kërkujt nuk dëshiron që t'ia mohojë të drejtën që të merret me këtë fushë, t'i ofrojë faktet, t'i këmbëjnë përvojat dhe që të argumentohet rreth tyre. Mirëpo, e tëra kjo duhet të bëhet në një gjuhë konstruktive. Me një gjuhë të baraspeshuar mirë, për arsye se qëllimi ynë është i mirë. Unë këtë qasje kaq energjike, ndonjëherë, kushtimisht po e them me tone të larta, e shoh përsëri si një nevojë dhe dëshirë të madhe që të gjendet zgjidhja dhe zgjidhjet ekzistojnë, aty vetëm duhet të bëjmë përpjekje që t'i kanalizojmë mirë, t'i orientojmë aty ku duhet. Kështu që edhe kjo ideja absolutisht për formimin e Komisionit në nivel nacional është e mirëseardhur dhe duhet dhënë hapësirë qysh mendohet të bëhet kjo. Pse mendohet, pse një pjesë e madhe mendon ashtu dhe qysh këto të harmonizohen. Ka pasur edhe mendime të tilla se qysh duhet të funksionojë në të ardhmen.

Domethënë krejt kjo që ne po bëjmë, është këmbim informatash, përvojash, me një fjalë është proces dhe mësim. Dhe askush këtu nuk po tenton të marrë pronësinë mbi diçka që është shumë e lëndueshme, është shumë e dhembshme. Ne jemi qytetarë dhe aktivistë të vullnetit të mirë, që duam ta bëjmë një shërbim për hir të atyre që më së shumti janë goditur, që t'u jepet mundësia që drejtësia të vjen në vend. U theksua disa herë që këto çështje në mënyrë meritore do të mund t'i shqyrtojnë, të vendosin dhe sqarojnë qeveritë. Mirëpo, deri te arritja e këtij qëllimi që qeveritë të jenë aktive, të japin pëlqimin zyrtar, të japin vulën e fundit fatkeqësisht apo fatmirësisht unë kisha me thënë, ekziston ndërgjegjja e shoqërisë civile roli i së cilës është i madh që proceset e tilla i merr për obligim t'i shtyjë përpara. Jo për hir, absolutisht jo, për hir të biznesit material që mund do të thoshte apo mendonte dikush. Përkundrazi, pikërisht për hir të borxhit moral e njerëzor që e kemi ndaj atyre që quhen viktimat gjithkund.

Prandaj, edhe një herë po theksoj, unë nuk konsideroj se ka përçarje këtu, absolutisht. Për arsye se të gjithë ne, qoftë në rrugë nacionale, rajonale e ndërkombëtare, e kemi vetëm një qëllim i cili është që drejtësia karshi viktimave të vihet në vend. Faleminderit! E zgjata pak. Fjalën tash po ia jap Natashës dhe jeni të ftuar të përgatiteni edhe të tjerët për diskutim.

Natasha Kandiç: Unë do të provoj t'i paraqes disa argumente për atë se në Kosovë prapë se prapë me këto konsultime është hapur një proces i rëndësishëm. Për atë të kaluar, për të zhdukurit, për ato krime të luftës gjer tani është folur vetëm në rrethin e shoqatave koordinuese. Nuk ekziston asnjë trup tjetër, ndonjë në rrethin e shoqatave dhe komisionit të pushtetit për persona të zhdukur. Nuk ekziston asgjë në shoqëri që e ka

hapur atë hapësirë për diskutimin e asaj çka është bërë, çfarë ka ndodhur në atë të kaluar. Nuk ka pasur rast, që për shembull të rinjtë, studentët të jenë të kyçur në atë. Nuk ka pasur rast që këtu në nivelin e Kosovës ose në nivelin regional që çfarëdo grupesh të jenë të kyçura në ndonjë diskutim e cila i takon të kaluarës. Do të thotë, argumenti i parë i rëndësishëm për këtë një iniciativë është që gjithkund në regjion ka filluar një proces konsultativ, një debat për atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën. Kjo është, ju lutem, më e rëndësishmja. Sot,, me të rëndësishmen që ne kemi mundur ta dëgjojmë nga Kushtrimi, çfarë kemi mundur të dëgjojmë nga i riu nga Vushtrria. Ky është rast për të gjithë, për këtë duheni ju më të vjetrit, zotëri Halit dhe Xhafer të kenë kujdes që ekziston dikush në të ardhmen, ekziston ndonjë gjeneratë, ekzistojnë disa gjenerata të ardhshme. Do të thotë duhet të ekzistoj një proces shoqëror që të bisedohet për atë. Nuk është e saktë që ky proces i raporteve dhe konsultimeve për të kaluarën i takon vetëm viktimave dhe shoqatave të viktimave. Gjithsesi shoqëria ka të drejtë dhe obligim të dijë çka ka ndodhur në të kaluarën. Kjo është e drejtë e tij Kushtrimit. Kjo është e drejtë e imja e Shukrijes, kjo është e drejtë e familjeve të viktimave, kjo është e drejtë e shoqërive veç e veç . Sipas kësaj formohet bashkësia njerëzore, sepse i ka disa të drejta dhe obligime edhe në raport me ndërtimin e ardhmërisë, e edhe në raport me mbajtjen në mend dhe kujtimin për atë çfarë ka ndodhur. Do të thotë, kjo është një gjë të cilën duhet ta keni parasysh. E dyta. Sot e kemi dëgjuar Xhafer Veliun i cili ka përmendur disa ... ai ka folur sikur për ndonjë ... Duhet që Serbia së pari të kërkojë falje, që të dëmshpërblehen familjet, që të gjinden dhe të kryhen ekshumimet, që të zgjidhet fati i të zhdukurve, dhe thotë dhe ka thënë – e tek pastaj pajtimi. Sikur t'i zgjidhnim të gjitha këto, po nuk ka fare nevojë të formohet komisioni, as të angazhohemi për formimin e ndonjë komisioni, nëse ne presim që mundet në ndonjë mënyrë të ndodh që ja Serbia të kërkojë falje pastaj që dikush të zbuloj varrezat masive pastaj të bëhet identifikimi, pastaj nuk kemi arsye që të angazhohemi që të themelohet ndonjë komision. Pikërisht pasi që kjo nuk është, na nevojitet një hapësirë nevojitet edhe angazhum jo vetëm i shoqërisë civile në një moment por do të jetë dhe duhet të jetë projekt shtetëror, ju lutem, që ne të arrijmë gjer te ajo që të vërtetohen faktet të cilat do të flasin për atë që Xhaferi thot. Të shohim, jo vetëm atë që thot Xhavit Berisha, kur thotë se nuk është në pyetje aty individit por është shteti. Saktësisht, ato komisione me interpretimin e të dhënave dosido ato pasqyrojnë edhe atë nivel të përgjegjësisë shoqërore. Por të gjitha këto mund të arrihen vetëm kur ekziston një lloj trupi regjional. Bosnja dhe Hercegovina Dy herë kanë qenë iniciator për formimin e komisionit nacional të Bosnjës. Dy herë! Asnjë herë nuk ka kryer me sukses pasi që në Bosnje e Hercegovinë nuk mund të arrihet gjer te e vërteta dhe faktet përderisa në këtë nuk janë kyçur edhe Kroacia dhe Serbia. Pasi që, kryesit e shumtë, urdhërdhënësit, ata të cilët i kanë sjellë vendimet, formacionet, policia, ushtria kanë ardhë nga Serbia. Prandaj këto nuk mund të vërtetohen në një nivel nacional. Ose, ky komision për Srebrenicë ky është gjer tani trupi më i rëndësishëm i themeluar zyrtarisht i cili ka sjell gjer te konstatimet e disa fakteve. Për fat të keq, raporti i atij komisioni nuk është diskutuar publikisht. Këtu edhe është problemi i madh por ai komision ka bërë dhe ka sjellë një pranim te parë publik zyrtar se Republika Serpska dhe ushtria e saj janë përgjegjëse për vrasje, pushkatime, likuidime të 8.000 Myslimanëve. Në Serbi ka qenë provuar që Tribunali i Hagës të minimizohet dhe të formohet komisioni, e ajo është e ashtuquajtura “komisioni i Koshtunicës”. Ajo nuk e ka pasur për qëllim të vërtetoj faktet dhe ka mundur, për shembull, sikur ai komision të kishte qëllime të ndershme dhe ai që e ka themeluar të

vërtetohet dhe të nxjerr faktet për ato se çfarë kanë bërë policia dhe ushtria e Republikës së Serbisë në Kosovë. Jo, nuk ka qenë ajo ide e atyre që kanë propozuar por kanë dashur të tërtojnë të minimizojë dhe të bllokojnë punën e Tribunalit të Hagës dhe që ashtu bashkësia ndërkombëtare të argëtohet me atë far komisioni të Serbisë. Çdo iniciativë është e mirë. Nëse ju mendoni se juve mund të ju ndihmojë komisioni nacional i Kosovës atëherë dikush duhet të ulet dhe të merret seriozisht me atë. Duhet me të vërtetë të shikohet se me çka do të merrej ai komision. Nuk duhet të harrojmë se ekzistojnë komisionet qeveritare për të zhdukurit. Por duhet pastaj të ulemi të kemi idenë e saktë dhe ta zhvillojmë atë ide të cilën dikush e ka rreth saj. Ne jemi koalicioni për KOMRA por nuk përjashtojmë që këto konsultime lirisht të kenë qasjen dhe kohën dhe kujdesin tonë dhe atyre të cilët kanë edhe iniciativa të tjera. Por, ne jemi të fokusuar në viktima, në pranimin në nivelin regional. Dëshirojmë që viktimat nga Kosova - viktimat e policisë serbe, ushtrisë serbe të fitojnë hapësirë, të mundin të dëshmojnë për këtë publikisht në Serbi, apo në Kroaci. Ju gjithashtu e dini e dini për këtë që foli sot Salem Çorbo. Të gjithë e kemi ndarë një të kaluar të përbashkët. Dhe duhemi që në fund të sjellim ndonjë llogari për atë të kaluar, të vërtetojmë ato fakte dhe të tregojmë se çka ka ndodhur. Nuk është qëllimi i kësaj iniciativës sonë pajtimi (falja). Pajtimi është një shprehje e cila lidhet me komisionin Jug-Afrikan. Te ne kjo shprehje nuk ka ndonjë kuptim të mirë pozitiv. Te ne as e vërteta nuk është e pranuar në kuptimin më të mirë. Prandaj ne flasim për faktet, sepse faktet askush nuk mundet t'i kontestoj, sepse ato janë shumë të dëshmuara dhe ne dëshirojmë që në këtë regjion të krijohet dhe të vërtetohet së paku minimumi fakteve të cilat askush nuk do të ketë guxim t'i kontestoj. E ju lutem, ne do t'i kushtojmë aq kujdes të dëgjojmë propozimin tuaj dhe ndoshta ai komision të cilin ju e propozoni dosido do të jetë në disa elemente kompatible me këtë komision regional por të gjithë ne jemi shumë larg nga ky komision regional, ne nuk do ta formojmë por e vlerësojmë që këtë një vit e gjysmë sa na ka mbetur dhe kjo është një kohë tepër e rëndësishme sepse për herë të parë po hapet hapësira, kemi konsultime që të mund të për atë që ka ndodhur, të kemi iniciativë si të përgjigjemi në atë që ka ndodhur dhe gjithashtu kemi idenë dhe iniciativën të diskutojmë për atë se cilat masa mund t'i propozojmë në mënyrë që për atë që flasim gjithnjë për kthimin e dinjitetit viktimave ashtu që ajo të jetë një mënyrë temë kryesore e atij KOMRAI dhe në përgjithësi të gjitha shoqërive të cilat marrin pjesë në këtë proces konsultativ. Unë vetëm i kisha përshëndetur shumë këto propozime të zotëri Baraliut që këtë konsultim, këtë debat në përgjithësi për atë që ka ndodhur, që kyçim pjesëtarët e bashkësive fetare dhe të kemi më shumë kohë për konsultime ti japim pjesëtarëve për paraqiten e mendimeve dhe iniciativave të tyre.

Shukrije Gashi: Urdhëroni, Haki!

Haki Kasumi: Po, unë po bëj përpjekje me hap temë ose debat. Jam Haki Kasumi, Këshilli koordinues i asociacioneve familjare të zhdukurve të Kosovës. Me interesim të jashtëzakonshëm përcjella filmin dhe përgëzoj organizatorin për një hap dhe veprim të tillë shumë të qëlluar. Arriti që të na unifikoj në koncentrik të gjithëve këtu dhe nga kuptimet e mia dhe përqendrimi im unë kam nxjerrë dy gjëra me interes shumë të madh të cilat konsideroj se do të na shtojnë të thellojmë mendimin për këtë iniciativë dhe ide e cila, siç thash edhe më parë, është e rëndësishme, është pozitive dhe sigurisht varet prej momentit kur ajo do të fillojë të implementohet edhe në rrethanat e Kosovës. Në plan të parë, unë do të bëj një koment. Konsideroj se qëndrimi i një pjese të madhe të asociacioneve dhe të faktorit vendor të Kosovës, të cilët kanë arsytet e veta, normal të

cilat nuk i kemi elaboruar sa duhet dhe nuk i kemi nxjerrë ende në formën e duhur dhe në letër për t'i bërë publike ato, por shembull i filmit, konsideroj, sipas pikëpamjeve të mia dhe përshtypjeve nga filmi që pash – e vërtetojnë atë të drejtën tonë se një komision i tillë veproi edhe në nivel të një shteti. Nuk ishte, sa unë kuptova, një komision regjional ky, por ishte një komision nacional i cili megjithatë nuk bëri çudira por arriti që çështjen ta lëvizë përpara dhe me siguri në një perspektivë ose me një hap tjetër nëse problemi ka patur shtrirje edhe jashtë Marokut atëherë vetvetiu nevoja do t'i detyrojë ata njerëz që të shtrihen dhe të krijojnë mekanizma regjional jashtë kufirit. Por ky shembull praktik mua më jep dhe më forcon bindjen dhe ma merr mendja se hapi i parë shumë i rëndësishëm që është gjithashtu në vazhden e çuarjes përpara të kësaj iniciative pozitive është edhe qëndrimi ynë që të fillojë me një komision. Nuk po dua me thënë nacional, sepse, për fat po them me Kushtetutën e Republikës së Kosovës shteti i Kosovës është definuar si shtet multinacional dhe unë po them nën një komision në nivel të Kosovës ose me një komision multinacional të gjitha nacionaliteteve që e përbëjnë Kosovën. Dhe, çështja e dytë, në të cilën do të ndalem është për një fenomen që e pash aty dhe që më bëri përshtypje për situatën aktuale, sidomos për çështjen me të cilën merrem unë dhe një pjesë e njerëzve të goditur nga lufta e fundit është se 40 vite në shtetin e Marokos në burgje dhe kthina të ndryshme ose shtëpi të ndryshme të panjohura u mbajt, u tha, një numër i madh i njerëzve për të cilët askush nuk ka patur informacion dhe nuk ka ditur. E lus zonjën Natasha të përgjigjet, gjegjësisht nëse ka ndonjë hulumtim ose koment, a thua bindja shumë e përhapur te familjarët e zhdukur në Kosovë dhe e cila është gjallë edhe sot e kësaj dite, a ka ndonjë mbështetje dhe a ka mundësi të ketë ajo shpresë e tyre ndonjë perspektivë reale, ose a është bërë ndonjë hulumtim i organizatës së saj joqeveritare ose i ndonjë segmenti tjetër të shoqërisë civile të Serbisë që të hulumtojë burgjet sekrete në Serbi, burgjet ose shtëpitë në të cilat, sipas bindjeve të familjarëve të cilëve u mungojnë të afërmit e tyre dhe të cilët kanë sipas përshtypjeve të tyre edhe argumente, edhe informatorë, edhe shenja për jetën e tyre e cila kalon në segmente të errëta të shtetit të Serbisë. Pra, do ta kisha lutur nëse ka ndonjë hulumtim ose ndonjë koment apo përgjigje për këtë përshtypje time që e pash. Përderisa një realitet i tillë ka mund të jetojë 40 vjet në Maroko, pse nuk do të kishte mundur, për shembull në Ballkanin tonë ku syri ose kontrolli i pushtetit është, të them ashtu, ndoshta i mbyllur ose jo vigjilent sa duhet. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit, Haki! Natasha?

Natasha Kandi: Një është të bisedohet me familjet, e një kur, për shembull, po të ishte këtu ndonjë nënë dhe të thotë biri im është zhdukur dhe unë ju besoj informatave se ende ka burgje të fshehta dhe që biri im është diku në atë burg. Unë pastaj nuk do të ... dhe them: e dini, kjo nuk është e vërtetë, nuk ka më burgje të fshehta, sepse ashtu nuk mund t'i thuhet një nënë. Kam pasur jo kaheerë, në Suharekë, një situatë të tillë ku kam qenë shumë jo taktike dhe ai, njëri, baba pastaj më ka thënë, e dini, unë të gjitha këto i di, por unë dua – dua – dua, tri herë ka thënë se, dua të besoj se ka shpresë që ai është gjallë, këtë e ka thënë për të birin e tij. Por, dhjetë vite kanë kaluar edhe në Kosovë, edhe në Serbi edhe në të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë kanë qasje për kontroll Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, komisionet e Këshillit Evropian, Bashkësisë Evropiane, Kombeve të Bashkuara. Do të thotë nuk ekziston asgjë, as në Kosovë, as në Bosnjë e Hercegovinë, as në Kroaci që mund të jetë e mbyllur për Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, që mund të jetë e mbyllur për cilin do institucion në përgjegjësinë e të cilave janë raportet për të drejtat e

njeriut, për raportuesit e Kombeve të bashkuara, Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, do të thotë, të gjitha kanë qasje për kontroll. Ajo që është e mirë, kurdo që dikush, nëse disponon me ndonjë të dhënë për atë, që ka indikacione se është në ndonjë vend, se ndoshta është në ndonjë burg të fshehtë, duhet t'i thuhet menjëherë Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe menjëherë duhet t'i thuhet edhe cilësdo ambasadë, anëtare të Bashkimit Evropian ose kryesuesit të Bashkësisë Evropiane, sepse, ata menjëherë do ta vërtetonin, natyrisht, me kanalet e veta të ndryshme diplomatike. Prandaj nuk është më asgjë sikur para qershorit të vitit 99 që gjërat të mund të zhvillohen, ose atëherë kur njerëzit kanë qenë në burgjet në Serbi se mund të ndodh diçka, e që ajo është larg, se ajo është plotësisht e vlefshme. E vetmja që është e sigurt sot është se nuk mundet as Bashkësia Evropiane, as Kombet e Bashkuara e as Këshilli i Sigurimit që ti zbuloj varrezat masive përderisa nuk i jep të dhënat ai që i ka bërë. Kurse të gjitha të tjerat kanë qasje. Çdo burg ka qasje, mund të ketë kontroll në të. Përndryshe, vetëm kisha dashtë të shfrytëzoj këtë situatë edhe për diçka. Kur thoni komisioni multinacional në Kosovë, duhet të mendoni dhe të kenë parasysh çka do të ishte mandati i atij komisioni, çka të vërtetoj nëse ekziston dhe nëse do të jenë shumë shpejt të njohura dhe të emërtuar të gjitha të dhënat për viktimat, të vrarët dhe të zhdukurit. Paramendoni për atë që ai komision nuk mund të zbuloj varreza masive në Serbi as kudo përderisa dikush njk jep fakte. Kështu që, kenë kujdes se nuk është i parëndësishëm ky Komision pushtetar për të zhdukurit. Atë ajo e hap, vetëm tani institucioni zyrtar i qeverisë i cili e ka atë kanal për tu drejtuar, të kërkoj ndonjë të dhënë, të bëj presion, të kërkoj ndonjë të dhënë. Nuk ka asnjë trup tjetër, Dhe ai komision nuk mund të ndërprehet. Gjithkund në të gjitha shtetet, ekzistojnë këto komisione të qeverisë. Ekziston në Serbi Komisioni qeveritar, në Bosnje dhe Hercegovinë në vend të komisionit ekziston instituti për të zhdukurit. Në Kroaci ekziston Komisioni për të zhdukurit, Do të thotë këto janë trupat zyrtare që funksionojnë, të cilat bashkëpunojnë në mes veti, shkëmbejnë të dhënat të në cilat opinionin nuk ka qasje.

Shukrije Gashi: Faleminderit Natasha! A dëshiron ndokush? Urdhëro, Xhafer!

Xhafer Veliu: Xhafer Veliu. Unë nuk e thash atë që mendon Natasha se thash për komision, por familjarët e kërkojnë atë drejtën e tyre. Nuk iu intereson familjarëve kush bëhet komision. Unë kam qenë vullnetar prej 99. E din edhe Natasha, e dinë edhe të gjithë, Kryqi i kuq ndërkombëtar dhe kam ndejt me të gjithë ndërkombëtarët. Kam kërkuar prej tyre përgjigje për këta të zhdukurit çka do të bëhet. Asnjëherë me shkrim askush s'më ka kthye kurgjo. U bënë 11 vjet. Ishalla, dhashtë zoti nuk bëhen edhe 11 tjera, e që familjarët të mos dinë për më të dashurit e tyre. Për këtë thash unë s'jam për komision, as nuk jam kundër komisionit. Sot e kemi shtetin – Republikën e Kosovës. E kemi Qeverinë tonë, kemi Presidentin. Kjo do të shkojë edhe në marrëveshje me Qeverinë dhe me Presidencën. Nuk mundemi ne të zgjedhim asgjë pa Qeverinë tonë. Kjo është e tëra. Natasha unë nuk thash asgjë për komision, as nuk jam kundër komisionit. Kushdo qoftë le të zgjedhet dhe unë nuk jam kundër tij. Qeveria e Kosovës është për këtë. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit, Xhafer! Zoti Mërlaku?

Ymer Merlaku: ... Natashës që thotë se Kryqi i kuq e asociacione të ndryshme që e kanë bërë hulumtimin në Serbi, andej e këndeje, ia kisha parashtruar vetëm një pyetje. Karaxhiqi, sa vjet ndejti pa u gjet në Serbi. Po edhe Ratko Mlladiqi, edhe ai është i fshehur diku në Serbi dhe s'po mundet kurrkush me gjet, dikush e din ku është. Ndërsa,

sa i përket çështjeve tjera, unë s'di sa herë e kam thënë. Lufta është shkaktuar si rrjedhojë e politikës, politikës hegjemoniste, gllabëruese, sunduese e tjera mbi një popull tjetër. Po, rrjedhimisht kjo mund të zgjidhet. Nëse politikisht është shkaktuar, zgjidhet me mjete politike. Me mjete politike nga qeveria, institucionet, shteti. Shteti ka mekanizma të vetë, ka gjykatën, ka prokuroritë, ka ministrinë e drejtësisë dhe krejt këto që merren me këtë çështje, që janë të obliguara. Dhe, shteti, me ligje, me kushtetutën e vet dhe me të gjitha, është i obliguar ndaj popullit të vet po edhe ndaj popujve tjerë që t'i bëjë publike ato sene. Ndërsa, askush, aq më pak familjarët, çdo familjar ka qejf që drejtësia të shkojë në vend. Po nuk mundesh t'i me i bindur se ky komision do të bëjë diçka të mrekullueshme. Unë nuk mendoj! Ndoshta jam jashtë asaj rregulle që thuhet, por unë nuk besoj. Sepse, kam lexuar që, edhe ato komisione që kanë qenë të formuara në ish-shtetet në konflikt, kanë pasur të njëjtën rrjedhë, janë prishë, janë ç'formuar, domethënë nuk e kanë arritur qëllimin e duhur. Këtu e kam qëllimin. Kaq, faleminderit!

Shukrije Gashi: Urdhëroni, Ruzhdi! Një moment, se nuk po di kujt me ia dhënë më parë fjalën.

Ruzhdi Jashari: Unë po kërkoj falje që e marr fjalën për s'dyti. Ndoshta nuk hy borxh shumë por megjithatë ndiej obligim me i prekur disa çështje. Së pari, ma merr mendja se nuk ka dilema për njerëz që janë në ballë të kësaj tavoline për asociacionin "Partners" të Kosovës, domethënë nuk ka dyshime sepse Shuki bashkë me ekipin punon për të mirën e vendit, për të mirën e Kosovës, për qytetarët e saj. Domethënë, është e dëshmuar. Së dyti. Nuk po dua ta vë në dyshim edhe zotin Çorbo, që punon për të mirën e qytetarëve të Bosnjës, për të mirën e vendit të vet. Njëkohësisht për të mirën e vendit të vet punon edhe zonja Natasha Kandiç. Domethënë, duke tentuar me i luftuar të ligat e popullit të vet, ndikon pozitivisht në popullin e vet, secili. Në njërën anë, kemi kërkesën e vazhdueshme që koha po brenë, koha po merr, koha po na rrënon ndër këmbë dhe po ecin vitet – dhjetë vite dhe pesëmbëdhjetë vite. Në anën tjetër, kemi kërkesa që a mos është herët. Dhembja, brenga, krejt këto janë me ne prezentë vazhdimisht. Mua po më bien në mend fjalët e një raportuesi të një televizioni të huaj BBC me rastin e varrimit më 11 shkurt në Reçak, të masakruarit e Reçakut. Dhe, thotë, raporti i fundit kur mbulohen viktimat. Thotë "paqja dhe liria, një ditë do të vjen në Reçak, do të vjen në Kosovë, mirëpo qetësia shpirtërore e njerëzve do të jetë shumë e vonuar". Për qetësinë shpirtërore, ne e dimë që e kemi të vonuar. Mirëpo, qetësia jonë dhe ankthi ynë përsëri vazhdon dhe akoma më tej sa ne jetojmë në këto problematika kështu. Adresa e zgjidhjeve të problemeve janë tri qeveritë: Qeveria e Bosnjës, kushtimisht po them, Qeveria e Serbisë – shkaktarja e luftës dhe luftërave në Ballkan, pastaj Qeveria e Kosovës. Krejt këto tri qeveri me ngacmime të brendshme, faktori i brendshëm mund të lëvizë. Mirëpo, nga presionet e jashtme, nga presionet e jashtme ku pret me aderua Serbia, ku pret me aderua Kosova, ku pret të shkojë edhe Bosnja, problemet e zgjidhen ashtu. Unë po nxjerr një shembull konkret, pragmatik. Ne kemi në jetën e përditshme këtu ndërhyrjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Domethënë një mekanizëm, një asociacion jashtë Kosovës. Po e bie një letër, thotë nuk ka para, domethënë zvogëloi vendet e punës, kriter. Pastaj kemi organizma regjionale plotë që ndërtojnë jetën publike të shoqërisë civile, gjysmë civile dhe qeveritare. Ndikimi i mekanizmave, Cefta, Efta, që i kemi në rajon, Kosova i ka dhe është e aderuar diku si anëtare dhe 5-6 shtete, 3-4 shtete diku, kanë bërë efektet e veta me ndikimin në Unionin Evropian që nesër të ndërtohen kritere patjetër që Kosova me kalua kufirin, qoftë të kalimit të lirë të qytetarëve, të mallrave e ku ta di unë – tarifat.

Organizimi i një institucioni të një niveli rajonal është obligativ. Kush e nis i pari dhe kush e nis i fundit, janë çështje krejt të ditës, çështje të kalueshme ato. Janë shumë të respektuar të gjithë ata që kanë punuar, të gjithë ata që pretendojnë të punojnë dhe më mirë është mos me u vonuar në organizimin e tillë. Modalitetet me i ndërtuar. Në modalitete me pas vend ata që kanë informacionet, ata që kanë shënimin dhe ata që mund të bëjnë presionin. Të parët janë asociacioni i familjarëve të Kosovës që mund të jenë aty në gjirin e këtij organizmi dhe nuk prejudikohet, as nuk ndalet asnjëherë organizimi dhe ndërtimi i asnjë asociacioni qoftë në nivel lokal, qoftë nivel rajonal, brenda Kosovës në shumë regjione, qoftë në nivel të vendit të Kosovës. Mua ma merr mendja si qytetar i thjeshtë, që e shoh këtë brengë të çdoditshme dhe çdo ditë, këto gjëra na sillen në kokat tona se koha nuk pret për të ecë në organizime globale dhe rajonale. Çështja e të drejtës së njeriut, çështja e humanitetit nuk është detyrë vetëm e një organizmi. Është detyrë e scilit qytetar që pretendon të jetojë i lirë, të jetojë i qetë dhe t'i thitë ato fryte të lirisë por normalisht edhe me u familjarizuar me brengat e njerëzve që u mungojnë të afërmit, për çka edhe jemi tubuar dhe për çka jemi të thirrur këtu. Andaj, unë shkurt edhe një herë po e potencoj, që le të bëhen organizma nacionale, në një rrafsh, le të punohet. Në rrafshin tjetër le të punohet edhe ky segment. Dy segmentet paralele le të bëhen, por të mos ndalet puna. Ndale ti këtë punë, unë ta bëj atë punë, ose ndale ti atë punë unë ta bëj këtë punë. Pra, iniciativat janë të mira, iniciativat nuk kanë të ndalur. Iniciativat qeveritare, nëse janë nacionale, në nivel të qeverisë, në nivel vendi është tjetër. Organizmi i shoqërisë civile është tjetër. Ka të drejtë të grupohet edhe ky mekanizmi qendror dhe me marrë pjesë ose si vëzhgues në këto organizmat nacionale në nivel të vendeve të ndryshme. Kërkoj falje që mora përsëri fjalën dhe bëra një ndërhyrje. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë, Ruzhdi. Kjo ishte një qasje konstruktive. Urdhëroni, zoti Halit!

Halit Berisha: Halit Berisha, jam i shoqatës “Shpresimi” në Suharekë. Ky filmi të ngërthen 3 çështje me i elaboruar këtu. E para, ne folëm për një film që ka ndodhur në Marok. Maroku është një popull maroken me një mbret i cili ka dhunuar popullin e vet dhe ka burgosur, ka sakatuar dhe të gjitha tjerat. Ne ndjejmë dhimbje shumë të mëdha. Mirëpo, të dielën e kaluar e kam pa një film, quhej “Hotel Ruanda”. E tash, në fund, nuk po dua të elaboroj, thotë – ai ushtaraku apo kryetari i Ruandës, në Tribunalin e Hagës është dënuar me burg të përjetshëm për gjenocidin që e ka bërë ndaj atyre Tucu, si quhen ata, kurse kryetari i Srbisë në Tribunalin e Hagës është liruar nga përgjegjësia. Domethënë, dy kut për një gjenocid që është bërë ndaj një popullatë. Dhe, e treta, është se unë e kam lexuar, dhe zonja e din mirë, i kam lexuar nja 2.300 faqe të transkriptit të Gjykatës në Beograd. E tash, kur e kam lexuar, vetëm 3 serbë janë që kanë pranuar se ka pasur vrasje. Dhe, unë nuk mund ta kuptoj se shefi i shërbimit informativ në Prizren i cili është e pamundur që s’e ka dit, dhe unë atë e marr si strumbullarin e informatave të cilat gjatë kohës 99 janë bërë në Kosovë dhe nuk e din se ka ndodhur ajo vrasja më 26 mars në Suharekë. S’e din ai! Nuk e dinë eprorët e komunës që e kanë larg 25 metra dhe nuk e di se a i ka aq dhe nuk e din se ka ndodhur në Suharekë. E tash, shtrohet pyetja në fund: kryekomandanti i forcave speciale të Nishit Mitroviq, lirohet. Unë e di pse lirohet. Ne e dimë pak këtë rrjedhën se ai zëvendëskomandanti i stacionit të policisë në Suharekë në deklaratën e parë ka thënë se ai ka qenë më 26 në Suharekë dhe ka thënë çka po pritni. Më vonë i ka ra pishman. Kur i ka ra pishman, ai është liruar prej përgjegjësisë. Domethënë aty është një malverzim që kam thënë unë gjithmonë se unë nuk kam besim

në gjykimet që bëhen në Serbi. E tash. Unë pajtohem me KOMRA, si po i thonë, me formimin e komisionit i cili do të bëhet. Po, unë shtroj një pyetje: E formojmë komisionin, i bëmë konkluzionet. Athua ajo Qeveria e Serbisë, e cila prej 1776 ka pru programe për shfarosjen e shqiptarëve. A thua do të ndërmer një hap për të mund ta zbardhë fatin e personave të zhdukur. Sepse, strumbullar dhe çelës kryesor i të gjitha të këqijave është shpalosja e dokumenteve sekrete të policisë dhe të ushtrisë në Serbi. Tjetër nuk ka! Se, unë jam ai i cili më ka përzënë më 1999 si refugjatë. Dhe, nuk e di unë, sepse kam shkuar shumë vonë, por ata kanë shkuar më 28 mars dhe prej 28 mars e deri kur kanë ardhur në fund të qershorit, ata nuk e kanë ditur atë. Pushtetin absolut, politik, ushtarak e policor e ka pasur Serbia dhe këtë e dinë të gjithë. E tash, cila është ajo forcë që mund t'ia shtrëngojë kokën Qeverisë së Serbisë dhe me tregua, me i hap ato dosje dhe me i treguar ato. Unë e kam përmendur atë 25-tin se Ali Cena i ka investuar nja 3 policë në Beograd dhe ata me emër i din redaksia dhe thotë: ne jemi në gjendje të tregojmë, me një dallim 5 metra, ku gjenden varrezat masive në Kosovë por me një kusht. Me një kusht – me na siguru jetën! E tash, dihen emrat e atyre policëve dhe pse ata nuk sillen në Kosovë, e me i tregua ku janë varrezat masive të cilat i kanë bërë vetë në Kosovë. E tash, ne do ta formojmë atë komision, do t'i caktojmë konkluzionet dhe detyrat, por Serbinë as Amerika s'po mundet... Ia ka kallë ambasadën dhe s'ka mund me i bë kurrigjë hiq, e ne po mundemi me i bë! Ajo është edhe më tutje shtet dhe qeveri, ajo e cila vetëm t'i jepet rasti se ajo që ka ngjarë në 99 kishte me qenë uverturë e një opere, me shfaruar të gjithë popullin shqiptar. Unë nuk kam besim. E ata të rinjtë që kanë besim, le të urdhërojnë. Unë po e pyes zonjën Kandiq, pse atë ditë kur është bërë shqiptimi i dënimeve në kufirin Merdare shqiptarëve të cilët kanë pasur letërnjoftim të Kosovës iu është ndaluar me shkuar me letërnjoftim të Kosovës në Serbi. Përse? A është ai dokument? Ia kanë marrë edhe pasaportën dhe ata kanë shkuar pa identitet në Serbi. Përse, e kanë bërë atë? Unë po pyes tash. Sepse ata që kanë shkuar, më kanë treguar se na i kanë ndalë letërnjoftimet që kanë pasur emblemën dhe stemën e Republikës së Kosovës dhe pasaportën e Republikës së Kosovës. Domethënë, a kam unë siguri sot vet, me pasaportën e Republikës së Kosovës të shkoj në Beograd. Mua s'më lejojnë me shkua me marrë shënime të cilat nevojiten ne, sepse unë e di kush kanë qenë. Unë shkoj në Llazarevc, unë shkoj në Smederevë, unë shkoj në Llapovo, unë shkoj në Sremçicë dhe i gjej ata serbët e Suharekës të cilët kanë ikur prej këtu dhe me bisedu me ta, se ata e dinë që kanë bë krime në Suharekë. Po unë s'mundem me shkua, sepse s'kam siguri. Ky është problemi që më mundon për formimin e saj dhe qëndroj në këtë që të bëhet ai këshilli kombëtar këtu dhe ata le të vendosin se çfarë do të kenë raporte me atë këshillin rajonal dhe çfarë do të ndërmarrin për me mund me zbardhë fatin e personave të zhdukur në të gjitha shtetet ku ka bërë krime Serbia. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit! Natasha?

Natasha Kandiq: Unë mendoj se të gjithë ne këtu duhet të kemi kujdes (llogarisim) çka është në interes të viktimave, ju lutem të mos mendojmë ose diskutojmë në kuptimin se çfarë qëndrimi do të marrë ky apo ai trup. Serbia apo ndonjë shtet tjetër, lidhur me KOMRA-n kjo është ende çështje, nuk mundemi vetëm me këto konsultime të definojmë, çka themi dëshirojmë këtë apo atë komision i cili do të ketë aftësinë e hetuesisë, që mund të marrë çdo dokument ose në konsultime do të arrijmë gjer te ajo që shumica do të thotë – nuk mendojmë se shteti do të pranoj që ai komision ka fuqinë që të gjithë t'i thërras të dëshmojnë. Prandaj janë ato konsultime, të shohim çka mundemi, çka nuk mundemi.

Këtë komision e fortëson sepse është regjionale. Pastaj, nëse keni dëgjuar me kujdes, zotëri Ruzhdiun, ai gjithnjë na thotë se të gjitha shtetet e ish Ballkanit dëshirojnë të hyjnë në Evropë. Evropa është, ai lloj vizioni, ai cak. Për Evropën sigurisht që këtu nuk do të përsëritet krimi, shumë më shumë ai komision regjional sesa cili do komision nacional. Për Evropën, atëherë e di se këtu do të vijë gjer te njëfarë stabiliteti regjional, se ekziston bashkëpunimi regjional, komunikimi, që të zgjidhen disa çështje në nivel regjional. Kjo është e rëndësishme për Evropën. Kjo është e rëndësishme për të rinjtë sepse, nëse formohet ai komision regjional, atëherë të gjitha shtetet e ish- Jugosllavisë do të pajtohen për hir të atyre të rinjve, për gjeneratat e ardhshme, është e rëndësishme të kemi një trup i cili do t'i liroj ata të rinj nga përgjegjësia për të kaluarën. Kjo është një masë shoqërore e shtetit, për derisa arrijmë te ajo. Përndryshe tani të kthehem në pyetjet e juaja. Duhet të jeni më të qartë, që njerëzit këtu të kuptojnë qartë për çka po flitni. Ju uluni, e di se ju i keni lexuar të gjitha transkriptet, por këtu atë nuk e kupton askush. Ja e para çka është. Nuk është fakt i ri se Serbia nuk e pranon Kosovën, se nuk i pranon dokumentet e Kosovës, Këtë e dimë të gjithë. Ne si organizatë për të drejtat e njeriut bëjmë presion, ne gjithnjë flasim kur ministri punëve të jashtme i ë së thotë – “Kosova është pjesë e Serbisë” e ne publikisht flasim se ajo nuk është e vërtetë. Po pse nuk vjen në Kosovë e ta thotë atë. Por ju mua më pyetni, në të vërtetë më thoni pse e ke marr një mostër të dokumenteve. Mënyra e vetme ka qenë që shtetasit e Kosovës të hyjnë në Serbi, të hyjnë pa dokumente. Kështu nuk ka askund në botë, dhe së paku këtë e kemi arritur që ata të mund të hyjnë të përcjellin atë shpalljen e gjykimit. Ndonjë herë të kaluar kemi arrit që dy persona të hyjnë me dokumente të Kosovës, por kjo tani është ndonjë herë, një pyetje e rëndësishme për organizatën për të drejtat e njeriut të bëj presion që Serbia të ndërprej atë farsë që gjithnjë e konteston sovranitetin e Kosovës, Kjo është një gjë. E dyta, kjo që thuani ju për gjyqet. Atë që e keni cekur nuk është e saktë, zotëri Halit. Nëse i padituri, i cili mbron të paditurin tjetër ndryshon dëshminë, dhe aty gjyqi nuk mund të bëj asgjë, është e drejtë e tij të ndryshoj dëshminë. Por gjyqi pastaj, e humb dëshminë.. Kjo është diçka kështu që duheni t'i paraqitni në mënyrë të drejtë faktet dhe të dhënat të cilat i dëshmoni. Dhe gjithashtu nuk keni thënë, po që ai komandant është liruar para shtatë viteve por nuk është lëshuar dhe ju e dini shumë mirë këtë, sepse unë e di se çka lexoni ju, e di edhe numrin e faqeve që i keni lexuar, e di që ju i merrni transkriptat dhe të gjitha i lexoni. E pastaj sigurisht e dini që ai Mitroviqi i cili është liruar nuk është lëshuar nga burgu sepse ne para asaj e kemi ngritur një padi krimi në atë gjykatë, në të cilën ju dyshoni, ai e ka dhënë urdhrin për burgosjen e tij. Kështu që kjo nuk është punë e vogël që e ka bërë organizata për të drejtat e njeriut dhe është në kundërshtim me atë që thoni për gjyqin. Ajo Prokurori, prokuroria Serbe atë e ka mbajtur në burgim. Prandaj atij do t'i mbahet gjykim i ri, ai nuk është liruar por ka mbetur në burg. E tani, mund të paramendoni sa është urrejtja e tij nesh që e kemi sjellur gjer te kjo dhe ndaj asaj prokurorie e cila e ka lënë në burg. Më duket që sa më shumë kalon koha, mendoj nga ai diskutimi i parë i Zoteri Halitit, ne jemi gjithnjë e më konstruktiv, ndoshta të mbetemi deri nesër ndoshta atëherë so të hapnim është çështje tjera të rëndësishme për të cilat është e rëndësishme të diskutohet kur është fjala për të kaluarën dhe çka ne dëshirojmë. A dëshirojmë që të rinjtë të urrehen në mes veti në regjion, që të mos komunikojnë, të mos udhëtojnë, që të rinjtë nga Kosova të mos shkojnë kurrë në Kroaci, të mos shkojnë kurrë në Bosnje, të mos shkojnë askund, që të rinjtë nga shtetet tjera të mos vijnë këtu? Po komunikimi është i rëndësishëm, është i rëndësishëm bashkëpunimi rajonal. Është e

rëndësishme, për që të mund ta fitojmë duhet të kemi shumë fakte të vërtetuara për atë se çka ka ndodhur, që askush të mos i kontestoj. Dhe hajde të provojmë ta bëjmë këtë, atë që mund ta bëjmë. Nuk mundemi ne, ku ta di, të sjellim vendime në vend të qeverisë. Kush e di çka do të bëhet kur ne e bëjmë këtë model, kur t'i mbledhim miliona nënshkrime. Mu atëherë fillon një kohë e komplikuar sepse çdo shtet, çdo qeveri do t'i ketë kërkesat e veta, dhe mendimin e tij për komisionin. Dhe pastaj përsëri vjen koha e shoqërisë civile të luftojmë për atë mandat të komisionit që si ç mendojmë do të sjellë drejtësinë për viktimat. Dëshirojmë reparacionin për viktimat, dëshirojmë që viktimat të jenë të dëmshpërblyera. Por pastaj duhet të formohet një lloj fondi dhe të precizohen saktësisht viktimat do të jenë të dëmshpërblyera. A do të, për shembull viktima e plaçkitjes, a është viktima e plaçkitjes e njëjtë si viktima e përndjekjes. E po nuk është. Këto janë gjëra të ndryshme. Por për atë kohë duhet të fillojmë të bisedojmë ngadalë dhe për propozime dhe zgjidhje shumë konkrete, edhe sa i përket mekanizmit në nivelin regional, dhe unë i jam shumë e falënderueshme zotëri Ruzhdiut i cili e ka parë saktë dhe në mënyrë precize çka është, sa një proces i tillë konsultativ në nivelin regional mundet me qenë shenjë edhe për Bashkësinë Evropiane, edhe për procesin e stabilizimit dhe shoqërimit edhe për sjelljen e ndoshta këtij vendimi për heqjen e vizave në fund të vitit. Nuk është e pa domethënëse edhe pse shoqëria civile, ky debat por ky për ata është argument, e thotë e ja, shoqëria civile arrin që të lidhet, ajo arrin të diskutoj për atë të kaluar, për ato krime të luftës. Do të thotë nuk është kjo një gjë e parëndësishme, Mendoni edhe për këtë pak!

Shukrije Gashi: Urdhëroni!

Bogdan Ivanisheviq: Unë do të doja që të thoja diçka, dhe ndoshta zotëri Kasumi nuk do ta merr këtë personalisht, thjesht ne po flasim për tema. Ju keni thënë komisioni për Maroko një argument më shumë për atë që duhet të shkohet me komisione nacionale. Por zotëri Çorbo e ka shpjeguar thjeshtë kontekstin në të cilin gjendemi ne ku trupat e të zhdukurve shpesh janë në shtetin tjetër e jo në atë vend shtetas të të cilit janë ata, ku janë faktet për krime në shtetin tjetër, ku të dyshuarit për krime janë në shtetin tjetër. Do të thotë ekziston ai kontekst regional për shkak ... krimeve që kanë ndodhur. Në Maroko nuk është ashtu. Në Maroko të gjitha kryhen brenda një shteti. Prandaj unë tani këtu nuk pajtohem se a duhet komisioni nacional apo regional por thjeshtë dua të theksoj atë se ka numër të madh të shembujve ku janë themeluar, nuk dua të them nacionale, por komisione në nivel të shteteve, se aty është punuar mjaft në atë që çdo thyerje e të drejtave të njeriut apo krimet e luftës janë kryer në kuadër të atij shteti dhe se shtetet tjera kanë qenë shumë pak apo aspak të kyçura. Do të thotë, një kontekst plotësisht i ndryshëm nga ky kontekst, kështu që Maroko nuk është shembull i mirë për tezën që komisionet në nivel shtetëror duhet të iu japin preferencë atyre. Nuk është dëshmi as për tjetrin, duhet dhënë preferencë këtij regional, por vet shembulli i Marokos nuk tregon asgjë, pikërisht për shkak të karakterit të konfliktit. Do çka për zotëri Mërlakun. A është ai? E mirë, dëgjoni. Ju keni thënë komisionet tjera nuk kanë bërë asgjë, mendoj janë të reformuara dhe nuk ka pasur efekt të punës së tyre. Por ky komision në Maroko të cilin e kemi shikuar është nga 742 persona, mendoj se shifra është 742, kur ka filluar të punoj ai komision ka ardhur në fund të fundit të punës së tij në 66 persona të zhdukur. Do të thotë se fati i 600 dhe diku 99 e disa njerëzve është zgjidhur nga anë e këtij komisioni, është vërtetuar ku janë, nën çfarë rrethanash dhe ku janë varrosur. Kjo nuk do të thotë se KOMRA-i ose ndonjë komision tjetër ka patur një përqindje poashu të lartë të lëndëve të

zgjidhura, mirëpo më së paku do të thotë për komisionet tjera se nuk mundet të thuhet se nuk kanë bërë asgjë. Ceki shembullin e Marokos, mund të ceki edhe dhjetëra komisione tjera dhe tema tjera, kontributet tjera të atyre komisioneve. Them, përsëri rreth zgjidhjes së çështjes së të zhdukurve. Komisioni Jugo – Afrikan ka filluar me diku 1500 raste të të zhdukurve dhe në fund të punës së komisionit kanë qenë 460 lëndë të pazgjidhura, do të thotë më shumë se njëmijë raste, më shumë se një e treta e rasteve është zgjidhur. Prap ky vet prej veti nuk është garancion se ndonjë komision tjetër do të ishte më efikas, por gjithashtu është një indikator që ato komisione mund të veprojnë më sukses, Ose kur është fjala për kontributin e komisioneve për gjykimet e krimit. Duke iu falënderuar punës së komisioneve në Argjentinë, në Kilë, në Peru qindra njerëz janë procesuar, pra këto komisione kanë vërtetuar faktet për shkeljet e të drejtave dhe pastaj ka ardhur gjer te ajo që këto lëndë iu kanë dorëzuar prokurorive dhe ka ardhur gjer te gjykimet, jo menjëherë, kanë kaluar 10 ose 15 vite për të filluar ato gjykime por ka ardhur gjer te gjykimet dhe faktet nga ana e komisionit janë shfrytëzuar në ato lëndë ose prokuroritë në fazë të fakteve të marra nga komisioni ka hapur hetimet dhe kanë procesuar disa njerëz. Rasti më i ri, keni dëgjuar me siguri se ish kryetari i Perusë Suhimori jo kaheerë është gjykuar, para një – dy javëve, ka marr një dënim të lartë, 25 vite ose ashtu diçka. Atje raporti i komisionit të Perusë me të vërtete është shfrytëzuar si mjet dëshmues. Do të thotë gjykata i ka marr pjesë nga ai raport, jo ato pjesë që bazohen në përgjegjësinë konkrete të Suhimorit por ato pjesë të cilat bazohen në tërë kontekstin në të cilin kanë ndodhur ato krime për të cilat Suhomiri është konstatuar fajtor dhe gjykata në bazë të raporteve të komisionit Peruan ka vërtetuar të vërtetën se vrasjet dhe kidnapimet e njerëzve në Peru në atë periudhë kur kanë ndodhur krimet ka pasur karakter sistematik, se kanë qenë të zgjeruara dhe në bazë të kësaj gjykata ka ardh në përfundim se Suhomiri është përgjegjës për krimin kundër njerëzimit. Pra, gjykata deri te ai rezultat ka ardhur në bazë të analizës të cilën komisioni e ka bërë për të vërtetën, në bazë të fakteve të cilat ai komision i ka vërtetuar. Reparacionet materiale. Komisioni marokian, mendoj 9 mijë njerëz kanë fituar reparacione materiale, atyre njerëzve që janë identifikuar si viktimat nga ana e komisionit Maroken. Prapë, këta janë shembuj të suksesshëm. Mund të përmendi edhe shumë gjykime për kundërvajtje, reparacioneve, kërtimeve të faljeve të themi, sipas çështjeve të ndryshme. Ju ose ju zotëri Xhafer, ju keni thënë se së pari kërkojmë që Serbia të na kërkoj falje, a është kështu, e pastaj ndoshta komisioni. Mirëpo, si ka funksionuar ajo ... Së pari komisioni do të vërtetonte faktet e pastaj thjeshtë për shkak të atyre fakteve kryetarët e shteteve nuk kanë pas zgjidhje por kanë kërkuar falje, në bazë të atyre fakteve. Jo menjëherë, jo të gjithë, jo njëjtë bindshëm por kjo në shumicën e rasteve ka qenë ashtu. Pra , forca e fakteve gjer te të cilat ka arritur komisioni, në një veprimtari publike forca e dëshmimeve publike të cilat i shikuam këtu e këto dëshmi kanë ekzistuar në shumë komisione tjera,i ka detyruar përfaqësuesit e shtetit që ti pranojnë të dhënat e komisioneve dhe të kërkojnë faljen e tyre në emër të shtetit. Sipas kësaj të thuhet se komisionet nuk kanë arritur asgjë, më falni, kjo është plotësisht e pasaktë. Ka komisione të cilat kanë bërë shumë pak, ekzistojnë komisione të mira dhe të këqija, ekzistojnë aspekte të mira dhe të këqija të komisioneve të ndryshme, por ashtu an-blok përgjithësisht të thuhet se nuk kanë bërë asgjë, prapë mendoj se debati ka më shumë sukses,do të jetë më kualitativ nëse thjeshtë i respektojmë faktet.

Shukrije Gashi: Urdhëroni, kush dëshiron fjalën?

Ymer Merlaku: Këtu e ndaj mendimin. Zotëriu që flet, duhet të kuptoj se këtu ka pas të

bëj luftë ndërnacionale, jo sikur lufta në Marok atje, populli vet. Ne tash jemi dy shtete. Kosova është shtet, Serbia është shtet. Tjetër është ajo ndërnacionale. Këto çështje mund të zgjidhen. Kosova e ka shtetin, ka Kushtetutën, ka ligjet, ka Qeveri, i ka të gjitha segmentet dhe mund të merret me to. Ndërsa, sa i përket atje në Afrikë të Jugut e andej, atje nuk ka ligje, nuk ka rregulla. Specifika e Kosovës është krejt tjetër me ato rajone atje. Nuk përputhen, nuk ka të bëjë. Dhe komisionet, që mendoni ju, ato komisione, nuk e di, ndoshta mund të jam edhe gabim, por ky komision ka qëllimin e grumbullimit të të gjitha dokumenteve dhe ku të di fati i tyre ku mbaron. Unë mendoj se Serbia ka bërë krim dhe nuk mund të barazohet ajo me 200 – 300 serbë të cilët janë vra në luftë të ndryshme, ku edhe ata shtetas që janë vra, i din vet Serbia ku i ka vra dhe vetë ata i dinë. Ndryshe është për shembull kur janë vra këtu afër 15.000 shqiptarë, që i ka vra regjimi serb, në mënyrë institucionale, të organizuar në të gjitha segmentet. Ajo i din dhe veç le t'i hapë dosjet. Nuk ka nevojë hiq komisione. Veç dosjet le t'i hapë Serbia që i ka dhe krejt kanë me u gjend këta të zhdukurit. Mirëpo, dosjet i ka të mbyllura dhe atëherë ne luajmë me komisione e me këto... Sall dosjet le t'i hap, sepse të gjitha vrasjet që janë bërë në Kosovë krejt i ka bë ushtria e policia në mënyrë të organizuar, more ata kanë pasur edhe regjistër dhe sa lopë i ka fshati se le më sa njerëz dhe i kanë ditë të gjitha, e s'po i dinë tash. Të gjitha i dinë. Juve ju mashtron. Popullin e vet e mashtron, i thotë kështu-kështu e kështu. Juve ju mashtron. Më falni, kaq pata.

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë zoti Merlaku. Edhe unë kisha shtuar diçka.

Pikërisht pse të gjithë ne kemi dyshime dhe dëshirë që e vërteta të dalë në shesh, që faktet të dalin në sipërfaqe, ne kemi ndërmarrë këtë iniciativë. Ne jemi të vetëdijshëm se nuk do të mund të bëjmë mrekulli si me shkop magjik për t'i zgjidhur problemet, por kjo është një iniciativë e vullnetit të mirë me u përpjek. Kjo çka është dëgjuar sot, për shembull, këtu dhe që u fol sot, është se po të mos kishim ardhë këtu s'kishim pas shans me i nda këto informata që i ndamë bashkë. Prandaj, është e rëndësishme me bashkëbisedua, me u këshillua në mes veti. Sepse, në qoftë se ne nuk do të bëjmë asgjë dhe do të heshtim se Qeveria e Serbisë është e mbrapshtë, i mbanë të fshehura faktet apo secila tjetër qeveri atëherë çfarë do të bëjmë ne, çfarë kemi bërë. Do të kalojnë edhe nja dhjetë vite tjera dhe s'do të bëhet asgjë. Njerëzit që i kanë dëshmitë dhe faktet ose kanë për të rrëfyer diçka do të vdesin dhe përsëri do të vijnë gjeneratat e reja me ngarkesë dhe lëndime për të kaluarën. Dhe ne nuk do t'i hapim rrugë vetit, siç thanë disa, edhe Ruzhdiu edhe Baraliu dhe të tjerët këtu se as Evropa dhe askush në botë nuk do të na i hap dyert neve që ne të integrohemi si të gjithë qytetarët në shoqërinë e demokratizuar.

Eli Krasniqi: Veç diçka, se po më pengon gjithë kjo... Ndoshta e kam gabim, ndoshta është njëfarë mënyre qysh me aspirua ne deri te Evropa. Personalisht s'kishte me ma ndie më pak a po më pranon mua Evropa a jo. Tërë koha është ky farë presioni – na jemi tjetri, Evropa është aty dhe ne duhet të jemi si nxënës të bindur ndaj Evropës. Jo kemi ne arsye më të mëdha se sa Evropën përballë, të cilat janë vendosja e drejtësisë përpara viktimave dhe s'kemi nevojë hiq me shku te Evropa. Po më vjen keq, por qe sa vjet pas lufte në Kosovë, tërë kohën është diçka përballë nesh që më vendos mua me u bind si nxënës të mirë me shkop që ti nëse nuk bindesh unë ty nuk ta jap pavarësinë, unë ty nuk të shti në Evropë dhe mandej fillimisht harrohet arsyeja pse bëhen përpjekjet. Mendje del sikur bëhen përpjekjet për me u tregua nxënës të mirë ndaj Evropës se sa për të vendosur drejtësinë në vend. Në këtë kontekst, arsyeja pse po e fuqizoj këtë, pse po e theksoj këtë është se edhe Qeveria në këtë rast, përderisa krejt qeveritë tjera nuk e kanë përkrahur këtë

lloj iniciative, Qeveria jonë duke qenë se nuk thotë jo për kurrigjë, e përkrah edhe këtë. Për ata pyeta fillimisht çka është reale. Mirëpo, për mos ta zgjat më shumë, më mirë është me i qartësuar sendet në shtëpi tonë dhe pastaj me dalë jashtë shtëpisë – në oborr, a dini, kështu figurativisht.

Shukrije Gashi: Faleminderit!

Kushtrim Gara: Jo, s'prish punë. Mos e merr si reagim i Qeverisë, kjo ndoshta është mirë me dhënë mendimin. Fillimisht kur fola herën e parë, e ceka se Qeveria e Kosovës përkrah çdo iniciativë që do t'i kontribuonte zbardhjes... Jo, "që do t'i kontribuonte" e kam cekur, nëse të kujtohet fjalia – "zbardhjes së fatit të personave të pagjetur". Kjo nuk do me thënë se Qeveria s'din me thënë jo ose se Qeveria din me thënë veç po. Në ndërkohë, domethënë gjatë diskutimeve, doli këtu në shesh edhe ideja për një lloj komisioni apo një lloj këshillimi nacional, që do të quhej këshillim i brendshëm, por në start duhet theksuar se Qeveria kur e përkrah çdo iniciativë do të thotë duhet me pas shumë kujdes në ndërhyrje apo në ndërhyrje të subjektiviteteve, sepse në kuadër të Qeverisë funksionon Komisioni qeveritar i cili është komision ndërministror për persona të pagjetur. Mirëpo, në qoftë se të pranishmit pajohen dhe është kërkesë e tyre që një iniciativë apo një ftesë e tillë bëhet nga ana e Komisionit qeveritar për personat e pagjetur, domethënë që të ftohen të gjitha shoqatat apo të gjitha organizmat që merren me çështjen e personave të pagjetur do të thotë është diçka se nuk përkon me filozofi të madhe dhe kjo është diçka që mund të realizohet shumë lehtë, në qoftë se është pajtim i të gjithë këtyre që paraprakisht të mbajmë ndonjë takim së paku këshillues midis nesh dhe pastaj të dalim me një qëndrim të përbashkët. Mirëpo edhe këtë herë duhet të kemi kujdes në atë ndërhyrjen çka është qeveritare e çka është shoqëri civile. Domethënë kush po mirret dhe nga po vjen iniciativa dhe nga kush po përkrahet. Nëse ju pajtoheni dhe e mirëpritni një kërkesë të tillë ose ftesë të tillë, atëherë unë qysh sot mund të jap një lloj premtimi apo një lloj zotimi se kjo do të realizohet shumë shpejt dhe kjo mund të bëhet menjëherë në javët në vazhdim. Pra, në qoftë se jo del si përfundim apo si zgjidhje e këtij problemi, apo mos t'i them problemi, por zgjidhje të momentit për të vazhduar më tutje.

Halit Berisha: Zotëriut, unë kisha me i propozua që le ta lexojë një letër që ia kemi dërguar Këshillit koordinues, zëvendësministrit Ramë Manaj, që në dorë ia kam dhënë dhe zotëri Pren Gjetës. Lexoje mirë, nja 3 faqe i ka e pastaj mundesh me konkludu se çfarë kemi propozuar që iniciativa të jetë pikërisht prej Komisionit për persona të zhdukur, të Komisionit qeveritar.

Kushtrim Gara: Nëse është fjala për zëvendëskryeministrin Ramë Manaj, unë dua me sqarua si Komisioni qeveritar gjithmonë vepron në bazë të vendimeve dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, domethënë ne e kemi atë mandatin dhe misionin e caktuar në bazë të cilit mund të veprojmë. Në qoftë se kjo zgjidhet, sepse neve kur na ka ardhur ftesa ka ardhur si një iniciativë e Shoqërisë civile për një komision rajonal dhe përkrahja ka qenë edhe nga ana Presidentit dhe nga ana e Kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit zotit Ramë Manaj dhe vetë kryetarit të Komisionit zotit Pren Gjetaj. Domethënë, nëse deri këtu ka ardhur puna gjithsesi tash do të ndërmerret hapi nga ana Komisionit qeveritar dhe po ju them se kjo do të realizohet, dhe kjo është përgjigje ndaj asaj kërkesës prej 3 faqeve që janë dërguar.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Kushtrim! Veç një sekondë. Unë dëshiroj të theksoj diçka lidhur me konstatimin e Elit. Jo, dua patjetër, Eli, të lutem. Është fatkeqësi, sinqerisht po e them, është fatkeqësi e madhe që ne të gjithë sa jemi këtu dhe të tjerët që s'ndodhin në

këtë këshillim që duhet vazhdimisht të thirremi në kushtëzimin e standardeve karshi bashkësisë ndërkombëtare. Kush është fajtor pse po ndodhë kjo? Atëherë, jemi ne. Shkalla më e lartë e vetëdijes njerëzore do të ishte që të mos kushtëzohemi. Dhe çështjet e tilla të pranohen ashtu si janë. Kjo është domethënë ajo superiorja, është dëshira. Kurse realiteti dhe mundësitë janë tjera. Gjithkund në botë ekzistojnë njerëz të vullnetit të mirë. Njerëzit e vullnetit të mirë, nuk mjafton se mund të bëjnë diçka. Dhe kur njerëzit e vullnetit të mirë s'mund të bëjnë diçka, atëherë ekziston një forcë tjetër "vis-major" që në këtë rast janë standardet që deshe apo nuk deshe ta tregon ku e ke vendin dhe për ne e mira do të ishte, do të thotë, të mos lejojmë të vjen deri te kushtëzimi por hapat t'i bëjmë vetë, t'iu paraprijmë proceseve. Është bërë shumëçka, janë mbledh faktet, ruhen nëpër sirtarë vetjake dhe e di që është e arsyeshme dhe është pjesë e ndjeshmërisë për arsye se është bërë punë për gjetjen dhe mbledhjen e atyre fakteve. Dhe, pothuaj, ajo është bërë pjesë e jetës së atyre njerëzve. Ata që i kanë mbledhë këto janë mishëruar me to. Nuk e kanë lehtë që faktet e tilla t'i shpërndajnë tutje. Unë jam shumë e sigurt, pavarësisht çfarë gjuhe këta njerëz përdorin, e kanë një porosi njerëzore, e kanë shprehjen e shqetësimit dhe gjetjen e një mundësie opsioni. E ne, të gjithë këtu, jemi për të ofruar mundësi dhe opsione, duke përfshirë edhe këtë mundësinë për komisionin multinacional e të tjera. Ti si sociologe, qasja ishte definitivisht konstruktive. Mirëpo, ajo është e dëshirueshmja. E mundshmja është diçka tjetër. Kështu që ndjeva për obligim moral e njerëzor ta theksoj këtë, kurse fjalën në vazhdim do t'ia jap zotëri Salem Çorbo, për arsye se disa herë ka tentuar me marrë por nuk munda t'ia jap fjalën. Urdhëroni, zoti Çorbo!

Salem Çorbo: Po, ja unë to të kthehem në atë që kam folur paradite. Do të shtoj edhe një theks të rëndësishëm në kuptimin që ai mund të arrihet me formimin e komisionit në nivel regjional me mandat të plotë, me kritere plotësisht të njëjta për tërë hapësirën dhe drejta plotësisht të njëjta për të gjitha viktimat. Për cilën do viktimitë duhet të sigurohen të drejta të njëjta dhe ky është trajtim i barabartë, dhe ky është trajtimi i vetëm të cilin mund ta bëjë komisionet. Shtetet duhet të identifikojnë arsyet pse të hyjnë në atë proces. Mirëpo, më duket se në këtë pjesën e pasdites nuk dëgjoj diskutime nga këndi i viktimave. Disi, sikur disa të tjera pak më kanë ... dhe mendoj që kjo pasqyron gjendjen reale në shoqëri. Unë këtu, veç e kam thënë, por nëse unë dëgjoj mirë, dëgjoj për dhjetë vite se nuk është realizuar ndonjë përparim në fushën e kërkimit të të zhdukurve. Do të ju kthej në situatën në Bosnjë e Hercegovinë. 14 vite pas luftës, ne kemi 13.000 të zhdukur. Pak më parë kemi shikuar filmin. Nëse unë kam shikuar mirë 25.000 njerëz për ato 40 e diçka vite kanë kaluar nëpër llogore. Ne i kemi 13.000 të zhdukur. Diçka nuk është mirë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në këtë regjion. Por në sektorin qeveritar i cili nuk është mjaft këmbëngulës, energjik ose qeveritë nuk janë të mira, apo viktimat nuk janë mjaft këmbëngulëse, apo viktimat nuk insistojnë mjaft për këtë. Është ndonjë problem i madh. Jo kaheerë është shpallur informata në vijim në Bosnje dhe Hercegovinë se shoqata e kursimeve devizore e Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilët janë dëmtuar me ato transaksione para luftës, i kanë bllokuar rrugën Bosnjës dhe Hercegovinës devizore gjer sa të mos plotësohen obligimet e tyre që atyre të iu kthejnë devizat. Unë këtë nuk e kam dëgjuar nga asociacionet e sektorit qeveritar. Unë këtë nuk e kam dëgjuar aga ata të cilët, përsëris, në ndonjë mënyrë të përshtatshme paraqesin interesat e atyre viktimave. Po të ishin 13.000 vetura, në Bosnje dhe Hercegovinë do të kishte më shumë hetime. Po flas për një rrugë ku po shkojmë ne nëse këto gjëra i lemë anash. Nëse këto gjëra i lejmë të përealizuara, të heshtura 10 vitet e ardhshme, 20 vitet e ardhshme, këto që i kemi

përjetuar përafërsisht ka lidhje me ato të luftës së dytë botërore e cila edhe ashtu ka përfunduar si ka përfunduar pa ndonjë distancë historike, disa shteteve koekzistente hulumtimeve dhe të dhënave publike. Frikohem se i tërë regjioni disi me dhunë do të hyjë në ato procese demokratike. Unë e kam shpjeguar pse mendoj se qasja regjionale dhe nuk mendoj më të ... Nuk mundet që Bosnja dhe Hercegovina do të përfundojë ... A e dini se cilat janë ... ushtritë kanë ardhur dhe shkuar dhe ku janë trupat e atyre njerëzve. Unë kam dhënë shembull për gjendjen e shqiptarëve. Nuk kam dëgjuar përgjigje për atë. Çka të bëj organizata ime atje. Çka të bëjë, me kënd të kontaktojë. Unë e kam marr këtë adresën e njëfarë asociacioni, unë e kam marr adresën poshtë nga Kosova dhe Maqedonia, si të lidhim hetuesit nga Bosnja dhe Hercegovina me njerëzit nga Maqedonia, si ti sjellim afër njëri tjetrit. Unë flas për gj[ra] praktike. Si ti marrin viktimat dëmshpërblimet, si të fitojnë dëshmimin publik, si viktimat të marrin njohjen. Unë do të dëshiroja përgjigje të tilla, në emër të viktimave. Kur është në pyetje presioni i Evropës. Unë nuk i dua presionet. Jam demokrat i lindur por shumë i dua presionet në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Ballkan sepse vetëm ato i kanë lëvizur gjërat, dhe vetëm ato i kanë shpejtuar gjërat. Kthimi i pasurisë, është realizuar 99%. Kjo është praktikisht çdo i dyti njeri ka jetuar në shtëpi të huaja dhe mendoj se kështu do të mbetet përgjithnjë. Mirëpo ka munguar reaksioni dhe presioni publik ndërkombëtar për krimet e luftës dhe e kemi këtë gjendje. Të them diçka për Komisionin në Srebrenicë. Këtë e ka bërë Komisioni për Srebrenicën në mandatin e dytë. Në mandatin e parë, në kohën e premierit Mlladen Ivaniq nga një parti e progresit demokratik. Atëherë komisioni i të njëjtës qeveri e ka dhënë përafërsisht këtë përgjigje, se kanë vdekur rreth 1.500 boshnjak dhe atë se si e kanë vrarë njëri tjetrin sepse disa kanë dashur të dorëzohen e të tjerët jo. Dhe për këtë ka pasuar reagim i fortë i bashkësisë ndërkombëtare dhe përafërsisht ju kanë thënë të bëjnë atë që duhen bërë. Atë që e kanë bërë ata plotësisht përputhet me ato që i ka Haga dhe disa asociacione që merren me këtë. Unë përsëris. Unë nuk dua të jetoj në shtetin i cili është pjesë e Evropës dhe ka 13.000 të zhdukur. Unë vështirë pajtohem të jetoj në shoqëri të tillë. Kjo shoqëri e humb hapin me moralin, me gjendjen e saj natyrore njerëzore do të thoja edhe me gjendjen shoqërore, në disa kategori të cilat për neve janë eminente dhe pa të cilët ndihemi të zbrazët në hapësirë dhe kohë. Unë mendoj se duhet të shikojmë edhe kah ato. Nuk ka çmim për të cilën nuk jam i gatshëm të shkoj për informatën për personin e zhdukur ose për informatën për atë se kush e ka kryer ndonjë krim. Këtë edhe e kam vërtetuar në punën time. Dhe kështu, disa njerëz të cilët kanë..... mbi gjendjet momentale. Nëse vërtetë dëshirojmë ti zgjidhim ato nëna të cilat paguajnë (qajnë) dhe të cilat nuk e dinë se çka të bëjnë me veten, nuk dinë se si ti përballojnë dramën të cilat vijnë. Unë nuk jam këtu, nuk ishte temë, as nuk kam dëgjuar për status, statusin e viktimave këtu. Unë kam cekur se në Bosnje dhe Hercegovinë primatin enorm në të gjitha kategoritë e ka popullata luftarake. Kam dhënë shembull që për llogorashët nuk ka pasur zgjidhje ligjore në Bosnje dhe Hercegovinë. Të gjithë i keni parë incizimet nga ato llogoret që u transmetuan. Asnjëra anë, asnjë etnitet, asnjë kanton e bile as shtet nuk i ka mbledhur forcat të iu pranoj atyre njerëzve statusin dhe ato që iu takojnë. Këto janë pushtetet. Të gjithë ata që janë burgosur, këta të mbyturit këta të zhdukurit. Dhe prandaj unë kam thënë, investoj shumë në sektorin civil, që ai të jetë ai që e nxit, përforcon atë raport ndaj pushtetit. Nuk bën shteti pothuajse asgjë vetvetiu. Përvojat e mija nga Bosnja dhe Hercegovina janë të rënda. Pa presionin tonë, pa formësimin tonë, shikoni këta filma, ka shumë, shumë shtete, shumë pësime, por ne të gjithë e kemi pas tragjedinë tonë. Dhe ne duhet të dalim vet nga kjo. Nuk është asnjë

shtet që i ka pas këto që i kishim ne. Vetëm në dy shtete ka punuar një komision së bashku, askund nuk ka pas shembull. Askund nuk ka ndodh kjo që ka ndodh këtu. Kështu që, vërtetë, nëse e shikoni komisionin nacional kjo është krejt në rregull. E keni vetëm një problem të vogël kohor për këto dhjet vite, e dini. Ne i kemi formuar dy, dhe janë shkatërruar për atë kohë. Jo që po ju sugjeroj diçka, por po flas. Nëse shihni se duhet të përgatisim terrenin për njerëzit të cilët i udhëheqin shtetet e këtij regjioni, që ti mbledhin forcat historike siç kanë bërë Francezët, Gjermanët dhe Anglezët pas 45. vitesh, të thonë ka qenë kjo – ka qenë kjo, pastaj i kemi pas gjykimet, dhe tani ecim në jetën e mëtutjeshme. Mendoj se Ballkani do të jetë së shpejti regjion në të vërtetë në një rend të tillë dite dhe këtyre integriteteve Evropiane, unë nuk jam për dhunë por nëse kjo është e vetmja mënyrë që politikanët tanë ti zgjidhin detyrat e shtëpisë, besoni në emër të viktimave do ta bëja edhe atë. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë, zoti Çorbo për gjithë këtë elaborim kaq domethënës. Besoj se të gjithë neve do të na shërbejë si një porosi e mirë, kurse para se me ua dhënë fjalën juve Baraliu, do t'ia jap Xhaferit se e kërkoi disa herë. Urdhëroni!

Xhafer Veliu: Faleminderit! Po më duhet ta marr fjalën s'di sa herë, se mua pare më preku ai, cili ishte ai zotëria i "Rockefellerit" a kush ishte ai. Unë thash se ato që i thash janë të vërteta... Ato janë të vërteta dhe të mos mendojë askush që nëse do dikush me ta zgjatë dorën e pajtimit për një kusht a për diçka e ka shumë gabim, sepse familjarët nuk e donë atë dhe se dua edhe unë vet si familjar por edhe familjarët tjerë. Sa për çështje të këtij zotëriut që tha, orientimin ne e dimë ku e kemi e ku është faji. Beogradi është fajtor për të gjitha edhe për serbët edhe për shqiptarët, se ai i di të gjitha krimet ku i ka bërë dhe ku i ka çua, qysh i ka marrë dhe ku i ka masakruar dhe kah i ka çua dhe i ka të gjallë apo të vdekur. Por unë desha si shkurt të them edhe një komision i drejt me u bë se sa të jetë kjo qeveri Beogradi krimet ka me i fshehur.

Shukrije Gashi: Faleminderit zotëri Xhafer. Edhe një a dy le ta marrin fjalën dhe pastaj ne do të vazhdojmë me propozime, përfundime ose rekomandime. Për faktin se përfaqësuesit e veteranëve të luftës nuk janë dhe ajo pjesë nuk ka pse të shqyrtohet pa praninë e tyre, ne do ta përmbylim këtë këshillim të sotëm. Paraprakisht do t'ia jap fjalën zotit Terziu se kaheerë e ka kërkuar por s'ka pasur mundësi se secili dëshironte të fliste. Urdhëroni!

Shaban Terziu: Faleminderit! Unë kam kështu një propozim. Më fort po ndiej për konstatimin e gjendjes se sa lëvizjen e gjërave dhe do të duhej më shumë të merremi me lëvizjen sepse konstatimet veç po dihen, janë të njohura kaheerë, por diçka të ndryshojmë. U bisedua për burgjet sekrete dhe varrezat masive. Kam njohuri nga përvoja e kaluar për burgjet që janë në Kosovë, janë në Serbi. Unë e përkrah atë rrëfimin dhe thënien e zonjës Kandiç sepse jam më se i bindur se burgje nuk ka në Kosovë. Gjithashtu mendoj se nuk ka as në Serbi, as në Bosnje.

Shaban TERZIU: Gjeje ti! Tjetër send është burgu, tjetër send është fshehja, zotëri. Të lutem kur diskutuat ju, unë s'ju ndërhyra. Edhe si jurist, nuk po e dëshmon veten. Unë desha me thënë atë për të të bindur, por ti s'më le, po ngutesh. Unë kam punuar në institucionet amerikane, s'po di me i thënë edhe disa gjëra më sekrete. Njerëzit në kuadër të atyre burgjeve i kanë shkatërruar, si shqiptari Serbit, Serbi shqiptarit, duke i thënë i pagjeturi. Unë ta gjej mi jep kaq të holla. Serbi i ka gënjyer shqiptarët, Serbi shqiptarin. Kemi shkuar dhe i kemi verifikuar gjërat. Nuk ka varreza masivë. Njerëzit e kanë shitur edhe shtratin, teshat e veta duke menduar se do ta gjejë, ka dalë turli far hajni, turli farë

matrapazi, turli far idioti. Kam njerëz me emra dhe që i di, e kam edhe të njohshëm, në region të Gjilanit – edhe shqiptar edhe serb, duke menduar se njeriu për të vetin i jep, i shet edhe teshat e trupit vetëm me gjet të zhdukurin.

Sa i përket çështjes së burgjeve sekrete, ato janë vetëm gënjeshtria e përfituesve. Kemi hulumtuar shumë këso gjëra edhe te zonat shqiptare, edhe te zonat serbe, dhe njerëzit i kemi zbuluar, disa janë arrestuar, disa janë përgjigjur – nuk ka varreza masive. Mendimi im është, për çka kam gjëra konkrete edhe më shumë. Sa i përket varrezave masive. Ka njerëz, prapë po e them në bazë të argumenteve, ka njerëz të cilët kanë marrë pjesë në luftë, kanë marrë pjesë në krime, ka njerëz që thotë ishalla s'vdes pa e treguar çka u bë. A e ke bërë ti, jo unë s'e kam bërë. Vetë e ka bërë po s'guxon me treguar që e ka bërë vet. Po thotë, as gjumi s'po më zë natën, po dua me u çmend. Thotë më mirë të shkoj diku ta mbys veten se sa po vuaj dhe një gjë që u bë s'po mundem me tregua se po frikohem. Dhe nuk del nga ky mendim se qysh me bë ndonjë telefon sekret, një vend diku që njerëzit të rrëfejnë se burgje masive ka. Dy-tre, edhe në Kosovë ka, dhe në Serbi ka, edhe në Maqedoni po ndiej që ka. Po duhet ta mendojmë të gjithë ne këtë.

Shukrije Gashi: A po flet për varreza apo për çka je duke fol.

Shaban TERZIU: Për varreza masive!

Shukrije Gashi: E po mirë!

Shaban TERZIU: Ashtu thash unë dhe unë ashtu e qartësova.

Shukrije Gashi: Jo, burgje thatë.

Shaban TERZIU: Dhe për këtë e kam qysh ta gjejmë një model, një modus njerëzit të rrëfehen që po lypin ende të zhdukurit. Ka njerëz që i dinë, ka marrë pjesë. Ai vetë e ka bërë krimin dhe është i interesuar me tregua por s'po guxon. Hajt pra të shkojmë në këtë drejtim se unë nuk jam as psikolog as sociolog as jurist, por të shkojmë në këtë drejtim e diçka të formojmë, ndonjë komision që njerëzit të rrëfejnë dhe vërtet të gjenden njerëzit e zhdukur. Iniciativat qytetare, shoqëritë civile. Po dua me ju treguar se kanë bërë shumë më shumë gjëra se sa që bëjnë qeveritarët. Shembull konkret dhe të gjitha po dua me i bë me shembuj konkret. Dokumentacioni i Gjilanit, i Vitisë, Kamenicës dhe Novo-Bërdës është në Vranjë. Unë vet kam qenë në Vranjë për dokumentacion dhe atje aq vështirë është me ardhë për to, por pa i dhënë pare s'mund e merr asnjë dokumentacion. Shkojnë gra, fëmijë, shqiptarë presin në rend aty, ftoftë e tmerr është dhe ne si shoqëri kemi shkuar me disa shoqata të Vranjës dhe i kemi treguar hallet dhe brengosjet tona, bile na fikën duke na marrë, duke u korruptuar dhe s'po mund të nxjerrim asnjë dokument dhe atje gra shtatzëna e fëmijë që presin dhe interesant ato kanë negociuar e ne s'na u ka dhënë rasti me negociua me institucione të punëve të brendshme të Vranjës dhe e kanë marrë iniciativën e i kanë burgosur vetë policia serbe vetë nëpunësit e serbëve të organeve të punëve të brendshme të Gjilanit të cilët tani gjenden në Vranjë. Domethënë, kur s'ka mund qeveria me negociuar për disa gjëra ne si shoqëri civile i kemi bërë dhe ka dalë pozitive dhe gjërat janë tash shumë më mirë duke lëvizur. Qeveria e kaluar ka marrë iniciativë në katër komuna për mësimin e gjuhës së mjedisit. O kanë aty Klina, Vitia dhe tjerat s'po më kujtohen. Nuk e ka pasur atë sukses dhe s'ka mund ta arrijë. Për mësimin e gjuhës së mjedisit e kam fjalën, shqiptarët e kanë mësuar Serbishte, serbët shqipen. Ne gjashtë kurse të gjuhës i kemi organizuar dhe kemi mbajt, po shqiptarët e kanë mësuar Serbishten, serbët e kanë mësuar shqipen dhe të gjithë së bashku gjuhën angleze. Përveç këtyre, e kemi mësuar gjuhën rome dhe gjuhën turke në rrethin e Gjilanit ku janë vendas aty. Me këtë dua të them dhe të konstatoj se shumë gjëra i lëvizë dhe ndryshon shoqëria

civile – OJQ-ët se sa Qeveria, se qeveritë ndërrohen. Më falni se ndoshta mora kohë.

Shukrije Gashi: Faleminderit, zoti Terziu. Fjalën do ta marrë Bogdani edhe një herë.

Bogdan Ivanisheviq: Po ja tani, kanë shkuar mjaft njerëz me të cilët unë para së gjithash kam dëshiruar të dëgjoj në çfarë dua të them unë, kështu që unë nuk e di a ka kuptim që unë të flas. Dëm që kanë kaluar 10 minuta para përfundimit kur diçka duhet të përfundohet. Por mirë, secili e ka mënyrën e vet në të cilën punon. Unë desha, kur nuk ka askush, ja unë do ta pyes Elin diçka si ndërrim. Ajo në fillim ka thënë se do të kishte dëshirë të dëgjoj, e intereson se cilat janë arsyet për të cilat njerëzit janë skeptik respektivisht për idenë e për formimin e komisionit regjional. Unë tani nuk dua ta kthej topin në terrenin e saj ose në terrenin e atyre që flasin për atë se së pari të formohet komisioni nacional apo vetëm komisioni nacional. E nuk e di sa janë njerëz të tillë të pranishëm këtu. Do të thotë, mua më intereson cilat janë arsyet për të cilat ju mendoni se së pari duhet të formohet komisioni nacional ose komisioni nacional në nivel të Kosovës e jo komisioni regjional. Unë mund të jap disa arsye pse mendoj se nuk do të ishte mirë që së pari të formohet komisioni nacional, por mua më intereson cilat janë arsyet e juaja dhe pse mendoni që duhet të themelohet komisioni nacional. Të themi, kjo që tha zotëriu, kjo më ka tërhequr në atë ... Njerëzit të cilët e dinë ku janë varrezat masive, shumë më e madhe është mundësia se do ti japin ato informata komisionit regjional sesa komisionit nacional. Mendoj, njerëzit që janë në Serbi, të cilët e dinë ku janë trupat, ata as që do të dinë për komisionin në Kosovë. Do të dinë por nuk do të kenë rast, nuk dot ë mund të shikojnë në televizor dëshmimit publike, nuk do të kenë atë lidhje direkte me atë komision, e që cilëndo ta kenë të supozojmë me komisionin regjional. Nëse komisioni regjional do të punonte në një mënyrë kredibile. Është e mundur që ata njerëz të cilët nuk mund të flenë për atë që dinë, në çka kanë marr pjesë e që frikohen tani të tregojnë, ndoshta do të kontaktonin atë komision me anë të ndonjë lidhje të fshehtë ose disi që të japin informata. Keni kujdes mjafton që këtë ta bëjnë tre njerëz me ndërgjegje që të filloj të zgjidhet kjo dhe të thuhet diçka. Por ata njerëz nuk besoj se do të munden, 'jam i bindur', se do të munden në të njëjtën mënyrë të kenë interaksion me komisionin e Kosovës. Tjetër është dokumentacioni, siç e thatë ju tani, nuk është në Kosovë. Një pjesë e rëndësishme e dokumentacionit nuk është në Kosovë por themi se është në Serbi apo diku tjetër. Dëshmimet publike me siguri, po qe se Kosova do të ishte përfshirë në komision, në numrin më të madh të rasteve do të ishin të një populli, që nuk jam i sigurt se në fund do të kontribuonte zbulimit të plotë të fakteve për ato që kanë ndodhur në Kosovë. Komisioni regjional, përkundrazi, për shkak të karakterit të tij do ti mundësonte pjesëtarëve të të gjithë popujve të dëshmojnë në atë komision. Pra, ja disa ide për atë si më duket mua se komisioni regjional do të ishte më efikase që të dhënat e tij të kishin kredibilitet më të madh. Por tani, nuk ka kohë të themi për debat të plotë për marrëdhëniet nacionale dhe komisionet regjionale por ndoshta do të duhej që shkurtimisht të dëgjojmë diçka për këtë. Do të doja të theksoja për atë që tha zotëriu diçka, prandaj jam lajmëruar. Më falni nuk po shoh, zotëri Shabani, dhe të mendohet për atë se si të motivohen njerëzit të cilët dinë për krime, të cilët e dinë ku janë trupat e zhdukur dhe këtë tia thonë ndonjë trupi i cili merret me gjetjen e të zhdukurve.

Eli Krasniqi: Shpresoj se nuk më ka ikur diçka sepse ishte goxha gjatë. Arsyeja pse thash ashtu, pse e ceka komisionin në nivel kombëtar është për shkak se... dhe unë pajtohem me krejt çka i thatë ju. Domethënë unë s'kam nevojë të bindem për rëndësinë e një komisioni në nivel rajonal, absolutisht jo. Mirëpo, për mua është legjitime ajo se çka

thonë njerëzit dhe çka njerëzit në teren flasin. Është e kotë që unë të përpiqem me i bind sa është i rëndësishëm ky mbledhim, ta quaj, në nivel rajonal përderisa ata nuk e ndjejnë. Mandej nuk është e drejtë prej meje të supozoj që unë di më mirë se çka është e nevojshme për ta. Edhe qoftë nëse kërkesa e tyre është për me qetësuar nevojën e tyre shpirtërore psikologjike, për mua është ajo legjitime. Dhe kjo numërohet. Mandej, jam shumë e bindur që kur të formohet ky nivel kombëtar, kur njerëzit ndihen rahat dhe ndihen pjesë e kësaj iniciative, ku ndihen zot të shtëpisë së vet, problemi është më i madh se sa që ne po mendojmë. Këtë që e kemi ne sot, është problem i së kaluarës. Ne kemi nevojë si popull me u ndie zot të vetës. Edhe nga iniciativat që ndërhyjnë prej jashtë, edhe kur nuk kemi të drejtë me i cilësuar si të huaja, ne i cilësojmë për shkak se janë dekada të një mentaliteti të kolonizuarit. Dhe si të tillë, për mua këto kërkesa janë absolutisht të nevojshme dhe janë legjitime. Tash po kthehem prapë. Nëse veç bëhet ky në nivel kombëtar, s'ke me mund me iu shmangur nevojave dhe me komunikua me rajonin. S'ke me mund me iu shmang. Po le të jenë ato nevoja dhe të vijnë ato nevoja natyrshëm prej njerëzve që punojnë në terren. Mos t'iu tregojmë ne se çka iu vyejnë atyre. Ne mund t'u tregojmë por sinqerisht, dhe po kërkoj falje sepse nuk jam kyçur tërë kohën, por për aq sa unë kam provuar me i përcjell këto procese të këtij komisioni dhe këshillimi, unë gjithmonë e shoh të njëjtin problem. Komunikimi është për shembull, një pjesë e tavolinës flet diçka, tjetra pjesë e tavolinës thuaja se nuk ka dëgjuar fare që ka thënë kjo pjesë e tavolinës, vazhdon me të vetën. Për shkak se aty rrihet çekani, aty ku dhemb më së shumti. E për mua ajo është legjitime. Po e them prapë. Unë jam shumë e bindur se të gjitha këto nevoja që ju i cekët të bashkëpunimit rajonal kanë me ardhë natyrshëm, por vetëm pas këta njerëz të vijnë natyrshëm në atë rrugë, domethënë kur këto pengesa të dalin në rrugën e tyre, jo në rrugën që ne ua trasojmë por në rrugën që këta vetë e trasojnë. Për mua është me rëndësi qysh njerëzit ndihen në këtë proces. Unë kam përshtypjen se njerëzit nuk po ndihen pjesë e këtij procesi, për shkak se ky proces ka ardhur si pjesë e ojç. Ne, që dhjetë vjet në Kosovë e dimë shumë mirë që OJQ, jo të gjithë, e kanë zërin e mirë në Kosovë, për shkak të keqpërdorimeve. Domethënë në Kosovë, duke qenë se njerëzit janë nëpërkëmbë aq shumë, është humbur besimi dhe njerëzit kanë nevojë ta rikthejnë besimin. Po qysh e rikthejnë njerëzit besimin? Duke bërë vetë përpjekje për me qenë pjesë e diçkahit. Nuk e di a jam e qartë? Ndoshta nuk po ia qëlloj por për mua kjo është e rëndësishme. Dhe, mos harroni një gjë. Ne e patëm për muhabet edhe më herët. Për mua është shumë e rëndësishme kjo që çka po shohim ne sot është pjesë e së kaluarës. Ky është momenti i parë për mua që ne po ballafaqohemi me të kaluarën. Po ballafaqohemi jo në kuptimin individual dhe jo vetëm në sferat tona private, por në njëfarë forumi pak më publik që është hala më e vështirë. Dhe në këtë kuptim, po mendoj se është shumë legjitime dyshimi, frikat, janë pra absolutisht të natyrshme. Ne nuk po flasim për përvojat e njerëzve, për vuajtjet dhe të gjitha ato sakrifica vetëm me fillimin e luftës. Po flasim për shumë-shumë dekada më herët ku shqiptarët kanë qenë Single-out en Jugosllavia. S'po di qysh me thënë shqip. Të veçuar. Domethënë këto janë trauma që përcjellen gjeneratë pas gjeneratë dhe është e natyrshme. Unë mendoj duhet të dimë ne çka duhet me bë. Unë po e shoh veten se po i japi vetes më shumë të drejtë të flas se gati si një person i jashtëm që po përpiqem me observua me tërë dashamirësinë e mundshme, a ndoshta thjeshtë duhet vetëm me dëgjua. Këta njerëz kanë nevojë për njëfarë katarze. Unë kam nevojë për atë farë katarzë.

Shukrije Gashi: Faleminderit Eli! Mund të vazhdojmë.

Halit Berisha: Zotëriu tha se pse alergji në formimin e komisionit rajonal. Në këtë pse KOMRE, këtu thotë 3 organizata joqeveritare për të drejtat e njeriut është Fondi për të Drejtën Humanitare FDH, Dokumenta dhe Qendra kanë alarmuar autoritetet dhe opinionin për nevojën e ballafaqimit me këto. Një. Në Podgoricë më 9 maj 2008, kanë qenë dy përfaqësues që i dimë ne, Hysni Berisha dhe Ahmet Grajçevci. Në emër të kujt ata kanë fol aty se ata mund të jenë anëtarë komisionit për formimin e saj. Për ata është ajo arsyeja dhe kërkesa jonë përforcimin e këshillit nacional të Kosovës. Ai është problemi. Kush i ka autorizuar ata, në emër të kujt kanë shkuar ata të dytë. Njëri është kryetar i Shoqatës unë ku jam aty, tjetri është i Fushë-Kosovës. Dhe ne kur i kemi bërë pyetje, thotë kush po ju vet juve. Nuk është kryetari këtu se ai e din mirë. Për atë arsye po kërkojmë decidivisht formimin e këshillit e pastaj me këto tri fonde, shoqata joqeveritare edhe ne të përfaqësohemi me shoqata tona dhe të ulemi e të bisedojmë se çka do të punojmë më tutje. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Faleminderit! Fjalën e ka Natasha.

Natasha Kandiç: Zotëri Halit, por këtu fare nuk shtrohet pyetja kush në emër të kujt. Tash ju pyes emrin e kujt ju ... Po kjo edhe nuk është me rëndësi. Nuk është kjo çështja më e rëndësishme. Çështja më e rëndësishme është si ti kontribuojmë ndonjë drejtësie, vërtetimit dhe përcaktimit të ndonjë të vërtete për atë që ka ndodhur. Kjo është çështja kryesore. Dhe gjatë këtij debati paraqiten të dy këto mendime. Ja ju e keni këtë mendim. Unë nuk dua që ... prandaj ju të provoni komisionin nacional sepse në nivelin regjional paraqiten disa të cilëve ju nuk i jepni të drejtë të përfaqësojnë. Po ndoshta nuk është kjo arsyeja. Ndoshta arsyeja pse ju e doni nacional është sepse mendoni të diskutoni në nivel të Kosovës, të arrini gjer te ajo se çfarë ka ndodhur. Disa prej nesh këtu kanë tentuar të paraqesin elemente për atë përse ndoshta ndonjë nivel regjional, por ne akoma presim të dëgjojmë argumente nga ju për atë nivel nacional. Ndoshta ne kemi lëshuar diçka. Bogdan Ivanisheviq, si njëri nga organizatat që ka qasje të plotë në të gjitha komisionet në botë, të cilat janë themeluar dhe të cilat edhe sot funksionojnë, ai ka zgjedh një shpjegim shumë të thjeshtë çka është në dobi të regjionale, çka do të thotë niveli nacional. Askush nuk e kundërshton, absolutisht nivelin nacional, as lokal. Ne bile mendojmë se do të vijë një kohë ndoshta edhe për disa gjëra pozitive. Përndryshe, në të gjitha anët ka shembuj solidariteti, se njerëzit i kanë ndihmuar njëri tjetrit edhe pse janë të nacionaliteteve të ndryshme. Ndoshta në këtë moment është herët për këtë, por ne mendojmë për atë se ndoshta në kornizën e mandatit të atij komisioni, le të jetë KOMRA ... edhe nga këto përvoja pozitive. E gjithë kjo kontribuon që të përcaktohen disa fakte. Prandaj nuk do të jetë keq që ti paraqitni pak ato argumente, qëndrimet dhe mendimet për këtë, për këtë komision nacional. Me kënd ky komision ... edhe Salemi edhe Bogdani kanë thënë harroni si do të veproni në nivelin nacional nëse trupat gjenden jashtë Kosovës, çka do të bëni nëse dokumentacionet të cilat i përmendin Xhaferi dhe Ymeri gjenden në ndonjë vend tjetër. Po nuk ia vlen nëse komisioni punon në rrethin e kësaj asaj plotësisht e mbyllur këtu në Kosovë. Nuk është asnjë komision që mund të funksionojë kështu. Duhet të jetë i hapur, duhet të ketë kërkesa, duhet të ketë komunikim. Duhet ti ketë dhe nuk bën pa to. Nuk kanë ndodhur këtu disa grindje për gjëra të parëndësishme. Këtu janë vrarë njerëz. E dini atëherë sa është e nevojshme të gjendet strategjia më e mirë që ata të cilët akoma i fshehin të dhënat, akoma e mbrojnë Millosheviqin dhe sa e komplikuar dhe e vështirë është të merren këto rezultate. Nuk mundemi që të mos respektojmë asgjë. Dhe prapë se prapë, paramendoni pranë meje, pranë Bogdanit, pranë

të gjithë nesh të cilët e dëshirojmë këtë të vërtetë, kanë kaluar ata kamiona, frigoriferë me kufoma dhe ne këto nuk i kemi parë. Dhe tani sipas jush, ju do të mund të na akuzoni se si ne nuk e dimë këtë. Unë gjithnjë kam qenë në rrugët e Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe nuk e kam parë asnjë frigorifer. Do të thotë vazhdimisht mendoj për atë se si është e mundur që nuk e kam parë asnjë frigorifer dhe vazhdimisht mendoj se me mua nuk është diçka në rregull, por nuk e kemi parë, nuk e kemi parë. Do të thotë se ekzistojnë shumë gjëra të cilat janë shumë të organizuara, shumë me ndonjë qëllim të qartë se si të shmangët opinionin në këtë. Përndryshe siç thotë Eli nuk mundemi ne nëse viktimat ndihen më mirë. Keni kujdes, këtu jeni ju dhe viktimat dhe përfaqësoni disa individë të cilët drejtojnë disa shoqata. Por e dini çka do të thotë, ne duhet të konsultohemi dhe ti pyesim njerëzit të cilët janë poshtë në fshatrat e tyre, në qytetet e tyre, të cilët nuk kanë rast, nuk janë sot këtu me ne që të bisedojmë. Edhe nuk duhet, të them ashtu, të sillemi si disa komunistë ne tani do të përcaktojmë se kush çka do të thotë dhe se si do të ... E kemi lënë atë sferë. Nuk është më ai komunizëm. Dëshirojmë edhe individë, edhe viktima, edhe shoqëria, edhe të rinjtë dhe të gjithë kemi të drejtë dhe nevojë të dimë çka ka ndodhur dhe të përcaktojnë ato fakte. Po hajde pra të shohim, se unë do të doja të dëgjoj. Eli, ti je sociologe, po trego pra kur thua, ti duhesh, ti e formon atë shoqëri. Kur thua mirë nacionale. Të shohim çka do të jetë mandati i Komisionit nacional. Ku janë familjet e Boshnjakëve të zhdukur? Ka shumë që kanë shkuar nga këtu.

Mazllum Baraliu: Po kërkoj falje, unë ju dhashë përparësi juve, më jepni ju mua tash. Pikërisht disa përgjigje. Unë po shoh këtu qasje që është krejt normale, por nuk është mirë të ketë nuanca të tepruara të përjashtimit, domethënë të kemi diskutime përjashtuese të një variante dhe të kemi apologjike të një variante tjetër. Unë mendoj se më kuptoni të gjithë mirë çka po dua të them. Unë mendoj që në nuancat e propozimeve këtu nuk ka dallime të mëdha. Esenca dhe qëllimi është i njëjtë dhe ajo duhet të jetë mbrojtja e viktimës dhe ndërprerja e status-kuos, ju lutem. Që për 11 vjet po shkojnë në Kosovë, 17 vjet na tha zotëriu në Bosnje, ka një gjendje pothuaj se status-kuo, me gjithë respektin edhe të sektorit civil edhe të institucioneve qeveritare që kanë bërë, por gjendja nuk ka ndryshuar shumë. Ne duhet të lëvizim. Dhe unë mendoj nuk kemi të drejtë të themi se as komisioni nacional ose ndonjë trup tjetër koordinues por gjithnjë nacional, as ky tjetri regional nuk mund ta zgjidhin problemin. Kjo nuk qëndron. Sepse, është përpjekje, nuk po them se do ta zgjidhim por duhet të bëjmë përpjekje të mëtutjeshme sepse e kemi gjendjen keq. E dyta. Dikush tha këtu në emër nuk e di të çkahit, por mos harroni se kemi njohuri edhe ne dhe po i përmendi, jo 100 shembuj, por vetëm shembullin e Indonezisë dhe të Timorit Lindor, ku edhe përkundër insistimeve dhe ndihmesës së bashkësisë ndërkombëtare është formuar një krijesë e cila nuk ka dhënë rezultate të mira dhe nuk ka qenë e drejtë në kuptim të zëbrthimit të së drejtës. E dyta çështje u shtrua këtu, nga zotëriu i nderuar, nga Bosnja, çështja e mandatit dhe nga diskutues. Ky komision rajonal duhet të ketë mandat të plotë dhe mandati nënkupton edhe funksionalitetin, edhe legjitimitetin, edhe efikasitetin edhe rezultatet. Unë po ju garantoj dhe po lus që të keni mirëkuptim nga përvoja ime si anëtar prej 95 i Këshillit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Prishtinë, një njeri që ka dëshirë me të vërtetë në mënyrë universitare të ju ndihmoj dhe t'i mbroj të drejtat e qytetarit qoftë ato individuale qoftë kolektive, se nuk mund të ketë sukses në qoftë se nuk bëhet edhe ndihmesa nga qeveritë përkatëse, Qeveria e Bosnjës që ka shumë probleme, më shumë se e jona këtu, të jemi real sepse duhet konsensusi i tri qeverive dhe shumë vështirë është për të formuar një qëndrim për të

dhënë të dhëna. Sepse, dihet etnia e Republikës Serpska i ka të dhënat, por edhe këto të tjerat i kanë, edhe bashkësia kroatë edhe bashkësia myslimane. Në Serbi është problem i parë sikur të ne që po e shtron zonjusha apo zonja me të drejtë dhe zotërinjtë se për t krijuar një konsensus, sepse edhe atje nuk mundet bash lehtë sepse nuk ka ndonjë sjellje e qëndrim të unisuar. Në Kosovë ne kemi problemin kryesor dhe këtu është problemi, se qëllimi është që ta ndihmojmë këshillin gjegjësisht komisionin rajonal. Askush me arsye të shëndoshë nuk ka kundër, sepse e kemi synimin e mbrojtjes së viktimës që ta ndihmojmë dhe formojmë komisionin për vërtetimin e të vërtetës. Por, për ta bërë atë, kuptoni, ju vetë duhet ta dini gjysmën e njerëzve që i keni ftuar këtu e që kanë qenë atje s'janë këtu. Nuk kemi konsensus. Nuk mund të shkojmë përpara që t'u ndihmojnë juve dhe plotësisht kanë të drejtë sidomos përfaqësuesit e tyre, se këta janë përfaqësuesit e familjeve të viktimave kryesisht, duke respektuar edhe OJQ-ët tjera që merren, pa shkuar me një hap. Domethënë dallimin e kemi vetëm në hapa. Hapi i parë, të konsolidohemi brenda. Nuk do të thotë në asnjë mënyrë formimi i ndonjë komisioni nacional që do ta përjashtonte ndihmesën, koordinimin me komisionin rajonal. E dyta, e treta çështje. Ne kemi një komision ndërministror. Nuk ka rezultate të mëdha, me shumë përpjekje. Dhe ai komunikon me Qeverinë e Serbisë, nuk ka. Prandaj ka nevojë që pikërisht ashtu si tha përfaqësuesi i Qeverisë, por shumë urgjentë, ata ta marrin iniciativën se përndryshe nuk vijnë përfaqësuesit e shoqërisë civile në qoftë se thërret zonja Shukrije ose unë, po vijnë kur i thërret një institucion qeveritar dhe të bëhet një trup koordinues i përbashkët midis shoqërisë civile, gjithnjë ndërnacional, por zoti Haki nuk tha komision multinacional, që gjithsesi është po tha është shtet multinacional në Kosovë, por edhe në atë komision multinacional të gjithë përfaqësuesit e të gjitha kombësive, sepse të gjithë kanë viktima, në koordinim me Qeveri dhe në koordinim të plotë në të njëjtën kohë me komisionin rajonal, pa ndërpre aktivitetet. Prandaj, kjo nuk e përjashton variantin, njëri variant dhe tjetër. Unë këtu e shoh dhe ky është propozimi im final që në këtë mënyrë të shkohet dhe ta rrumbullaksojmë disi këtë. Faleminderit!

Shukrije Gashi: Unë e falënderoj shumë zotin Baraliu për këtë propozim që e dha. Konsideroj se ka vend për dy opsionet dhe shumë mirë e keni theksuar, që do me thënë që të dyja mund të bëjnë punë paralelisht dhe të plotësohen, nuk ka përjashtim. Tash edhe një ta marrë fjalën dhe konsideroj se është koha që ne ta përfundojmë. Urdhëroni!

Ylber Maxhuni: Faleminderit! Ylber Maxhuni nga OJQ "Youth Step". Sa i përket kësaj pjese desha të ndërlidhem me atë rolin tredimensional të shoqërisë civile, të komisionit dhe të viktimave në raportin e tyre. Komisioni çfarëdo qoftë struktura e tij dhe përbërja e tij nuk do të ketë sukses pa mbështetjen e shoqërisë civile, gjegjësisht OJQ-ëve. Sepse, OJQ-ët shtrihen në regjione të caktuara dhe ato shërbejnë si element bazik dhe element shumë i pashmangshëm për depërtimin deri te viktima, deri te të prekurat dhe siç dihet roli i komisionit është edhe ta bëjë trajtimin e viktimave, qoftë për gjetjen e familjarëve të zhdukur, qoftë ndihmën materiale për viktimat e prekura të cilat kanë humbur të dashurit e tyre dhe nuk kujdeset tash askush për ta dhe risocializimin e tyre. Andaj, shoqëria civile përbën një element shumë bazik dhe të pashmangshëm për suksesin e komisionit. Tjetër çështje është ajo që desha të lidhem me të respektuarin zotëri Baraliun. I rëndësishëm është mandati për funksionimin e komisionit. Mandati i plotë, sepse ne mund të organizojmë një komision mirëpo varet sa kemi mandat dhe sa mund të funksionojmë ndërsa komisioni regjional ka kompetenca shumë të mëdha dhe njihet nga të gjitha institucionet. Andaj, ideja e formimit të komisionit regjional është shumë më logjike dhe

tek e fundit Qeveria jonë nuk ka zbritur nga qielli, sikur shkrimet e shenjta që kanë zbritur, mirëpo qeveria është organizatë të cilën e ka zgjedhur populli dhe populli i Kosovës ia ka dhënë mandatin me votat e tij. Andaj, më vjen mirë që këtu është përfaqësuesi i Qeverisë dhe kjo do të duhej të shkojë në mënyrë institucionale, mos të kemi konflikte opinionesh por të jemi konstruktivë në një çështje shumë madhore – zgjidhjen e fatit të të zhdukurve e cila është çështje shumë preokupuese dhe unë, dhe të gjithë, besoj se jemi të interesuar për zbardhjen e kësaj çështjeje. Ju faleminderit!

Shukrije Gashi: Xhafer, a do me thënë edhe diçka? Urdhëro!

Xhafer Veliu: Zoti Bogdan a keni ndonjë pyetje për mua?

Shukrije Gashi: Mirë, faleminderit!

Bogdan Ivanisheviq: E di që ju kam përmendur, por nuk mund të kujtohem më në cilin kontekst, kërkoj falje.

Shukrije Gashi: Mirë, faleminderit shumë. Unë vetëm dua t'ua bëj me dije se vetë emërtimi, këshillimi ose proces konsultativ ose këshillues nënkupton faktin se aktiviteti do të vazhdojë dhe është një proces dhe është vetëm një proces. Domethënë mundësitë janë të hapura, është bashkëbisedim dhe këmbim informatash, ofrim të opsioneve, mundësive çka funksionon çka nuk funksionon, pse nuk funksionon, pse është e dobishme njëra e pse s'është tjetra. Është çështje perceptimesh, është çështje përvojash dhe praktikash. Prandaj, kjo është e hapur dhe do të vazhdojë këshillimet edhe në të ardhmen e afërt në kuadër të Koalicionit për KOMRA. Të gjithë të interesuarit janë të mirëseardhur që të kontribuojnë qoftë u pajtuan apo s'u pajtuan me iniciativën.

Nesër është edhe një konsultim tjetër i cili është i paraparë që të zhvillohet me krijuesit – artistë të Kosovës. Më vonë tentativat tona janë që përsëri të vazhdojmë me Rrjetin e grave të Kosovës, pastaj me Qeverinë siç u bë një propozim në bashkëpunim me shoqërinë civile. Po ashtu, edhe me asociacionin e komunave të Kosovës dhe të gjitha grupet e interesuara. Ju jeni të mirëseardhur që të kontribuoni me këshillime, me idetë, mundësitë e juaja, me të dhënat që do të ishte mirë që të ofrohen edhe argumente dhe të dhëna në dispozicion. Në qoftë se nuk ka edhe dikush tjetër për të thënë diçka, konsideroj se ky këshillim është i përmbyllur, përveç nëse ka propozime dhe rekomandime. Ato duhet t'i bëjmë shkurtimisht për arsye se kemi dalë jashtë kohës së paraparë. Duhet theksuar se atë që i tha zoti Baraliu, Ruzhdi Jashari dhe shumë të tjerë këtu, edhe përfaqësuesit e shoqatave duke përfshirë edhe atë të opsionit, mundësinë e nivelit të komisionit në nivel nacional, ose kombëtar ose opsioni tjetër multi-etnik në nivel nacional, e të tjera, të gjitha këto me një fjalë janë propozime, rekomandime dhe sugjerime. Prandaj, konsideroj se ky këshillim është i përmbyllur, nëse nuk keni edhe diçka, ju lutem. Faleminderit shumë të gjithë juve për kohën që ia keni kushtuar këtij këshillimi dhe në radhë të parë interesave tona të ndërsjella. Në veçanti falënderoj zotëriun nga Bosnja Salem Çorbo dhe të gjithë të tjerët këtu që kanë ndërmarrë këtë udhëtim për ta nda përvojën, brengat e tij dhe praktikën që zhvillohen në Bosnje. Shpresoj se edhe në të ardhmen e afërt do të kemi këshillime të tilla. Faleminderit!

Besarta Vasija: Më falni, kemi edhe diçka teknike. Kush ka pasur shpenzime për udhëtim le të lajmërohet te Mentori për refundacion.